



Konferenca e I-rë Ndërkombëtare mbi

ARTIN DHE EDUKIMIN

UNIVERSITETI I ARTEVE TIRANË
11 - 12 QERSHOR | 2025

LIBRI I ABSTRAKTEVE



Kryetar i Nderuar:

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Organizues:

Prof. Mr. Nora Halimi

Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut

Prof. Dr. Sara Brajović

Fakulteti i Arteve, Universiteti Donja Gorica, Mali i Zi

Prof. Mr. Fatbardh Gashi

Fakulteti i Arteve, Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, Kosovë

Prof. Asoc. Dr. Zeni Ballazhi

Fakulteti i Arteve, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Prof. Asoc. Albes Fusha

Zëvendës Dekan në Fakultetin e Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Silvana Skënderi

Zëvendës Dekan në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Elis Mataj

Zëvendës Dekan në Fakultetin e Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Janko Ljumović

Fakulteti i Arteve Dramatike, Universiteti i Malit të Zi

Prof. Asoc. Dr. Ardian Isufi

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Holta Sina

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Elida Rapti

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Ervin Meniko

Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Armira Kapxhiu

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin e Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Edmir Ballgjati

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Msc. Adela Kusuri

Sektori Ligjor, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

MA. Kein Katroshi

Supervizor i dizajnit grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Shkencor Ndërkombëtar:

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Academic Vasil S. Tole

Akademia e Shkencave, Tiranë, Shqipëri

Prof. Arben Llozi

Dekan i Fakultetit të Muzikës, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Sadik Spahija

Dekan i Fakultetit të Arteve të Bukura, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Milto Kutali

Dekan i Fakultetit Skenik, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Arian Paço

Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dorian Çene

Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Dr. Hazir Haziri

Dekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Prof. Ma. Hysen Nimani

Dekan i Fakultetit të Arteve, "Haxhi Zeka" Universiteti i Pejës, Kosovë

Prof. Mr. Senad Abdul

Dekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut

Prof. Dr. Francesco Perri

Conservatorio "S. Giacomoantonio" di Cosenza, Italy

Prof. Dr. Innocenzo Cosimo De Gaudio

Conservatorio "S. Giacomoantonio" di Cosenza, Italy

Prof. Asoc. Dr. Edin Jasarović

Dekan i Fakultetit të Arteve Dramatike, Universiteti i Malit të Zi, Mali i Zi

Dr. Ardian Ahmedaja

Universiteti i Muzikës dhe Arteve Skenike në Vjenë

Dr. Bledar Kondi

Universiteti Martin Luther Halle-Vitenberg, Gjermani

Dr. Ermir Nika

Universiteti European, Tiranë, Shqipëri

Dr. Dashamir Vaqarri

Universiteti "Derby", Mbretëria e Bashkuar

PËRGATITUR NGA:

Konferenca I-rë Ndërkombëtare mbi Artin
dhe Edukimin (ICAE 2025)

BOTUESI:

Universiteti i Arteve

ISBN Print:

9789928486004

ISBN Digital:

9789928486035

ISBN E-Book:

978-9928-4860-3-5

PRINTUAR NGA:

West Print Albania

TIRAZHI:

I printuar dhe online

VENDI I BOTIMIT:

Tiranë, Shqipëri

E DREJTA E AUTORIT:

©Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të
riprodhohet në asnjë formë pa lejen e
Redaksisë

Bordi Redaktues:

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Holta Sina

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Edmir Ballgjati

Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana

Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Dr. Ervin Meniko

Fakulteti Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Bordi Kreativ:

MA. Kein Katroshi

Supervizori i dizajnit grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Mikea Dusha

Dizajner grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Jori Zguro

Dizajner grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Marsia Kuka

Dizajner grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Publikuesi Online:

Erjon Sulaj



MESAZH MIRËSEARDHJEJE!

Është kënaqësi dhe nder i veçantë t'ju uroj mirëseardhjen në Konferencën e Parë Ndërkombëtare për Artin dhe Edukimin (ICAE 2025), organizuar nga Universiteti i Arteve në Tiranë.

Kjo ngjarje e rëndësishme, mbledh një grup të larmishëm dhe të spikatur studiuesish, edukatorësh, artistësh dhe kërkuesish nga i gjithë rajoni dhe më gjerë, të bashkuar nga një përkushtim i përbashkët për të zhvilluar më tej ndërthurjet mes praktikës artistike dhe pedagogjisë. Në një kohë kur artet vendosen para sfidave të shumta për t'iu përgjigjur transformimeve të shpejta shoqërore, teknologjike dhe kulturore, kjo konferencë ofron një platformë jetike për shkëmbim, reflektim kritik dhe dialog krijues.

Tri fakultetet tona – ai i Muzikës, i Artit Skenik dhe i Arteve të Bukura, kanë bashkëpunuar për të kuruar një program që pasqyron si trashëgiminë ashtu edhe inovacionin, duke lidhur teorinë me praktikën. Gjerësia dhe thellësia e temave të trajtuara në këto punime dëshmojnë për pasurinë e kërkimit artistik bashkëkohor. Nga çështje të qëndrueshmërisë kulturore, ruajtjes digjitale dhe edukimit ndërdisiplinor, te reflektimet mbi rolin në zhvillim të arteve në hapësirën publike dhe shëndetin mendor, kontributet e mbledhura këtu na ftojnë të rimendojmë rolin e artistit dhe edukatorit në shoqërinë e sotme.

Shpreh mirënjohjen time të sinqertë për komitetet organizative dhe shkencore, për bordin redaktues, si dhe për çdo pjesëmarrës, puna intelektuale dhe artistike e të cilëve, e ka bërë të mundur këtë ngjarje. Uroj që diskutimet që do të ngjallen këtu, të frymëzojnë bashkëpunim afatgjatë dhe përkushtim të vazhdueshëm për avancimin e arteve dhe arsimit në komunitetet tona.

Mirë se vini në ICAE 2025!

Prof. Dr. Erald Bakalli

Rektor

Universiteti Arteve, Tiranë, Shqipëri.

TABELA E PËRMBAJTJES

SESIONI I - Fakulteti i Arteve të Bukura - Postmodern-Multidisiplinar

1. Harri Aleksi

Arti protestë - Transformimi vizual nga gjysma e dytë e shekullit të XX deri më sot.....16

2. Kein Katroshi

AI dhe Tipografia Gjeneruese: Një front i ri në dizajn17

3. Helidon Gjergji

Zanafilla e artit të performancës në Shqipëri – Dy Guliverët18

4. Dr. Dorina Papa

Land Arti si një qasje arkitektonike e qëndrueshme dhe mjedisore për krijimin e hapësirave me identitet.....19

5. Prof. Dr. Nora Halimi

Konvergenca e artit dhe dizajnit grafik: Një qasje ndërdisiplinore për të përfshirë diversitetin e artit pamor në edukimin e dizajnit grafik.....20

6. Joan Ikonimi

Interaktiviteti si një Dimension i ri Artistik: Video Games vs. Artet Tradicionale21

7 . Vlerë Mulliqi

Arkitektura si një përvojë ndijore dhe artistike: Një analizë fenomenologjike përtej funksionalitetit....22

SESIONI II - Fakulteti i Arteve të Bukura - Etnografi

1. Alkida Boshnjaku, Prof. Asoc. Dr. Taulant Pustina

Metodat tradicionale dhe bashkëkohore në dokumentimin dhe restaurimin e veshjeve tradicionale.....23

2. Fjoralba Prifti, Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

Dinastia e Zengove, krijimtaria ndër breza prej dy shekujsh.....24

3. Kleida Gjata

Restaurimi, fillesa e mbarëvajtjes shekullore të trashëgimisë kulturore.....25

4. Elona Nallbani

Veshja popullore. Kostumet e zonave veriore të Shqipërisë. Ndikimet nga kultura orientale për shekuj me radhë26

5. Klevisa Gaxha

Dasma tradicionale në Has-Shqipëri.....27

6. Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

Pikturabizantine-postbizantine.....28

SESIONI III - Fakulteti i Arteve të Bukura - Arti Pamor shek XX

1. Edmond Muço

Interesimi i piktorëve të Rilindjes Kombëtare për etnografinë.....30

2. Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

Një histori e shkurtër e institucioneve artistike shqiptare31

3. Dr. Agron Mesi

Disa fillesa të pranisë së trupit të zhveshur (nudos artistike) në artin laik shqiptar.....32

4. Prof. Dr. Jëlldës Asani

Tabutë dhe voajerizmi si (auto)censurë e trajtimit të trupit femëror në artet pamore shqiptare.....33

5. Dr. Merita Toçila

Arti tekstil në bashkëkohësi.....34

6. Dr. Kujtim Halili

Arti në hapësirat publike: skulptura si mjet edukativ në Shqipëri.....35

7. Dr. Ervin Meniko

Vepra stilistike e piktorit Abdurrahim Buza.....36

8. Blerina Pagra, Prof. Sadik Spahija

Skulptura Shqiptare në hapësirën publike gjatë shekullit të 20-të.....37

SESIONI I - Fakulteti i Artit Skenik - Skenografi dhe Koreografi

1. Elona Beqiraj

Kultivimi dhe zhvillimi artistik i valles lirike dhe epike në Republikën e Shqipërisë.....52

2. Ersilja Çeli

Roli i Inteligjencës Artificiale në koreografi: Një epokë e re e lëvizës.....53

3. Prof. Asoc. Dr. Roberta Ndokaj

Synimi drejt veprave kombëtare origjinale.....54

4. Drini Shehu

Studim krahasues i skenografive për shfaqje të njëjta në teatro të ndryshme.....55

5. Enela Mastori

Skenografia dhe kostumet në fillesat e kinematografisë shqiptare.....56

6. Gazmend Koçollar

Ndërtimet italiane të viteve 1900 në qytetin e Gjirokastrës, frymë perëndimore që erdhi nga Italia57

7. Ened Kuka

Evoluimi i teatrit dhe skenografisë.....58

8. Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana

Arbërishtja dhe shqipja standarde: Dallime gjuhësore dhe rreziku i zhdukjes.....58

SESIONI II - Fakulteti i Artit Skenik - Filmi dhe Kinemaja

1. Eno Milkani

Ndikimi i “artit të shtatë”, në Shqipëri, nga kinematë e para e deri tek ndikimi i artit të realizmit socialist.....44

2. Suela Bako

*Kinemaja për fëmijë e viteve '60-'90, një mjet edukimi që kërkon strategji orientuese për të komunikuar me fëmijët e sotëm.....*45

3. Dr. Elis Mataj

*Petro Marko, një dramë përballë kritikës.....*46

4. Suela Agolli, Prof. Asoc. Dr. Anila Mullahi

Elementi dramatik në eposin e kreshnikëve47

5. Prof. Asoc. Dr. Anila Mullahi, Suela Agolli

Dramaturgjia shqiptare gjatë periudhës së realizmit socialist48

6. Anila Varfri

Prezenca e mistikës dhe aspekti filozofik i kinemasë së Bergman-it.....49

7. Elvis Lule

Dialogu vizual mes pikturës dhe filmit bashkëkohor: Referencat e artit pamor në kinemanë ndërkombëtare.....50

8. Prof. Asoc. Zamir Kokonozi

Nga fjala në imazh: Interpretimi vizual i narracionit dhe emocionit në film.....51

SESIONI III - Fakulteti i Artit Skenik - Teatri

1. Qëndrim Rijani, Agron Vrangalla

Makbethi: Një ndërhyrje eksperimentale mbi skenën e vrasjes së mbretit Duncan.....38

2. Kristjan Koroveshi

Frymëmarrja diafragmatike, fillesa e rrugës stërvitore drejt të folurës së mirë në skenë dhe në publik39

3. Inis Gjoni

Regjia dhe regjisorit në skenën shqiptare, përmes veprimtarisë së regjisorit Pandi Stillu.....40

4. Prof. Asoc. Dr. Rozina Kostani

Aktrimi, nga teoria në praktikë - Hulumtimi e zbatimi i metodologjive në shkollën e aktrimit shqiptar.....41

5. Valdrin Asani

Dramaturgjia e sirtarit. Rikthimi i veprave të ndaluara dhe pritshmëritë e audiencës postkomuniste.....42

6 . Iris Canaj

Arti në hapësirat publike - Sfidat dhe mundësitë e ekspozimit të artit në hapësirat urbane.....43

SESIONI I - Edukimi / Metodologjia – Probleme dhe Risi

1. Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala, Adivi Kuka

Edukimi artistik, domosdoshmëri apo harresë.....60

2. Prof. Asoc. Dr. Artan Ibërshimi, Uesli Alushi

Sfida e integritetit të kërcimit në kurrikulën arsimore kombëtare.....61

3. Prof. Asoc. Dr. Rreze Kryeziu Breznica, Prof. Asoc. EdD. Besa Luzha

Harmonizimi i programeve të historisë së muzikës shqiptare në arsimin e lartë të Kosovës dhe Shqipërisë.....62

4. Andi Hila

Edukimi artistik përmes Muzeut Kombëtar “Marubi”.....63

5. Dr. Oltsen Gripshi

Semiotika dhe interpretimi i krijimeve artistike në grupmoshat 3 deri 18 vjeç.....64

6. Dr. Irena Buzi

Metodologjia e mësimi të teknikës së skulpturës dhe qeramikës për grupmosha 6-12 vjeç.....65

7. Ulpiana Aliaj

Roli i edukimit muzikor në zhvillimin e artistëve të rinj për skenën operistike.....66

8. Linda Kazani

Ndikimi i pedagogjisë vokale tek këngëtarët sipas zhanreve të ndryshme muzikore.....67

SESIONI II - Edukimi / Simbolika e Artit dhe Edukimi

1. Angela Bushati

Arkitektura e mijes: Rikonceptimi i Muzeve dhe hapësirave urbane si territore të kreativitetit dhe edukimit.....68

2. Ervin Rapushi, Artur Zoto, Teuta Backa	
<i>Reumatologjia në art</i>	69
3. Prof. Asoc. Dr. Roven Vata Mikeli	
<i>Simbolika e vdekjes në poezinë e D. Agollit</i>	70
4. Mirela Vitaj, Mimoza Marko, Vitori Gjonaj, Aurora Zekaj, Gjylie Çela	
<i>Rëndësia e komunikimit jo verbal në marrëdhëniet mësues – nxënës</i>	71
5. Saranda Nitaj	
<i>Disiplina në orët mësimore</i>	72
6. Ardi Pulaj, Prof. Edith Mihali	
<i>Tefta Tashko Koço, këngëtarja lirike urbane në epokën digjitale</i>	73
7. Prof. Asoc. Dr. Sajmir Shatku	
<i>E drejta e autorit dhe digjitalizimi i pronësisë intelektuale artistike</i>	74
8. Endona Bardhi	
<i>Globalizimi, ndikimi i kësaj dukurie në zhanret muzikore në Kosovë</i>	76
9. Amalia Koleka	
<i>Psikologjia e ndërmjetësimit, impakti i metodës</i>	77
SESIONI I - Muzika - Rrugë të reja krijuese dhe studime teorike në muzikën moderne shqiptare	
1. Valmir Xoxa	
<i>Modernizimi i operës shqiptare pas vitit 1990: Qasja eksistencialiste dhe serializmi në operan moderne në operën moderne shqiptare - Dhoma të kompozitorit Ermir Dergjini</i>	78
2. Jetmir Zaganjori	
<i>Krijimtaria muzikore e Zeqirja Ballatës, një mes i artë mes traditave muzikore popullore dhe muzikës bashkëkohore</i>	79
3. Pirro Gjikonci	
<i>Edmond Buharaja – “Tërësia e polisemizmit morfologjik”, vështrim i përgjithshëm mbi strategjitë dhe teoritë analitike</i>	80

4. Dr. Fabio M. Rochi

Disa reflektime mbi përfaqësimin zanor të stuhisë. Retorika, estetika dhe funksionet didaktike të një tropi muzikor.....81

5. Rozana Kuka

Flauti në formacionet e muzikës së dhomës dhe tendencat bashkëkohore në këtë gjini.....82

6. Flavio Lito

Kitara në muzikën shqiptare (Shekulli XX).....83

7. Prof. Mr. Fatbardh Gashi

Roli i klarinetës në muzikën bashkëkohore shqiptare.....84

8. Syzana Jakupi

Fillet e muzikës pianistike në Kosovë.....85

9. Entela Demi

Promovimi i krijimtarisë së kompozitoreve gra në botë përmes festivaleve muzikore dhe recitaleve: Një përvojë e vlefshme për skenën muzikore shqiptare.....86

SESIONI II - Muzika - Këndvështrime Historiografike

1. Ajet Çekiçi

Muzika shqiptare e dhomës në vitet 1910 – 1940.....88

2. Ardita Bufaj

*Veprat muzikore për orkestër të At Fan S. Nolit, si pikë takimi me Nolin poet, klerik, studiues e shtetar....
.....89*

3. Prof. Asoc. Dr. Holta Sina Kilica

“Copëza” të muzikës bizantine në muzikën profesioniste shqiptare.....90

4. Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

Roli i orkestrave frymore në zhvillimin e muzikës së kultivuar në Shqipëri.....91

5. Fatma Spahiu

Lindja e muzikës profesioniste në Shqipëri dhe lidhja e saj me lëvizjen e bandave muzikore në qytetin e Shkodrës.....92

4. Arjan Brahimi

“Vallja me dajre” e Th. Gaqit – mes muzikës dhe simbolikës.....93

5. Lorenc Treska

“Sonatë për violinë e piano” e Çesk Zadesë - Këndvështrimi analitik dhe kritik i koncepteve të reja muzikore ndërthurur me folklorin shqiptar.....94

8. Klejda Tare

Veprat e para shqiptare për piano e orkestër dhe vendi i tyre në fondin e muzikës shqiptare.....95

9. Fjorda Veizaj

Muzika shqiptare në piano në fundin e shekullit XX – fillimin e shekullit XXI dhe roli i saj në formimin e e shkollës kombëtare pianistike shqiptare.....96

10. Laura Lila

Teknika Pianistike dhe Muzika shqiptare e viteve 50’ – 60’.....97

SESIONI III - Muzika - Muzika, kultura bashkëkohore

1. Armend Xhoni

Nga protesta te patriotizmi: Roli i muzikës rrok dhe këngës patriotike në ndërtimin e identitetit kombëtar shqiptar.....98

2. Andi Kongo

VNdikimi i muzikës jazz në muzikën e lehtë shqiptare gjatë periudhës socialiste (1945 - 1973).....99

3. Santana Xheladini Myftaraj

Muzika në Radio Tirana: Një trashëgimi kulturore.....100

4. Voltan Prodani

Transformimi i procesit krijues të kantautorit përmes teknologjisë moderne muzikore.....101

5. Prof. Dr. Hysen Nimani

Arti dhe kultura e qytetit të Pejës.....102

6. Aulon Naçi

Një studim krahasues midis muzikës polifonike “a tenore” të Sardenjës dhe muzikës iso-polifonike të Labërisë.....103

7. Elvina Koçillari

E qara me ligje në zonën e Labërisë dhe “Gjama” e veriut - tradita të lashta të kulturës shpirtërore shqiptare.....104

8. Arbër Çerri

Roli dhe rëndësia e lahutës, sharkisë dhe çiftelisë si instrumente kordeofone në traditën dhe kulturën muzikore kombëtare shqiptare.....105

Arti protestë - Transformimi vizual nga gjysma e dytë e shekullit të XX deri më sot

Harri Aleksi

harrialeksi@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim hulumtues ngre çështjen e mesazhit vizual që aktivizmi, i ndikuar nga lëvizjet shoqërore dhe politike, i ka përcjellë audiencës dhe vazhdon t'i përcjellë përmes artit pamor gjatë dekadave. Hipoteza në këtë studim synon të demonstrojë se gjuha vizuale e aktivizmit përmes artit protestë ka ndryshuar me kalimin e kohës. Nga një gjuhë paqësore dhe unifikuese, në më të dhunshme e përçarëse dekadave të fundit.

Duke analizuar momente kyçe historike gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX dhe dy dekadave të shekullit të XXI, momente në të cilat arti pamor ka qenë i ndërthurur me aktivizmin, si dhe duke marrë në analizë grupet shoqërore që udhëhoqën ose u ndikuan nga këto momente historike, studimi synon t'u përgjigjet pyetjeve: “Si ka ndryshuar mesazhi aktivist përmes gjuhës pamore gjatë historisë?” “Cilat kanë qenë momentet më domethënëse në të cilat arti pamor dhe aktivizmi kanë qenë të ndërthurur dhe si e ka ndikuar opinionin publik”? “Si mund të evoluojë aktivizmi përmes artit në të ardhmen”? “Cila mund të jetë qasja e shoqërisë në të ardhmen”? “Cilat janë përgjegjësitë e artit pamor në këtë proces”? “Kush flet për artin protestë”?

Në një konfrontim gjithnjë e më të ashpër midis grupeve shoqërore, në një luftë modelesh kulturore, duke përfshirë ato të ambientalizmit, identitetit etnik/racor/gjinor/fetar dhe të të drejtave të njeriut, studimi përpiqet të konkludojë me rëndësinë dhe përgjegjësinë e rolit që ka arti pamor në këtë transformim të pandalshëm. Një rëndësi gjithnjë në rritje, e ndikuar edhe nga teknologjia, e cila po i jep “imazhit” një barrë të konsiderueshme në kulturë, politikë dhe ekonomi.

Fjalë kyçe

lëvizja kundër luftës, arti i rrugës, të drejtat e njeriut, feminizmi, arti i protestës

AI dhe Tipografia Gjeneruese - Një front i ri në dizajn

Kein Katroshi

katroshikein@gmail.com

University of New York, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (AI) dhe algoritmet gjeneruese po revolucionarizojnë artin e tipografisë, duke hapur një kufi të ri të gjerë në dizajn. Ky punim eksploron se si krijimtaria gjeneruese mund të rrisë dizajnin tradicional të fontit, duke mundësuar fleksibilitet dhe personalizim unik në krijimin e fontit. Ky kërkim paraqet një rast studimi të Universal Sans, një platformë gjeneruese tipografike, e vlerësuar me çmime që ilustron konvergjencën e mjeshtërisë së dizajnit dhe inovacionit algoritmik.

Duke analizuar veçoritë tipografike të Universal Sans, aftësitë e drejtuara nga AI, ndërfaqen e përdoruesit, aksesueshmërinë dhe integrimin e elementeve krijuese dhe teknike, kërkimi demonstroi se si tipografia gjeneruese mund të demokratizojë dizajnin e personalizuar të shkronjave pa sakrifikuar cilësinë estetike ose lexueshmërinë. Gjetjet theksojnë se përmes algoritmeve të definuara me kujdes dhe mjeteve të përqendruara të përdoruesit, dizajnerët janë të autorizuar të bëhen bashkëkrijues duke modifikuar format e shkronjave dhe duke eksploruar variacionet stilistike në kohë reale, dhe duke shtyrë përfundimisht kufijtë e komunikimit vizual.

Kjo sintezë e inteligjencës njerëzore dhe makinerive jo vetëm që prodhon shkronja funksionale dhe kohezive të përshtatura për nevoja specifike, por gjithashtu sinjalizon një zhvendosje më të gjerë drejt proceseve më ndërvepruese, gjithëpërfshirëse dhe inovative të projektimit në epokën e AI.

Fjalë kyçe

Inteligjenca Artificiale, tipografia gjenerative, dizajni i fonteve, etika e AI në dizajn

Zanafilla e artit të performancës në Shqipëri - Dy Guliverët

Helidon Gjergji

gjergji7@gmail.com

Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Lindja e artit të performancës në Shqipëri është e lidhur ngushtë me veprën e Flutura Prekës dhe Besnik Haxhillarit, të njohur ndryshe edhe si Dy Guliverët. Qasja e tyre novatore shënoi një ndryshim të rëndësishëm në skenën e artit shqiptar, e cila ishte ndikuar shumë nga realizmi socialist gjatë epokës komuniste. Deri në fillim të viteve 1990, arti shqiptar kontrollohej rreptësisht nga sistemi, që nuk linte aspak vend për shprehje avangardiste apo eksperimentale. Performanca e parë e Dy Guliverëve në Shqipëri u zhvillua në vitin 1998 në Galerinë Kombëtare të Tiranës, duke shënuar një nga momentet kyçe në tranzicionin e vendit drejt formave të artit bashkëkohor.

Vepra e tyre konsiston në një kombinim të vizatimit, performancës dhe artit konceptual, dhe kufijnjtë midis këtyre medimeve shpesh herë janë jo aq të qarta. Vizatimi shërben si një mjet kreativ ashtu edhe dokumentues i performancës së tyre, duke lejuar rishfaqjen dhe reflektimin mbi procesin artistik. Kjo qasje jo vetëm që pruri metoda të reja artistike, por gjithashtu pasqyroi një ndryshim më të gjerë kulturor në Shqipëri, pasi artistët filluan të eksplorojnë tema përtej formave tradicionale të pikturës dhe skulpturës.

Vepra e Dy Guliverëve përfaqëson një vazhdimësi dhe një shkëputje nga traditat artistike shqiptare. Duke përqafuar ndikimet ndërkombëtare e duke ruajtur një perspektivë unike, ata kanë kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e artit bashkëkohor në Shqipëri, duke i hapur rrugën brezave të ardhshëm të artistëve për të eksperimentuar me medime dhe tema të ndryshme.

Fjalë kyçe

performacë, art bashkëkohor, arti shqiptar.

Land Arti si një qasje arkitektonike e qëndrueshme dhe mjedisore për krijimin e hapësirave me identitet

Dr. Dorina Papa

dorinapapa@unyt.edu.al

University of New York, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Land Arti, i perceptuar tradicionalisht si një ndërhyrje artistike në peizazh, paraqitet si një medium i rëndësishëm për krijimin e hapësirës arkitekturore, e cila është njëkohësisht e qëndrueshme në aspektin mjedisor dhe e lidhur thellësisht me peizazhin. Ky kërkim shqyrton mënyrën se si Land Arti mund të kapërcejë qëllimin e tij artistik dhe të ndikojë në krijimin e hapësirave arkitekturore që integrohen në mënyrë harmonike me peizazhin, duke ofruar një alternativë të qëndrueshme ndaj mjediseve të ndërtuara konvencionale.

Duke iu përgjigjur kushteve specifike të kontekstit dhe duke përqafuar parimet e dizajnit të peizazhit, arti i tokës krijon një përvojë hapësinore zhytëse që forcon ndjenjën e vendit. Përmes një analize kritike të projekteve kryesore të artit të tokës dhe karakteristikave të tyre hapësinore, studimi shqyrton se si këto ndërhyrje përcaktojnë karakterin e vendit, kornizojnë pamjet dhe lehtësojnë ndërveprimin njerëzor me peizazhin.

Rastet studimore të veprave të artistëve si A. Goldsworthy, R. Smithson, A. Burri, etj., si dhe arkitektëve bashkëkohorë, ilustrjnë se si arti i tokës funksionon si një formë arkitekturore që mishëron qëndrueshmërinë, ndikimin minimal mjedisor dhe rëndësinë kulturore. Gjetjet sugjerojnë se arti i tokës mund të shërbejë si një model për praktikën e ardhshme arkitekturore, duke promovuar një marrëdhënie simbiotike midis mjedisit të ndërtuar dhe atij natyror, ndërsa forcon identitetin dhe ndjenjën e përkatësisë në një vend. Ky kërkim e pozicionon përfundimisht artin e tokës si një strategji alternative projektimi, e cila rikonceptualizon arkitekturën duke ofruar rrugë inovative për krijimin e qëndrueshëm të vendeve.

Fjalë kyçe

arti i tokës, arkitektura e peizazhit, dizajni i qëndrueshëm, krijimi i vendeve

Konvergenca e artit dhe dizajnit grafik: Një qasje ndërdisiplinore për të përfshirë diversitetin e artit pamor në edukimin e dizajnit grafik

Prof. Dr. Nora Halimi

nora.halimi@unite.edu.mk

Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut

Abstrakt

Nga vetë natyra e tyre, arti dhe shprehjet e tij shpesh u shmangen kufijve të përkufizimeve, kategorizimeve ose interpretimeve specifike, megjithatë në arsim, një kornizë e strukturuar është thelbësore për eksplorim dhe zbatim kuptimplotë.

Koncepti i artit është kompleks dhe i shumëanshëm, ai i referohet një spektri të gjërë përpjekjesh krijuese, performuese që ngjallin përgjigje emocionale, intelektuale ose estetike tek ata që i përjetojnë ato. Nga ana tjetër, dizajni grafik ka një qasje më të orientuar drejt qëllimit dhe komunikimit, shpesh me synim të përhapjes së mesazheve, informacionit, emocioneve dhe ideve në mënyrë vizuale.

Ndërsa sfidat e dizajnit bëhen gjithnjë e më komplekse dhe ndërdisiplinore, edukimi i dizajnit grafik duhet të evoluojë për të përqafuar diversitetin e artit pamor si një komponentë thelbësore e zhvillimit krijues. Ky punim eksploron një kornizë arsimore të ridefinuar që lidh diversitetin artistik dhe të menduarit përmes dizajnit, duke nxitur një mjedis mësimor më gjithëpërfshirës, inovativ dhe kulturalisht më të pasur.

Nëpërmjet strategjive pedagogjike, të tilla si përmirësimi i kurrikulës, mësimi i bazuar në studio, eksperimentimi artistik, angazhimi në industri dhe komunitet, etj., ky punim thekson se si kjo qasje ushqen të menduarit kritik, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe ndërgjegjësimin social në edukimin e dizajnit.

Në një epokë ku qëndrueshmëria është një domosdoshmëri globale, edukimi i dizajnit grafik duhet të evoluojë për të integruar artet pamore, në mënyrë që institucionet të mund t'i përgatisin studentët të shtyjnë kufijtë krijues dhe të formësojnë të ardhmen e komunikimit vizual.

Fjalë kyçe

të menduarit në dizajn, komunikimi vizual, sfidat arsimore.

Interaktiviteti si një dimension i ri artistik: Video Games vs. Artet Tradicionale

Joan Ikonomi

j.ikonomi@umb.edu.al

Universiteti Barleti, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Arti ka qenë gjithmonë i përcaktuar nga aftësia e tij për të shkaktuar emocione, për të transmetuar kuptim dhe për të pasqyruar narrativa kulturore të ndryshme. Format tradicionale të artit—piktura, skulptura, letërsia, muzika dhe kinemaja—kanë qenë historikisht përvoja pasive, që mundësonin interpretime të ndryshme, por me një pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të kufizuar. Ndryshe nga artet tradicionale, video lojërat përdorin interaktivitetin si një komponent thelbësor artistik, duke i mundësuar audiencës të marrë pjesë në përvojën krijuese, në vend që të jenë thjesht vëzhgues pasivë. Ky kërkim shqyrton se si interaktiviteti mundëson krijimin e një shprehjeje të re artistike, duke krahasuar video lojërat me format tradicionale të artit në aspektet e kompozimit, rrëfimit të historive, përvojës imersive dhe ndikimit emocional.

Duke analizuar raste studimore të disa video lojërave, përfshirë aspektet e estetikës vizuale, thellësinë e narratives, kompozimin muzikor etj., dhe duke i krahasuar me veprat klasike dhe bashkëkohore të pikturës, letërsisë dhe filmit, ky studim synon të tregojë se si video lojërat përfshijnë disa disiplina artistike në një medium interaktiv. Studimi do të diskutojë gjithashtu pasojat e veprimit të lojtarit, rrëfimit dhe mekanikës së lojës si mjete të reja artistike që zgjerojnë kufijtë e autorësisë artistike. Për më tepër, punimi shqyrton se si lojërat video sfidojnë përvojat estetike tradicionale duke integruar kohën, hapësirën dhe pjesëmarrjen e përdoruesit në kornizën e tyre artistike.

Në fund, ky studim argumenton se interaktiviteti përfaqëson një ndryshim transformues në angazhimin artistik, duke rikonfiguruar jo vetëm rolin e artistit, por edhe rolin e audiencës. Ditët e sotme, ndersa video lojërat po fitojnë njohje në institucionet kulturore dhe në diskursin akademik, ndikimi i tyre në evoluimin e artit ngre pyetje të reja në lidhje me autorësinë, përvojën zhytëse dhe të ardhmen e shprehjes krijuese në epokën digjitale.

Fjalë kyçe

mediat e reja, forma të artit multidisiplinar, pjesëmarrja e përdoruesit, rrëfim digjital.

Arkitektura si një përvojë ndijore dhe artistike: Një analizë fenomenologjike përtej funksionalitetit

Vlerë Mulliqi

v.mulliqi@ibcmirovica.eu

Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë, Kosovë

Abstrakt

Arkitektura nuk kufizohet vetëm me funksionin e saj utilitar, por ka potencial të shndërrohet në një formë arti që ndikon në përvojën ndijore dhe emocionale të përdoruesve. Ky studim shqyrton sesi qasja fenomenologjike në arkitekturë mund të përmirësojë perceptimin hapësinor, duke tejkaluar rolin e saj si strehë dhe duke krijuar eksperiencë estetike dhe emocionale më të thella. Hulumtimi shqyrton ndikimin e elementeve si drita, materialet dhe ngjyrat në hapësira dhe se si këto aspekte formojnë perceptimin dhe përvojën e përdoruesve.

Hipoteza e këtij studimi është se integrimi i parimeve fenomenologjike në dizajnin arkitektonik përmirëson përvojat ndijore dhe emocionale të përdoruesve, duke krijuar hapësira që kontribuojnë në mirëqenien e tyre përtej funksionit të thjeshtë utilitar.

Metodologjia përfshin një analizë vizuale dhe ndijore të disa ambienteve të dizajnuara nga autori, përmes të cilave vlerësohet ndikimi i elementeve arkitekturore dhe dizajni në përvojën perceptivë dhe emocionale të individëve. Pjesëmarrësit do të jenë të ftuar të shprehin opinionet e tyre në lidhje me ndikimin që kanë këto hapësira në ndjesitë dhe perceptimet e tyre, duke mundësuar mbledhjen e të dhënave për të kuptuar se si arkitektura mund të formojë përvoja të thella ndijore dhe emocionale.

Rezultatet tregojnë se ky studim kontribuon në diskursin mbi rëndësinë e ndërlidhjes mes artit dhe arkitekturës, duke theksuar potencialin e hapësirave që shkojnë përtej funksionalitetit për të krijuar përvoja estetike dhe shpirtërore. Përfundimet dhe rekomandimet synojnë të inkurajojnë arkitektët dhe dizajnerët që të konsiderojnë aspekte fenomenologjike në procesin e krijimit të hapësirave, duke i trajtuar ato si mjete për të promovuar mirëqenien dhe frymëzimin e përdoruesve.

Fjalë kyçe

arkitektura si art, fenomenologjia në arkitekturë, dizajni sensorial, përvoja emocionale, hapësira dhe mirëqenia

Metodat tradicionale dhe bashkëkohore në dokumentimin dhe restaurimin e veshjeve tradicionale

Alkida Boshnjaku, Prof. Asoc. Dr. Taulant Pustina
alkida.boshnjaku@yahoo.co, taulant.pustina@uart.edu.al
Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ruajtja e veshjeve tradicionale është shumë e rëndësishme për trashëgiminë kulturore, pasi është e lidhur ngushtë me historinë, identitetin dhe mjeshtërinë e një shoqërie. Megjithatë, këto veshje përballen me kërcënime të konsiderueshme, si degradimi i materialeve, ruajtja e papërshtatshme dhe humbja e aftësive mjeshtërore të punimit të tyre.

Problemi kërkimor i këtij studimi është nevoja për dokumentimin dhe restaurimin e duhur të veshjeve tradicionale. Qëllimi është të eksplorojnë metodat e dokumentimit dhe restaurimit, si dhe sfidat që hasen. Objektivat përfshijnë identifikimin dhe analizimin e metodave tradicionale dhe bashkëkohore të dokumentimit dhe restaurimit të veshjeve tradicionale. Pyetja kërkimore është: Si ndikojnë avancimet teknologjike në dokumentimin dhe restaurimin e veshjeve tradicionale? Hipoteza e studimit sugjeron se: përdorimi i teknologjive të avancuara përmirëson saktësinë e dokumentimit dhe restaurimit.

Ky artikull paraqet një rishikim të literaturës duke përdorur të dhëna dytësore si artikuj shkencorë, konferenca, libra, raporte dhe studime. Gjetjet theksojnë se teknologjitë, si skanimi 3D, imazheria multispektrale dhe arkivimi digjital, përmirësojnë dokumentimin dhe restaurimin e veshjeve. Megjithatë, ekzistojnë çështje etike të lidhura me mënyrën dhe nivelin e ndërhyrjes. Prandaj, është e nevojshme bashkëpunimi ndërmjet konservatorëve, historianëve dhe teknologëve për një ruajtje më të mirë të veshjeve.

Fjalë kyçe

veshje tradicionale, ruajtja, sfida, ndërhyrja, bashkëpunimi

Dinastia e Zengove, krijimtaria ndër breza prej dy shekujsh

Fjoralba Prifti, Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

prifti.fjoralba@gmail.com, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar

mikeltemo@gmail.com, Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Artistë, piktorë, fotografë dhe ikonografë të cilët lanë gjurmë me veprat e tyre në historinë e artit dhe njëkohësisht u bënë pjesë e trashëgimisë kulturore. Fundi i shek. të 19-të dhe fillimi i shek 20-të sollën një zhvillim të madh në ikonografinë shqiptare ku vend tepër të rëndësishëm zënë një grup artistësh nga fshati Dardhë, Korçë.

Në këtë periudhë ikonografia pati ndryshime rrënjësore duke dalë nga rregullat e pandryshueshme bizantine. Artistët e kësaj periudhe filluan të trajtonin skenat biblike dhe shenjtoret me më shumë vërtetësi dhe më pranë realitetit duke futur vëllim dhe ngjyra, ku me të njëjtin përkushtim dhe detaje trajtohej figura qendrore por edhe sfondi apo peisazhi. Ikonat nuk ishin më dydimensionale, por ishin më pranë paraqitjes së pikturave me tema fetare të rilindasve italianë apo dhe autorëve të njohur evropianë, të cilat herë pas here kopjoheshin me rigorozitet. Dinastia Zengo, fillon me Nikolla Zengon (i vjetri) shek. 18-të, vazhdon me përfaqësuesin kryesor, Vangjel Zengo, i cili ka patur një krijimtari të madhe dhe njëkohësisht ndikoi në formimin dhe edukimin artistik të motrave Zengo, vajzave të tij, të cilat e pasuan denjësisht. Brezat e familjes Zengo, kanë dominuar pikturën ikonografike, murale, por edhe laike dhe kanë qenë pjesë e drejtëpërdrejtë e këtyre ndryshimeve të rëndësishme në ikonografi dhe në artin bizantin duke u bërë shembull dhe për artistët e tjerë bashkëkohorë.

Në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, ruhen një numër i lartë veprash të realizuara nga artistët ikonografë dardharë, ku vendin më të madh e zënë veprat e Zengove.

Fjalë kyçe

dinastia Zengo, arti bizantin, piktura ikonografike, influenza kulturore

Restaurimi, fillesa e mbarëvajtjes shekullore të trashëgimisë kulturore

Kleida Gjata

kleidia_95@hotmail.com

Piktor & Restaurues Monumental - Dekorativ

Abstrakt

Restaurimi i veprave të artit është një proces thelbësor për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të çdo kombi. Ky proces ka evoluar ndër kohë, duke kaluar nga përdorimi i teknikave tradicionale në aplikimin e metodave moderne dhe teknologjive të avancuara. Restaurimi synon të mbrojë dhe ruajë integritetin estetik dhe autenticitetin historik të veprave, duke parandaluar degradimin e mëtejshëm dhe duke siguruar që vlerat kulturore të tyre të mbeten për brezat e ardhshëm.

Krahasimi i dy proceseve restaurimi dhe ripunimi : janë dy procese të ndryshme, ku restaurimi përqendrohet në ruajtjen e elementeve origjinale të veprës, ndërsa ripunimi përpiket të krijojë një kopje të një objekti të humbur ose të dëmtuar. Ky studim shqyrton zhvillimin e restaurimit të veprave të artit në Shqipëri, me fokus të veçantë në restaurimin e një pikturë të njohur nga artisti Nexhmedin Zajmi. Restaurimi i kësaj pikturë paraqet një shembull të qartë të sfidave dhe teknikave të përdorura në fushën e konservimit, duke përfshirë ndikimin nga ruajtja në kushte të pafavorshme dhe ndikimin klimatik.

Ky proces kërkon një qasje delikate për të ruajtur sa më shumë elemente origjinale dhe për të ndihmuar që vepra të ruhet pa humbur identitetin e saj. Përfundimisht, ky studim thekson rëndësinë e restaurimit për ruajtjen e pasurisë kulturore të Shqipërisë dhe nevojën për investime më të mëdha në këtë fushë. Restaurimi nuk është vetëm një proces teknik, por gjithashtu një mjet për të ruajtur dhe transmetuar identitetin dhe vlerat kulturore të një kombi.

Fjalë kyçe

Nexhmedin Zajmi, konservim, konsolidim, integrim estetik

Veshja popullore, kostumet e zonave veriore të Shqipërisë, ndikimet nga kultura orientale për shekuj me radhë

Elona Nallbani

elonanallbani@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Kultura Bizantine dhe Orientale ka ushtruar për një kohë të gjatë një veprim deri diku nivelues në veshjen e popujve ballkanikë, kryesisht në shtresat më të larta të shoqërisë së kohës, tek e cila rrezatimet e modës së Bizantit arrinin më lehtë. Me kohë disa rrezatime të zbehura të luksit të rënduar të këtyre veshjeve, mundën të depërtojnë edhe në veshjet popullore si psh., parapëlqimi i përdorimit të ngjyrave, e kuqja, manushaqja dhe e gjelbra, dëshira për të imituar zbukurimet e rënduara në ar, zgjatja e mëngëve ose e mëngëve dekorative në shpinë.

A ka ndikime në kostumet e popujve të tjerë nga kostumet tona popullore? Veshjet shqiptare të periudhës së Lidhjes së Prizrenit në vitet 1878 dhe me pas, sidomos veshjet e luftëtarëve të asaj kohe, janë paraqitur me mjaft vërtetësi në shkrime e botime dhe kjo gjë ka shërbyer për t'i bërë ato më të njohura në Evropën e asaj periudhe.

Në veshjet tona popullore vemë re se elementet që mbulojnë pjesën e sipërme të trupit janë disi më uniforme, ndërsa ato që mbulojnë pjesën e poshtme janë më të shumëllojshme si nga format e prerjes, ashtu edhe nga përbërja e materialit. Duke mbajtur karakterin historik të veshjeve, zhvillimin deri në një lulëzim të plotë të pjesëve kryesore, pastaj rënien dhe zëvendësimin e tyre me të reja ose mbijetesën në formë gjurmësh të zbehta krahas elementit të ri, do të kuptojmë se si janë shndërruar ato, nga një brez në tjetrin. Zëvendësimet e plota të kostumeve janë të rralla. Ato janë vërtetuar vetëm në raste kthesash të mëdha shoqërore. Ka ndodhur shumë herë që në të njëjtën krahinë të bashkëjetojnë dy ose më shumë tipe veshjesh. Një shembull i qartë është në Fushën e Zadrimës ku gjejmë kostume të Malësisë së Madhe, të Mirëditës, të Rranzave e të vetë Fushës së Zadrimës.

Në përfundim, veshjet tradicionale të Veriut të Shqipërisë janë një simbol i qëndrueshmërisë, traditës dhe identitetit kombëtar, duke pasqyruar një kulturë ku historia, lufta dhe zakonet janë ndërthurur në mënyrë të veçantë.

Fjalë kyçe

traditë, trashëgimi kulturore, tipologji veshjesh

Dasma tradicionale në Has-Shqipëri

Klevisa Gaxha

klevisagaxha@gmail.com

Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë, Kosovë

Abstrakt

Ky studim synon të paraqesë ritet e dasmës hasjane ndër vite. Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza e traditave dhe riteve të dasmës së vajzës hasjane dhe djalit hasjan. Ky studim fokusohet në mënyrën se si këto tradita janë ruajtur dhe praktikuar, si dhe në ndikimin që ato kanë pasur në shoqërinë e Hasit. Kjo ruajtje e riteve dhe zakoneve e shoqëruar nga një pasion i dukshëm, vazhdon të jetë e pranishme edhe në ditët e sotme, ku shumica e riteve, dokeve dhe zakoneve trashëgohen brez pas brezi.

Ky hulumtim analizon procesin e martesës, duke filluar nga dhënia e fjalës, deri tek finalizimi i ceremonisë. Po ashtu, do të shqyrtohen disa aspekte të tjera të rëndësishme të dasmës hasjane, përfshirë lojërat, vallëzimet dhe këngët që shoqërojnë mbrëmjet e dasmës.

Një aspekt tjetër që do të trajtohet është qejzi i vajzës, i cili punohej me dorë ose me vek. Hulumtimi gjithashtu do të trajtojë kostumografinë e dasmës hasjane, kostumet tradicionale dhe ruajtjen e tyre deri më sot. Po ashtu, do të analizohen rregullat që ndiqen gjatë ceremonisë.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është metoda empirike, pasi hulumtimi realizohet në mjedisin e tij. Ky studim synon të ndihmojë në dokumentimin e trashëgimisë kulturore të Hasit dhe ruajtjen e traditës hasjane.

Fjalë kyçe

dasma hasjane, kostumografia, ritet, zakonet

Piktura bizantine-post bizantine

Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo

mikeltemo@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi dhe objekti këtij studimi do të jetë njohja dhe prezantimi i ikonografisë bizantine dhe pikturës murale, të cilat përfaqësojnë një aspekt të rëndësishëm të jetës kulturore dhe fetare për botën e krishterë ortodokse lindore. Dallimet stilistike midis artit bizantin, artit grek, sllav dhe artit shqiptar, janë të dukshme jo vetëm në ndikimet estetike, por edhe në kontekstin historik, në marrjet dhe dhëniet e motiveve, si dhe në ndikimet kulturore dhe ato fetare.

Pyetja shkencore do jetë: A gjejmë elemente ndikuese nga vendet e tjera fqinje, në artin bizantin shqiptar?

Për hir të së vërtetës, tiparet stilistike të pikturës murale shqiptare shpesh pasqyrojnë një përzierje të ndikimeve bizantine lokale, ku fokusi bie në qartësinë narrative dhe shprehjen emocionale. Rezultatet e këtij studimit do të përqëndrohen në një raport krahasues gjithëpërfshirës të traditave të artit bizantin grek, sllav dhe shqiptar, duke vënë në dukje, stilet, teknikat dhe kulturën e veçantë të tyre.

Veçoritë unike të secilës traditë, do të pasqyrojnë edhe zhvillimet historike dhe fetare për secilin vend dhe kulturën e tyre përkatëse. Ikonografia bizantine është e pasur me elementë simbolikë, ku çdo ngjyrë, gjest dhe objekt ka kuptim të thellë shpirtëror. Zbërthimi dhe analizimi i elementëve simbolikë në artin bizantin, sllav dhe shqiptar, përbëjnë edhe esencën kulturore dhe artistike për secilin rast studimi.

Përfundimet do të jenë të bazuara në studimin dhe krahasimin e ndikimeve historike, fetare, kulturore dhe artistike, të cilat çuan në rritjen dhe zhvillimin artistik të artit bizantin grek, të artit bizantin sllav dhe të artit bizantin shqiptar. Përzirja e ndikimeve ortodokse, katolike dhe osmane krijuan një gjuhë unike vizuale, që theksonte qëndrueshmërinë, identitetin dhe përkushtimin shpirtëror.

Fjalë kyçe

ikonografia bizantine, ndikimet kulturore/fetare, kisha ortodokse, ndikimet bizantine-post bizantine, lindje-perëndim

Interesimi i piktorëve të Rilindjes Kombëtare për etnografinë

Dr. Edmond Muço

edmondmuco3@gmail.com

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri

Abstrakt

Artikulli ka si objekt dhe qëllim të sjellë krijmtarinë e piktorëve të rilindjes kombëtare , si Kol Idromeno, Spiro Xega , Simon Rrota etj . Këta piktorë të kësaj periudhe kanë dhënë një kontribut të veçantë në paraqitjen e vlerave, kulturave artistike të veshjeve popullore dhe elementeve të tjera etnografike . Sipas studimeve etnografike veshjet popullore mbeten një nga dëshmitë dhe manifestimet më të fuqishme krijuese të artit popullor.

Piktura e re shqiptare, që në krijimet e para është mbështetur dhe ka shfrytëzuar në masë të madhe veshjet popullore dhe elemente të ndryshme etnografike. Kjo ka ndodhur për një periudhë të gjatë dhe për shumë arsye që lidhen me zhvillimet historike shoqërore .

Piktura shqiptare nuk mund të perceptohet ndryshe, pa atë lidhje dhe bashkëpunim të ngushtë të saj me veshjen tradicionale apo elementet etnografike në tërësi. Kjo lidhje i ka shërbyer që të pasurojë elementet dekorative, ngjyrën, motivet dhe subjektet duke e kthyer në një pikturë me karakteristika tradicionale.

Arti popullor ka luajtur një rol të veçantë sidomos në historinë e kulturës artistike, sepse për mijëra vjet me radhë ka qenë e vetmja traditë artistike me vijueshmëri të pandërprerë. Rrethanat historike të papërshtatshme në të kaluarën e largët nuk lejuan krijimin e një arti të ri.

Elementet e ndryshme etnografike shqiptare kanë tërhequr vëmendjen edhe tek piktorët e Rilindjes Kombëtare. Madje këto elemente kanë ndikuar ndjeshëm në pasurimin e mëtejshëm të vlerave artistike dhe ideore të tyre. Artistët e kësaj periudhe kërkonin që me pasqyrimin e subjekteve etnografike, të evidentonin qartë specifikat e veçanta etnike.

Për efekt studimi do të analizojmë veprat më përfaqësuese të tyre, ku raporti midis etnografisë dhe artit të pikturës është shfrytëzuar në mënyra të ndryshme në funksion të vlerave ideo artistike të veprës.

Fjalë kyçe

etnografia shqiptare, arti popullor, veshjet popullore, piktorët Shqiptarë

Një histori e shkurtër e institucioneve artistike Shqiptare

Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha

ermirhoxha@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Rrugëtimi i institucioneve artistike në Shqipërinë e shekullit të XX, ishte një eksperiencë dinamike e një lloji të veçantë. Kuptimi i saj nis fillimisht me vendosjen e saj në kontekst kohor, fillimisht në Shqipërinë ende pjesë e Perandorisë Osmane, e më pas me përpjekjet për institucione të mirëfillta, në strukturën e brishtë të monarkisë shqiptare. Kështu mes Shkollës së Saverio Polarollit, asaj të vizatimit dhe më pas të Liceut artistik Jordan Misja e Institutit të Artit Figurativ, duket se ka kaluar një stafetë jo domosdoshmërisht lineare, e aq më pak një stafetë institucionale, e cila duket se është thjesht shkak pasojë e dinamikave politike e kulturore që shoqëruan vendin në gjithë fazën e vet institucionale.

Historia e institucioneve artistike shqiptare, në esencë është pasqyrë e asaj dinamike të fortë që përshkoi një vend në ndërtim e sipër. Ajo u zhvillua paralelisht në gjithë formatet e mundëshme, duke u përshtatur me atë realitet që gjeti. Si e tillë kjo histori institucionale me gjithë ngjyrat dhe kërshtërinë e vet, nuk është gjë tjetër veçse një histori tjetër e shekullit XX. Ajo padyshim përtheu gjithë vullnetet, apo ambiciet e një brezi intelektualësh për një at-mosferë artistike të çliruar nga vullneti politik, duke u shndërruar në një mënyrë apo tjetër në një instrument për implementimin e vetë pushtetit.

Fjalë kyçe

historia e artit, institucionet artistike, shkolla e vizatimit, liceu artistik, instituti i lartë i arteve

Disa fillesa të pranisë së trupit të zhveshur (nudos artistike) në artin laik shqiptar

Dr. Agron Mesi

mesiagron@gmail.com

Akademia e Shkencave, Tiranë, Shqipëri.

Abstrakt

Punimi merr në trajtesë disa nga momentet e para të shfaqjes së trupit të zhveshur (nudos artistike) në artin laik shqiptar. Kjo prani e nudos, fillimisht e pjesshme dhe e ndrojtur, do të bëhet prezente me mediumin e fotografisë në fundin e shek. XIX dhe në fillimin e shek. XX.

Në vijim, trupi i zhveshur në artin shqiptar na vjen si pjesë e eksplorimeve të plota dhe të thelluara shkollore të studentëve të parë shqiptarë që do të ndjekin akademitë e arteve në Evropë në vitet '10, '20. Moment i rëndësishëm historik fillese janë dhe trajtimi i parë i nudos nga piktorët shqiptarë në krijimtarinë e tyre të lirë pas studentore, si dhe modelja e parë shqiptare që pozon nudo për artistin. Gjithashtu do të synohet t'i japim përgjigje pyetjeve se kur vërehet për herë të parë në Shqipëri prania e nudos si pjesë e artit në hapësirat e jashtme, si dhe ekspozimi për publikun e gjërë i veprave me subjekt nudon.

Qasja studimore, për vetë qëllimin që ka shkrimi (prezantimin e disa fillesave), do të operojë duke ndjekur dhe shtjelluar në vijimësi kronologjike këto ngjarje e dimensione të para të trajtimit të nudos në artin laik shqiptar, të cilat na dëshmojnë për praninë gjithnjë e më shumë të frymës perëndimore në kulturën urbane shqiptare, duke filluar nga fundi i shek. XX e vijuar deri në mesin e viteve '40 të shekullit pasardhës.

Fjalë kyçe

mediumi i fotografisë, studimi akademik, krijimtaria e lirë, ekspozimi në publik

Tabutë dhe vuajerizmi si (auto)censurë e trajtimit të trupit femëror në artet pamore shqiptare

Prof. Dr. Jëlldës Asani

jelldes.asani@unite.edu.mk

Universiteti i Tetovës, Fakulteti i Arteve, Maqedonia e Veriut

Abstrakt

Procesi i semantizimit të trupit të femrës gjatë historisë u bë arsye për studimin e temës në vijim. Nëpërmjet këtij artikulli do të trajtojmë statusin estetik të trupit femëror në traditën arteve pamore (me theks të veçantë në artet figurative) shqiptare. Gjithashtu do të fokusohemi tek analizat teorike e implikimeve historike, ideologjike, sociale dhe kulturore me të cilat përballen, si artistët, ashtu edhe, studiuesit shqiptar, kur është në pyetje trajtimi i trupit të femrës, qoftë ai si objekt tematik apo edhe si subjekt artistik.

Të udhëhequr nga përvojat dhe praktikatat e teorisë dhe historisë së artit botëror, do të fokusohemi kryesisht tek arti shqiptar, që trupin femëror (gjykuar nga qasjet feministe dhe poststrukturaliste) e frenon dhe e shndërron atë në një motiv seksual artistik! Në artin shqiptar, kjo ka ndodhur edhe në të kaluarën, por vazhdon të ndodhë edhe sot. Pra, edhe pas shfaqjes së arteve të performancës në gjysmën e dytë të shekullit 20 - të, nuk u arrit “çlirimi” i vërtetë i trupit të femrës nga barra semiotike e nivelit të kulturës artistike dhe mentalitetit provincial të popullit shqiptar.

Të vetëdijshëm se trupi i femrës vazhdon të mbetet një nga temat më të diskutueshme në artet pamore, i cili po nxit debate të thella, shpesh të lidhura me tabutë shoqërore, objektivizmin dhe vuajerizmin, do të përpiqemi për t’i demontuar stereotipet dhe normat retrograde të “shoqërive” shqiptare. Në këto “shoqëri” të përcjella me shtresime dhe deformime (sub)kulturore, me amoralitet dhe moral të shumëfishtë, prezenca e sektarizmave të ndryshme fetare dhe ideologjike shfaqin edhe hamendësime në planin artistik. Për më shumë, tërë këto komponentë të pafavorshme e ushqejnë dhe mbajnë gjallë edhe (auto)censurën qoftë gjatë procesit krijues, por edhe në planin teorik dhe shkencor.

Nëpërmjet shembujve konkret të artit botëror, por në masë të madhe, të veprave të artistëve shqiptar, pa dallim gjinie, do ta ndërtojmë narracionin e këtij diskursi, të cilin nuk do ta bazojmë vetëm te normat e seksizmit, por edhe te stereotipitë dhe paragjykimet mbi trupin e femrës, qoftë si tematikë, apo qoftë si motiv artistik. Kjo është nevojë imediate për artin shqiptar, sepse, përjetimi i një vepre artistike pamore, gjithmonë është e varur nga një mori supozimesh shkencore rreth artit, që do të thotë se, me këtë rast do të identifikohen edhe faktorë të ndryshëm socio-politikë, që rrethojnë veprën që shikohet, si dhe personin që e vlerëson atë.

Fjalë kyçe

arti, tabutë, seksizmi, femra, pengesat, diskutimet kulturore

Arti tekstil në bashkëkohësi

Dr. Merita Toçila

galeri.info@yahoo.com

Universiteti Politeknik, Departamenti i Tekstilit dhe Modës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Punimet në tekstil studiohen sot si një nga format më të vjetra të artit. Tek ne janë përfshirë në folklor e etnografi të emërtuar si zeje apo artizanat dhe nuk kanë qenë objekt studimi në art. Ndërsa në kategorizimin e artit të aplikuar, arti tekstil jo gjithmonë është vlerësuar në shkallën që duhet dhe vonë ka nisur të marrë vëmendjen që i takon. Artistët shqiptarë e kanë përfshirë punën e dorës dhe zejen në hulumtimet e tyre, kanë zbërthyer teknikat dhe organizimin ornamental për ta interpretuar më pas në vepra. Këto janë kryer duke përdorur pëlhura, fibra a fije nga burime natyrore ose materiale të tjera sintetike dhe trajtesat variojnë nga aplikimi i imazheve dhe figurave deri te forma, relieveve dhe kompozimeve abstrakte zbatuar mbi sipërfaqe, forma skulpturale apo instalacione. Veprat e realizuara dëshmojnë se duke shfrytëzuar mjetet e shumta artistike dhe arkivin e pasur që ofron tradita shqiptare, ka mundësi të pafundme për të krijuar me pëlhurën, fijen, aksesorë tekstili dhe teknikat e punimit me dorë.

Në rrezikun e zhdukjes së artefakteve të trashëguara nga e kaluara dhe harrimit a deformimit të teknikave të vjetra nga artizanë me njohuri të cunguara rreth traditës që ushtrojnë veprimtari artizanale sot, por edhe nga tendenca e globalizimit të kulturës popullore, artistët e pasionuar të tekstilit po e ridimensionojnë lidhjen art dhe artizanat me ndërthurjen e zejeve me artin. Krijimtaria e tyre reflekton aspekte të kulturës dhe identitetit kombëtar dhe shpalos marrëdhënien midis artit bashkëkohor tekstil dhe vazhdimësisë së historisë së tekstilit në hapësirën mbarëshqiptare. Procesi i ekzekutimit zhvillon gjithashtu modele të reja për transferimin e dijeve dhe njohurive rreth trashëgimisë te brezat e rinj dhe nxit eksplorimin e mundësive të zbatimit të artit tekstil në shoqëri dhe më tej.

Fjalë kyçe

art pamor, moda, dizajn

Arti në hapësirat publike: skulptura si mjet edukativ në Shqipëri

Dr. Kujtim Halili

kujtim_halili@universitetipolis.edu.al

Universiteti POLIS, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Gjatë shekullit të 20-të, skulptura shqiptare pësoi transformime të rëndësishme, duke u larguar nga ikonografia tradicionale fetare drejt skulpturës moderne publike dhe përkujtimore. Vitet 1920 dhe 1930 shënuan një periudhë kyçe në këtë zhvillim, të karakterizuar nga rritja e portretizmit politik dhe përfaqësimi monumental i figurave kombëtare. Të ndikuara nga traditat akademike evropiane dhe estetika neoklasike, këto skulptura luajtën një rol thelbësor në formësimin e identitetit kombëtar. Megjithatë, liria krijuese shpesh kufizohej nga faktorë politikë dhe ekonomikë. Kostot e larta të materialeve si mermeri dhe bronzi, të kombinuara me regjimet autoritare, çuan në komisione të kontrolluara nga shteti që diktonin drejtimin artistik. Shumë konkurse përfunduan me projekte të parealizuara, duke lënë pas një koleksion të vlefshëm skicash dhe modelesh në allçi për analizë historike.

Një numër i konsiderueshëm monumentesh publike u krijuan nga skulptorë të huaj – kryesisht italianë, kroatë dhe rusë – kontributet e të cilëve mbeten ende të nënvlerësuara në narrativën e historisë së artit. Këto monumente, zakonisht të realizuara në bronz për potencialin e tyre ekspresiv ose në mermer për madhësinë neoklasike, ishin konceptuar për të qëndruar si simbole të përhershme të pushtetit dhe kujtesës. Skulptura monumentale e motivuar politikisht u bë një mjet dominues propagande, duke përforcuar ideologjitë shtetërore dhe duke ndërtuar një mitologji heroike kombëtare.

Pavarësisht kufizimeve buxhetore, qytetet shqiptare panë përhapjen e statujave dhe veprave përkujtimore, duke i shndërruar hapësirat urbane në narrativë vizuale të krenarisë kombëtare. Ky studim, i bazuar në hulumtime arkivore dhe analiza krahasimore, nxjerr në pah ndërthurjen mes artit, politikës dhe identitetit kulturor në skulpturën shqiptare të periudhës ndërmjet dy luftërave. Gjetjet nënvizojnë rolin e dyfishtë të këtyre monumenteve si shprehje artistike dhe instrumente politike, duke zbuluar dinamika komplekse që formësuan artin publik në Shqipëri. Kërkimet e ardhshme duhet të eksplorojnë më tej kontributet e artistëve të huaj dhe implikimet socio-politike të skulpturës monumentale në rajon.

Fjalë kyçe

portrete politike, kombëtare, identitet, monumental, propagandë

Vepra stilistike e piktorit Abdurrahim Buza

Dr. Ervin Meniko

emeniko@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Me origjinë nga Gjakova dhe lindur në qytetin e Shkupit, profesor Abdurrahim Buza filloi një rrugëtim akademik që e çoi në Akademinë e Arteve të Bukura në Firence, ku u specializua në pikturën monumentale. Indikacionet e para të lidhjes së thellë shpirtërore me rrënjët e tij shqiptare dhe trashëgiminë kulturore u shfaqën herët në karrierën e tij akademike, veçanërisht nëpërmjet ekzekutimit të afreskeve monumentale në Itali, të ndërmarra si pjesë e studimeve të tij formale. Me mbarimin e shkollimit dhe kthimin në vendlindje, Buza u angazhua thellë në prodhimtarinë artistike. Përveç përkushtimit të tij të përjetshëm në vizatim, ai krijoi një gamë të gjerë veprash që trajtonin tematika të lira si dhe ato tema që pasqyronin momente të rëndësishme historike, si Lufta Antifashiste dhe rindërtimi i kombit.

Vlera artistike dhe stilistike e piktorit A. Buza, përbën një nga shembujt më tipikë të aleancës mes artit dekorativ popullor dhe artit të kultivuar. Duke marrë frymëzim nga thellësia e burimeve folklorike, Buza zhvilloi një gjuhë vizuale të veçantë që përcakton veprën e tij. Veprat e tij përfshijnë elemente etnografike si kostumet tradicionale, motive nga punimet e drurit dhe shprehje të vallëzimit folklorik, të cilat të gjitha artikulojnë përmes një ndjeshmërie të rafinuar kompozicionale dhe kromatike.

Dimensioni etnografik i veprës së Buzës ofron një burim të vlefshëm frymëzimi për artistët në zhvillim, duke propozuar një kornizë dialogu midis trashëgimisë kulturore dhe shprehjes artistike bashkëkohore. Kjo aleancë midis traditës dhe modernitetit, nëse ushqehet, ka potencialin për t'u transmetuar në mënyrë kuptimplote brezave të ardhshëm.

Fjalë kyçe

vlera artistike, krijimtari, piktura, tematika, Abdurrahim Buza

Skulptura Shqiptare në hapësirën publike gjatë shekullit të 20-të

Blerina Pagria, Prof. Sadik Spahija

blerinapaglia@gmail.com, sadik_spahija@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Skulptura shqiptare është një nga format më të rëndësishme të arteve vizuale në Shqipëri. Ajo shfaqet para publikut si një reflektim i zhvillimeve kulturore, politike dhe sociale të vendit. Për shumë studiues, skulptura ka ngjallur interes studimi për aspekte të ndryshme. Fokusi i këtij studimi është evoluimi i skulpturës shqiptare në hapësirën publike gjatë shekullit të 20-të, roli i saj në përfaqësimin e ideologjive apo ndryshimeve shoqërore, siç ishte rasti me realizmin socialist në Shqipëri, ku skulpturat e heronjve dhe të punëtorëve ishin të pranishme kudo në hapësira publike. Metodologjia kërkimore e përdorur për këtë studim do të jetë ajo cilësore. Të dhënat e mbledhura do të jenë përshkruese. Burimet e të dhënave do të jenë studimet e kryera, shkrimet, dokumente historike, dorëshkrime, intervista, artikuj të shkruar si dhe materiale filmike. Studimi do të përqëndrohet në analizimin e disa veprave kryesore në skulpturë.

Pyetjet kërkimore: Si ka evoluar simbolika e skulpturës publike në kontekste të ndryshme historike dhe kulturore? Cili është roli i skulpturës publike në ruajtjen dhe ndërtimin e kujtesës historike?

Hipotezat: Simbolika e skulpturës publike ka evoluar në përputhje me ndryshimet shoqërore, politike të periudhave të ndryshme, duke shërbyer si mjet për të reflektuar dhe shpërndarë vlera, ide të caktuara në kontekste të ndryshme historike. Skulptura publike luan një rol kyç në ruajtjen dhe ndërtimin e kujtesës historike.

Skulptura publike shqiptare gjatë shekullit të 20-të ka pasur një zhvillim të ngushtë, të lidhur me ndryshimet politike dhe shoqërore që ka kaluar Shqipëria.

Fjalë kyçe

histori, simbolik, kujtesa, skulptura shqiptare.

Makbethi: Një ndërhyrje eksperimentale mbi skenën e vrasjes së mbretit Duncan

Qëndrim Rijani, Agron Vrangalla

qendrimrijani@gmail.com, Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri
agron.vrangalla@unt.edu.mk, Universiteti “Nënë Tereza”, Shkup, Maqedoni e Veriut

Abstrakt

Ky punim paraqet një vëzhgim kërkimor të udhëhequr nga praktika regjisoriale e zbatuar gjatë vënies në skenë të veprës Makbeth të Shekspirit, specifikisht skena e vrasjes së Mbretit Duncan, një skenë tragjike e nën-luajtur ose inskenuar në prodhimet e shfaqjes. Bazuar në praktikën profesionale dhe duke përdorur praktikën e vendosur në studimet e performancës, ky hulumtim trajton një boshllëk të rëndësishëm në praktikën teatrore: praktikën e nënvlerësimit të potencialit dramaturgjik të kësaj scene qëndrore.

Me shqyrtimin e ngushtë tekstual dhe nën-tekstual të fjalëve të Shekspirit, analizën e praktikës historike të vënies në skenë dhe regjistrimet e eksperimenteve në procesin e provave, hulumtimi ndërton dhe vërteton një model të veçantë regjisorial për skenën e vrasjes. Për dallim nga Shekspiri, i cili për shumë arsye vrasjen e mbretit e paraqet jashtë skene dhe e parasheh sjelljen në skenë të publiku përmes rrëfimit të të tjerëve, autori i parë i punimit dhe njëkohësisht, regjisori i veprës, e ka sprovuar veten duke e sjellë vrasjen e mbretit Duncan në mënyrë të drejtpërdrejtë në skenë. Hulumtimi përdor qasjen e praktikës reflektuese të Schön për të ekzaminuar konfigurimet hapësinore, ritmet kohore, motivimet psikologjike dhe elementet teknike që optimizojnë ndikimin dramatik të skenës. Proksemika dhe fizika e aktorit, rrisin jashtëzakonisht aksionin emocional të audiencës për dallim nga interpretimet tradicionale që e kufizojnë vrasjen në veprim jashtë skenës, apo ato që quhen lëvizje abstrakte. Hulumtimi në fjalë demonstroi se si një zgjedhje e tillë regjisoriale sjell në fokus elementët tematikë të fajit, ambicies dhe korrupsionit moral në qendër të tragjedisë së Shekspirit.

Kontributi i analizës dedikohet në praktikën teatrale dhe debatin teorik në një sërë nivelesh duke kapërcyer hendekun midis praktikës së punës në skenë dhe kërkimit analitik, duke u ofruar regjisorëve një mënyrë metodologjike të shëndoshë për të rishqyrtuar momentet e dhunës në tekstet klasike.

Fjalë kyçe

transformim, gjetje skenike, proksemika, fizika e aktorit

Frymëmarrja diafragmatike, fillesa e rrugës stërvitore drejt të folurës së mirë në skenë dhe në publik

Kristjan Koroveshi

kkoroveshi@live.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Punimi do të përmbajë një krahasim të detajuar të frymëmarrjes diafragmatike me frymëmarrjen instiktive.

Metodologjinë krahasuese do ta mbështes në dy kampionë prove, një person që ka filluar trajnimin e teknikës së të folurit dhe është në proces pune me frymëmarrjen diafragmatike dhe një kampion tjetër që s'ka njohuri mbi temën dhe kryen frymëmarrjen instiktive për funksionimin e organizmit.

Tezat e pikëpamjeve krahasuese do t'i zbërthej në ngritjen e pyetjeve:

- Cilat janë anët efikase dhe pozitive të frymëmarrjes diafragmatike si dhe ndikimi i dukshëm i saj?
- Rëndësia e përdorimit të saktë të saj dhe stërvitjes për interpretimin e pjesëve dramaturgjike në skenë apo fjalimeve dhe daljeve publike në medime të ndryshme.
- Rezervimi i frymëmarrjes si një çelës i synimit të suksesit të interpretimit të mirë pa dihatje, pa gulçime dhe pa shpeshtësi të procesit të frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes, kjo lidhur gjithashtu dhe me punën konkrete me materialin që interpretohet apo lexohet.
- Rrugëtimin stërvitor deri në arritjen e kontrollit të frymëmarrjes, menaxhimit të saj në një sërë aktivitetesh fizike dhe skenike, qofshin ato stërvitore ose në përballjen skenike.
- Rëndësinë e formës së qëndrimit të trupit dhe ushtrimeve përgatitore në faza të ndryshme të procesit të frymëmarrjes.

Punimi do të ketë si objektiv një pasqyrim profesional të fillimit të një metode pune drejt një frymëmarrjeje të plotë për rrugën e ushtrimeve dhe sesioneve stërvitore në format krahasimor të një të folure të mirë skenike dhe publike.

Tema dhe studimi merr shkas nga keqpërdorimi i gjuhës dhe aparatit të të folurit në diskursin skenik dhe atë publik.

Fjalë kyçe

krahasim i detajuar, frymëmarrje diafragmatike, metodologji krahasuese, rezervimi i frymëmarrjes, qëndrimi i trupit

Regjia dhe regjisor i në skenën shqiptare, përmes veprimtarisë së regjisorit Pandi Stillu

Inis Gjoni

gjoni.inis@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi dhe objekti i këtij studimi do të jetë regjisor i Pandi Stillu përballë realitetit të kohës si regjisor i parë i artit skenik shqiptar, përfshirjen e femrës shqiptare në aktrim dhe analizën krahasimore të veprave artistike që ai ka vendosur në skenë, duke iu referuar sfidave dhe problemeve me të cilat u përball arti skenik gjatë asaj periudhe.

Pyetja shkencore do të jetë: “Cila ishte sprova që kaloi Pandi Stillu, për të vendosur veprat e para skenike shqiptare?”

Mjaft e vështirë ishte puna për të zgjedhur aktorët në aspektin profesional, gjinor dhe kulturor. Gjithashtu, dhënia rëndësi e aspektit kulturor lidhur me gjininë femërore në përfaqësimin e tyre në artin skenik ishte delikate sepse spektatori tek ato shikonte aktoren me personalitet por edhe të aftë në rolin që ajo do të zhvillonte karakterin e dramës apo komedisë.

Rezultatet e këtij studimi do të përqëndrohen tek veprat skenike që regjisor i Pandi Stillu, si regjisor i parë shqiptar i skenës shqiptare vendosi në skenë, duke paraqitur vështirësitë, pengesat dhe sfidat që ai hasi në veprat e vendosura në artin e realizmit socialist.

Të gjitha veprat tematikisht të marra në analizë kanë qasje kronologjike dhe rievokojnë rëndësinë e krijimit të Teatrit Popullor, vështirësitë dhe rrugëtimin e regjisorit Pandi Stillu në promovimin e Teatrit Popullor si dhe promovuesi i dramaturgjisë shqiptare.

Përfundimet e këtij punimi do të jenë të bazuara në gjetjet e veprave artistike, krijimtarisë dhe analizave mbi këto vepra artistike të vendosura në skenën e Teatrit Shqiptar, ku përveç rëndësisë kombëtare, ku dukshëm ai i referohet konceptit të vënies në skenë të artit teatror, pavarësisht konteksteve politike dhe ideologjike.

Fjalë kyçe

teatër, aktore grua, arti skenik, konteksti politik dhe ideologjik

Aktrimi, nga teoria në praktikë: Hulumtimi e zbatimi i metodologjive në shkollën e aktrimit shqiptar

Prof. Asoc. Dr. Rozina Kostani

kostanirozi@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Baza shkencore e teatrit është metoda e K. Stanislavskit, e cila thekson ndërtimin e një interpretimi autentik bazuar në përjetimin dhe përvojën personale të aktorit. Përveç kësaj, mjete interpretimi janë trupi, zëri dhe teknika të avancuara të analizës së tekstit dramatik.

Krijimi i Shkollës së aktrimit “Aleksandër Moisiu”, pedagogët themelues të saj: V. Cerfanova, P. Stillu, S. Mio, K. Spahivogli. Qasja metodologjike nevojë e një hulumtimi teorik dhe praktik i përvojave pedagogjike e teatrore. Krahasimi metodologjik i kalimit nga teoria në praktikë e aktrimit shqiptar, duke trajtuar metodologjitë dhe teknikat kryesore të përdorura, ndikimet ndërkombëtare dhe sfidat me të cilat përballen aktorët e rinj.

Ndikimet nga traditat ndërkombëtare metodike, si: L. Strasbergut, përjetimin emocional të karakterit. S. Adler, imagjinata dhe rrethanat sociale. J. Grotowskit “teatri i varfër”, trupi dhe lëvizja, mjetet kryesore të shprehjes. B. Brecht, “Teatri epik”, distancim emocional, theksim mesazhi. V. Meyerhold, biomekanika, teatër fizik avangardë. S. Meisner, reagimi i natyrshëm, spontaniteti, teatri modern. M. Chekhov, simbolika dhe eksperimentimi fizik, energjia e karakterit, etj.

Përballjet me disa sfida të rëndësishme. Mungesa e burimeve dhe infrastrukturës moderne, kufizimi i hapësirave eksperimentale dhe vështirësitë e tregut të punës. Integrimi i teknologjisë, zhvillimi i programeve të reja dhe krijimi i teatrove alternative, ndihmojnë në tejkalimin e këtyre pengesave.

Procesi, duhet analizuar si kujtesë lëvizëse, ku çdo kohë ka nevojë për teatrin e vet, dhe ne, s’jemi gjë tjetër veç një hallkë e këtij zinxhiri. Për një zhvillim më të qëndrueshëm të aktrimit në Shqipëri, nevojitet një reformë që kombinon traditën me qasjet bashkëkohore, duke krijuar një platformë të hapur dhe inovative për aktorët e rinj.

Fjalë kyçe

edukim, teknikë, analizë, krahasim, platformë

Dramaturgjia e sirtarit: Rikthimi i veprave të ndaluara dhe pritshmëritë e audiencës postkomuniste

Valdrin Asani

valdrin.asani@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi: Konkretizimi i rolit të censurës mbi dramaturgjinë shqiptare. Duke qenë se çdo subjekt letraro-artistik ishte pre e propagandës dhe ideologjisë së regjimit, natyrisht edhe drama i nënshtrohej kësaj linje. A kemi të bëjmë, përveç censurës që ushtronte sistemi, edhe me një vetëgjykim, ose auto-censurë?

Pyetja: A ekziston në vendin tonë “Dramaturgjia e sirtarit”?

Në një kohë kur dramaturgjia transformohej thjesht në një mjet të fortë promovues të sistemit, shumë dramaturgë i hoqën veprat e tyre që kundërshtonin këtë koncept, nga frika e burgosjes ose internimit. Për fat të keq, sot nuk kemi mundësi të njihemi me këto vepra. Megjithatë, është shumë e rëndësishme të dimë nëse ekziston një dramaturgji që mund të jetë ende e pazbuluar. Ajo mund të gjendet nëpër arkiva shtetërore ose ato familjare.

Rezultati: Do të bazohet në periudhën pas viteve ‘90, kur veprat që ishin ndaluar gjatë komunizmit iu rikthyen skenës shqiptare. Këto vepra, natyrisht, nxirrnin në dritë disa elemente dhe ngjarje të panjohura për publikun shqiptar. A i përkisnin të gjitha këto vepra atij potenciali që koha kërkonte? A u plotësua pritshmëria e audiencës së re, postkomuniste, e uritur për një teatër që nuk ndiqte skemat e realizmit socialist?

Përfundimi: Do të bazohet në një hulumtim të thelluar në disa nga këto vepra që ishin ndaluar gjatë komunizmit dhe iu rikthyen skenës shqiptare. Njohja me këto drama mund të sjellë një këndvështrim më të saktë dhe më të plotë mbi to.

Fjalë kyçe

regjim, teatër, censurë.

Arti në hapësirat publike, sfidat dhe mundësitë e ekspozimit të artit në hapësirat urbane

Iris Canaj

c.iris925@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Arti duhet të jetë elitar apo më pranë komunitetit? A fituam sjellje të reja gjatë dhe pas pandemisë lidhur me frekuentimin (ose jo) të institucioneve kulturore? Arti në hapësirat publike jo vetëm që afron publikun me artin, por edhe zbukuron estetikisht qytetin, gjë e cila nxit gjendjen e mirë emocionale të banorët e tij, por nxit edhe turizmin, duke ndikuar në ekonominë e vendit.

Të bësh art në hapësira publike; festivale multidisiplinare si Festivali Artistëve të Rrugës, stola në formë libri si projekti « Stolibër », instalacione të ndryshme si « Reja », murale apo dhe Parku Vizual (dita pa parkimin e makinave) si projekt që rivitalizon lagjet e qytetit si hapësira të përbashkëta për angazhim komunitar, janë një formë artivizmi, që jo vetëm argëtojnë dhe zbukurojnë, por edhe edukojnë mbi tematika të ndryshme, si : arkitektura, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe historisë, ndërgjegjësim mbi mjedisin, socializim, nxitje në turizëm, ekonomi, qëndrueshmëri, etj. Hapësira publike, e përbashkët, duhet shfrytëzuar nga/për komunitetin dhe duke u mbrojtur nga ai vetë, gjë e cila jo rrallë ndodh që të vandalizohet...

Por, a ka një diferencë mes artivizmit në hapësira publike dhe vandalizimit? Si veprohet për ta shfrytëzuar artisti krijues këtë hapësirë publike, pa dëmtuar qytetin, por edhe duke zbatuar ligjin. A ekzistojnë ligjet për artin në hapësira publike? Do të shqyrtojmë vendimet dhe rregulloret e Bashkive si pushtet lokal, si dhe Ministrive përkatëse, si pushtet qendror, lidhur me artin në hapësirat publike. Gjithashtu, do të shqyrtojmë sfidat dhe mundësitë që arti në hapësira urbane ofron për krijuesin artist, por edhe për komunitetin. Kjo, do të sjellë rekomandime, bazuar në hulumtimin mbi eksperiencën personale lidhur me organizimet e sipërpërmendura, por edhe eksperiencën të ngjashme nga bashkëpunëtorët, si dhe institucionet përgjegjëse; lidhur me lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike, por edhe ruajtjen e tyre.

Fjalë kyçe

artivizëm, stolibër, Festivali Artistëve të Rrugës, parku vizual

Ndikimi i “artit të shtatë”, në Shqipëri, nga kinematë e para e deri tek ndikimi i artit të realizmit socialist

Eno Milkani

enomilkani@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ndikimi i kinemasë në shoqërinë shqipfolëse e më pas atë shqiptare nga viti 1897 e deri tek filmi i parë i shkurtër shqiptar “Fëmijët e saj” 1957, i njohur si filmi i parë i shkurtër shqiptar por jo si filmi i parë shqiptar. Kinemaja dhe ndikimi i saj thelbësor në shoqërinë, me një mentalitet thellësisht oriental, në transformimin e kësaj shoqërie me një të kaluar perandorake dhe në përqaftimin e një vizioni dhe praktike perëndimore si një lëvizje natyrale e shqiptarëve që me shpalljen e pavarësisë e deri tek fillesat e një kapitalizmi industrial në fund të viteve 30.

Shqiptarët, viktimat të një propagande vizuale, viktimat të kushteve social-politike e historike, si dhe entuziazmi që mori nëpërmjet imazheve optimiste nga vendet e ish bllokut socialist dhe zbatimi i tyre në kinematografinë e tij.

Ndërtimi i institucionit kinematografik në vitin 1953, si shenjë e superfuqisë së sistemit të ri komunist.

Edukimi i kineastëve të parë të cilët dokumentuan realitetin e një periudhe të caktuar, si dhe nevoja dhe dëshira për konsolidimin e “artit të shtatë” si një nevojë sociale dhe jo-politike. Mospërputhja propagandistike me mekanizmin e censurës së kohës si momenti i fundit i lirisë së shprehjes artistike dhe fillesat e një arti të kontrolluar nga aparati shtetëror një-partiak i kohës. Sundimi i metodës së realizmit socialist dhe censurës pas Plenumit të IV të Partisë së Punës, në Qershor të vitit 1973, si një valë e shprehjes së imponuar me forcë nga sistemi njëpartiak komunist.

Fjalë kyçe

kinema shqiptare, realizmi socialist, censura, liberalizmi dhe konservatorizmi

Kinemaja për fëmijë e viteve '60-'90, një mjet edukimi që kërkon strategji orientuese për të komunikuar me fëmijët e sotëm

Suela Bako

suelabako@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Në fëmijërinë time të hershme, rëndësia e filmave për fëmijë që shfaqeshin në kanalin e vetëm televiziv kombëtar, ishte e pashlyeshme. Përmes tyre u krijua jo vetëm imazhi i Luftës së Dytë Botërore, por edhe të Shqipërisë që nuk mund ta shihje nga afër, duke e shndërruar ekranin në një hapësirë magjike e cila shërbente “të vërtetën” e pajetuar. Në studime të ndryshme flitet për rëndësinë e kinemasë për fëmijë, si mjet edukimi. Po a mund të thuhet e njëjta gjë edhe për fëmijët e sotëm, të vendosur përballë të njëjtëve filma? A “magjepsen” njësoj nga kjo lloj kinemaje brezi i internetit dhe i hapjes me botën? Këto pyetje shkojnë edhe më tej: A edukon njësoj kinemaja në çdo kohë?

Kinemaja shqiptare për fëmijë, është një pasuri kombëtare në fondin e kinematografisë, por ky punim përpiqet të eksplorojë rëndësinë, vlerën dhe funksionin e saj në kohë, duke përballur mesazhet e ndjesitë e publikut të dikurshëm me atë të ditëve të sotme. Për të nxjerrë përfundime, është studiuar një kampion fëmijësh, sipas të cilit do të përpiqemi të kuptojmë nëse kjo kinema mbetet edukative edhe në ditët e sotme, nëse duhen vërejte apo shpjegime kontekstesh në përballjen e saj me publikun, nëse ka filma që mbeten të pakohë apo nëse kanë vlerë edukuese muzeore, që kërkon një ciceron për të shpjeguar kontekstet politike, historike e gjeografike të këtyre filmave. Përveç të dhënave që do të dalin për herë të parë nga një studim i tillë, punimi ngre edhe rekomandime për aktivitetet që Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit kryen me fëmijët, por edhe për aktivitete edukuese që kryejnë me moshat shkollë të tjera institucione të kujtesës dhe historisë së Shqipërisë.

Fjalë kyçe

film, brezi i ri, mesazhe, propaganda

Petro Marko, një dramë përballë kritikës

Dr. Elis Mataj

elis.mataj@artacademy.al

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi dhe objekti i këtij studimi do të jetë shkrimtari Petro Marko përballë mendimit kritik të kohës si dramaturg, ku atë pjesë të vogël të këtij lloji letrar, ai e ka referuese për kohën dhe për problemet me të cilat, u përball drama e asaj periudhe. I njohur si romancier dhe një personalitet i dijes letrare të kohës, Petro Marko hyn më së shumti në radhën e autorëve të ndaluar, kryesisht në llojin letrar të dramës. Pyetja shkencore do jetë: “Cila ishte sprova për Petro Markon, për të shkruar dramë në vitet 1960”?

Në këtë kohë ideologjia dhe kërkesat politike kishin krijuar murin e lartë dhe të pakalueshëm për dramën shqiptare, duke i hapur rrugë vetëm atyre dramave që shkonin sipas shijes së pushtetit. “Bora e kuqe”, një pjesë dramatike e Petro Markos, një version i dramës “Zonja Çurre” nuk u botua kurrë.

Rezultatet e këtij studimi do të përqëndrohen tek pjesët dramatike që shkruajti Petro Marko, si: “Guna mbi tela” me subjekt nga Lufta e Vlorës dhe drama tjetër e titulluar “Niku i Martin Gjinit” subjekt i frymëzuar nga koha e Skënderbeut, por që kishte konotacione të nënkuptuara politike për shkak të “liberalizimit” që e përshkonte, u ndalua, duke u cilësuar si një vepër e dëmshme ideologjikisht dhe jo në përputhje me artin e realizmit socialist. Të dyja veprat tematikisht kanë qasje historike dhe rievokojnë temën e lirisë, por që në të vërtetë autori duket se kishte një raport me kohën, kryesisht përmes metaforës së fatit të individit në momente krize. Përfundimet e këtij studimi do të bazohen në gjetjet letrare dhe kritike të kohës, ku Petro Marku dinte si dhe kujt t’ia besonte mesazhet e dramave, atyre që mund t’i deshifronin. Si tek drama për Zonja Çurren dhe drama që frymëzohet nga koha e Skënderbeut, në kontekst, përveç pavarësisë kombëtare, dukshëm i referohet konceptit të lirisë. Pra liria, përgjatë gjithë historisë së letërsisë botërore, është parë si një metaforë universale dhe përbën një nga konceptet më të rëndësishme të saj.

Fjalë kyçe

Petro Marko, dramë, kritikë, viti 1960, realizmi socialist

Elementi dramatik në eposin e kreshnikëve

Suela Agolli, Prof. Asoc. Dr. Anila Mullahi

sagolli.sa@gmail.com, Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

anilamullahi@gmail.com, Universiteti Filologjik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Cikli i kreshnikëve ose këngët epike për agët e Jutbinës, është një pasuri kulturore dhe shpirtërore, që paraqet edhe një sintetizim të formave specifike të rrëfimit. Në këtë cikël me frymë heroike, rrëfihen bëmat e heronjve që jetojnë në një botë, sa reale aq edhe fantastike, që mendojnë objektivisht, por pranojnë do lloj imazhi, veprimi dhe figure ireale.

Në mënyrën sesi janë ndërtuar shumë skena ndërveprimi, apo sesi janë ndërtuar personazhet, tipizimi i tyre, dallohet në këto këngë elementi dramatik që është jo rrallë i pranishëm në zhanrin e eposit.

Elementi dramatik tek eposet është identifikuar që nga Aristoteli, i cili e përcaktonte këtë element nëpërmjet aftësisë që kanë eposet për të krijuar skena dhe “për të sjellë në skenë”. Rrëfimi narrativ ndërpritet për të futur personazhe realë ose irealë. Personazhet e eposit, përshkruhen në një mënyrë shumë skenike në situata ku flasin me orët dhe zanat, kujdesen për fëmijët e tyre, por edhe në skena ku ata luftojnë me armiq të tyre herë njerëzorë e herë me përmasa përbindëshash.

Eposet janë konsideruar edhe “teatrot e pakohësisë”, sepse ato duket se nuk kanë qëllim primar fundin. Eposet karakterizohen nga shtrirja e cila ndërpritet nga veprime, nuk ka synim primar zgjidhjen e konfliktit ose të zbulimit të ndonjë misteri ose të konfliktit. Më shumë i intereson rrugëtimi, në kompleksitetin e marrëdhënieve, sesa fundi i tyre. Heronjtë e këtyre këngëve përqendrohen në skenat ireale, por edhe në skenat e luftimeve.

Fjalë kyçe

dramë, antikitet, epike, e vërtetë, e pavërtetë

Dramaturgjia shqiptare gjatë periudhës së realizmit socialist

Prof. Asoc. Dr. Anila Mullahi, Suela Agolli

anilamullahi@gmail.com, Universiteti Filologjik, Tiranë, Shqipëri
sagolli.sa@gmail.com, Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Dramaturgjia shqiptare pas 1944-ës, ashtu si gjithë letërsia shqiptare u gjend në një situatë të re dhe të panjohur. Në radhë të parë u bë shpëputja e detyrueshme nga tradita dhe modelet e suksesshme të së shkuarës. Shkrimtarë që kishin lëvruar dramaturgjinë si Gj. Fishta, N. Zadeja, apo K. Floqi e E. Haxhiademi, dënohen, vriten, mohohen ose lihen në harresë të qëllimshme. Më pas u ndaluan veprat e dramaturgëve më të njohur botëror jo vetëm ato bashkëkohor, por u hoqën nga skena në mënyrë paradoksale edhe autorët e antikitetit e mesjetës.

Drama shqiptare shpëputet nga autenticiteti i saj, duke u tjetërsuar e duke u vënë në ndjekje të modeleve të metodës së realizmit socialist importuar nga letërsia ruse ose nga vende të tjera komuniste, modele që nuk përshtateshin me zhvillimin kulturor e specifikën letrare shqiptare. Shpesh, dramat do t'i ngjajnë reportazheve të dramatizuara, të nxitura nga ngjarje imediate. Madje ndonjëherë krijoheshin drama edhe thjesht për aplikime teknike, zhvillimi i teknologjisë të cilat shndërroheshin në prezantime si mrekulli të gjërave krejt të rëndomta që s'mund ti m'vishje asgjë artistike.

Drama e aktualitetit ishte lloji më i indoktrinuar, sepse është një bastardizim i asaj drame që në zhvillimin e dramaturgjisë botërore quhet drama me tezë, drama e ideve, e lëvruar nga Ibsen, Show ose dramë propagandistike e lëvruar nga Brehti. Konceptimi estetik i Brehtit pranohej madje edhe shfrytëzohej fama e tij, por nuk përbënte model në praktikë.

Ndërmjet tërësisë së dramave të krijuara gjatë kësaj periudhe, disa prej tyre janë pjesë e traditës së zhvillimit të dramaturgjisë shqiptare. Vlera e tyre nuk qëndron në ndjekjen e metodës zyrtare, por janë rezultat i talentit të shkrimtarëve. Në prirjen jo për të kundërshtuar politikisht sepse kjo ishte e pamundur për kohën, por për të nxjerrë autenticitetin e brendshëm artistik, shkrimtarë si Fadil Paçrami e Minush Jeros u dënuan dhe vepra e tyre u ndalua pa arritur të luante rol ndryshues.

Fjalë kyçe

realizmi socialist, drama, dënime, drama shqiptare

Prezenca e mistikës dhe aspekti filozofik i kinemasë së Bergman-it

Anila Varfi

nilavarfi@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të prezantojë një tablo eksploruese dhe analitike mbi prezencën e mistikës dhe aspektin filozofik të kinemasë së regjisorit gjenial, Ingmar Bergman. Kundrimi i saj, kthehet në një udhëtim kompleks e shumëdimensional në thellësinë e shpirtit njerëzor.

A është kinemaja e Ingmar Bergman një formë e vazhdueshme kërkimi mbi kuptimin e jetës, vdekjes dhe ekzistencës humane? Cilat janë mjetet që përdor, jo vetëm për të kryer një kërkim, por edhe për ta ndihmuar shikuesin për të hyrë në thellësinë e tij?

A mos janë mistika dhe filozofia e kinemasë së tij ato që përkthehen natyrshëm në mjete shprehëse, që arrijnë ta provokojnë publikun të zhytet në dilemat ekzistenciale, duke bërë që temat e trajtuara në kinemanë e tij, të kenë dimension të thellë analitik dhe filozofik?

Mendimi filozofik i Bergmanit si kineast, duket se lundron në ujëra besimi dhe dyshimi të ngjashme me ato të filozofit dhe teologut danez Søren Kierkegaard. Por dilemat e tij mbi jetën dhe përjetësinë krijojnë një paternë simbolike tronditëse, aty kur nënshtresëzimi filozofik i Nietzsche-s amalgamohet në veprën kinematografike të Bergman-it.

Për të hulumtuar këto pyetje, ky punim do të analizojë disa prej filmave ikonë të Bergman-it, për të vlerësuar nëse mistika dhe filozofia janë vërtet dy shtyllat kryesore që mbështesin narrativën dhe zhvillimin e kinemasë së Ingmar-it, duke i dhënë asaj një dimension të thellë shpirtëror dhe nëse këto dy shtylla e shndërrojnë filmin në një hapësirë për reflektim, në një përballje me realitetin dhe me botën shpirtërore të gjithësecilit, duke ofruar një përvojë të fuqishme dhe transformuese për shikuesin.

Fjalë kyçe

mistikë, ekzistenca, vdekja, besimi, Bergman

Dialogu vizual mes pikturës dhe filmit bashkëkohor: Referencat e artit pamor në kinemanë ndërkombëtare

Elvis Lule

elvislule34@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Në kinemanë bashkëkohore ekziston një tendencë për të rikthyer format klasike të artit pamor si pjesë integrale e narrativës filmike. Megjithatë, mungojnë studime të detajuara që shqyrtojnë se si këto referenca ndikojnë estetikën, semantikën dhe përjetimin emocional të shikuesit.

Ky studim synon të analizojë mënyrën se si piktura klasike dhe moderne përfshihet në gjuhën vizuale të disa filmave autorë bashkëkohorë, duke identifikuar rastet, analizuar referencat dhe eksploruar ndërthurjen e gjuhës së artit pamor me rrëfimin kinematografik. Referencat ndaj pikturës në filmin bashkëkohor nuk janë vetëm homazhe estetike, por strategji të qëllimshme vizuale për të shtuar thellësi narrative, ndërveprim kulturor dhe përjetim emocional. Qasja do të jetë kualitative dhe analitike, me fokus në analizën krahasuese të skenave filmike që referojnë piktura specifike, duke analizuar filma bashkëkohorë ndërkombëtarë autorësh si Kurosawa, Majewski, von Trier, Greenaway etj.

Do të analizohen nga ana vizuale dhe semiotike kuadrot filmike dhe pikturat përkatëse, duke u mbështetur në literaturën akademike në fushën e teorisë së filmit dhe historisë së artit. Këto referenca përforcojnë kuptimin narrativ, ngarkesën filozofike dhe lidhjen me kujtesën kulturore të audiencës, duke ngjallur emocione dhe vendosjen e filmave në një dialog ndërgjuhësor me artin klasik. Përdorimi i pikturës në filmat bashkëkohorë është pjesë e një ndërthurjeje inovative ndërdisiplinore që pasuron mënyrën e rrëfimit në kinema dhe e çon filmin përtej mediumit linear, drejt një forme të re të përjetimit të artit.

Fjalë kyçe

kompozimi filmik, narrativa vizuale, semiotika e imazhit, piktura klasike në film, dialog ndërdisiplinor

Nga fjala në imazh: Interpretimi vizual i narracionit dhe emocionit në film

Prof. Asoc. Zamir Kokonozi

zkokonozi@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ndërsa fjala ndërton kuptimin kryesisht në mënyrë lineare dhe simbolike, filmi e krijon atë përmes manipulimit të hapësirës, kohës dhe fuqisë së menjëhershme të imazhit. Ky punim shqyrton se si filmat i shndërrojnë fjalët në imazhe dhe eksploron marrëdhënien komplekse mes fjalës dhe rrëfimit vizual. Pas çdo imazhi shprehës në film qëndron një kuptim i thellë i strukturës së narracionit. Ky punim eksploron mënyrën se si drejtori i fotografisë interpreton jo vetëm emocionalisht skenarin, por edhe ritmin e tij, temën kryesore dhe strukturën—duke përkthyer momentet kyçe të narracionit dhe marrëdhëniet e personazheve në imazhe që qartësojnë rrëfimin tek shikuesi.

Ndërsa skenari ofron dialog dhe përshkrim, shpesh lë të hapur interpretimin e nuancave emocionale dhe ritmit. Drejtori i fotografisë interpreton në këtë hapësirë imazhet që krijojnë, duke përdorur eksperiencën e tij për të udhëhequr vendime mbi mjetet kinematografike ku përfshihet ndriçimi, kompozimi, lëvizja e kamerës, objektivet e kështu me rradhë. Më shumë sesa teknik, term i përdorur rëndom në qarqet akademike, drejtori i fotografisë është në rradhë të parë rrëfimtari vizual. Puna e tij bazohet mbi skenarin duke interpretuar nëntekstin dhe duke sinkronizuar vizionin e tij personal me atë të regjisorit. Një ndryshim emocional i brendshëm i personazhit mund të pasqyrohet përmes një ndryshimi gradual të ndriçimit, ndërsa një pikë kulminante mund të theksohet përmes një lëvizjeje dinamike të kamerës. Këto zgjedhje burojnë nga një kuptim intuitiv dhe analitik i strukturës narrative.

Duke u mbështetur në shembuj nga kinemaja bashkëkohore dhe në dëshmi nga profesionistë të fushës, ky punim shqyrton se si kineastët bashkojnë instinktin vizual me logjikën e rrëfimit. Argumentonhet se roli i kineastit është thelbësor në shndërrimin e emocioneve të shkruara në një përvojë vizuale të ndjeshme—duke e kthyer skenarin në diçka që jo vetëm kuptohet, por edhe që ndihet thellësisht.

Fjalë kyçe

kinematograf, rrëfim, strukturë, filmike, teknikë

Kultivimi dhe zhvillimi artistik i valles lirike dhe epike në Republikën e Shqipërisë

Elona Beqiraj

elonabeqiraj15@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Kur flasim për vallet duhet mbajtur parasysh karakteri sinkretik i tyre. Ato shpesh janë të lidhura me fillesën artistike muzikore dhe poetike. Tendenca për të krijuar figura apo lëvizje koreografike mbi origjinalitetin e krijimeve folklorike, përbën një element esencial në Vallet e Përpunuara. Vallet popullore janë krijuar duke u bazuar në ndjeshmërinë dhe në natyrshmërinë e të kërcyerit individual, ekzekutim në grup, në formë rrethi apo gjysëm rrethi të kapur nga duar. Përgjatë hulumtimit, është vënë re, se nga mesazhi që vallet përcjellin, u pa e nevojshme nga etnokoreografët që të kishte një ndarje midis Valleve epike dhe lirike.

Duke pasur si objektiv dallimet dhe zhvillimet mes këtyre gjinive, aty do të gjejmë dhe pasqyrimet e problematikave të valleve të kultivuara të cilat kanë rëndësi për faktin se si kanë ndryshuar dhe evoluar, duke ruajtur motivin burimor. Në të parën hyjnë lëvizjet koreografike të lirikës të cilat janë të qeta, hedhje të vogla pa shumë shpëputje nga toka. Ndërsa në të dytën, kemi lëvizjet koreografike të epikes ku dallojmë zhvendosjet e theksuara, ndalesat e prera me njëjërën këmbë ose me të dyja, si edhe përplasjet e forta të hapave në tokë.

Si përfundim, mund të themi se me rëndësi është fakti se si përpunohen këto valle nga koreografë të ndryshëm të cilët shpesh vendosin dhe motive të valles lirike në atë epike, gjë e cila e vështirëson përcaktimin e tyre më pas. Dallimi i valles popullore për cdo gjini na çon drejt ndarjes së idesë emocionale që ato përcaktojnë gjatë ekzekutimit nga kërcimtarët popullorë.

Fjalë kyçe

folklor, gjini, koreografi, valle

Roli i Inteligjencës Artificiale në koreografi: Një epokë e re e lëvizjes

Ersilja Çeli

ersilja_celi@hotmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Inteligjenca Artificiale (AI) po transformon industrinë krijuese, duke përfshirë edhe koreografinë, ku shërben si mjet për të gjeneruar lëvizje, për të ndihmuar koreografët dhe për të zgjeruar mundësitë artistike. Ky hulumtim eksploron integrimin e Inteligjencës Artificiale në danc, duke u fokusuar në faktin nëse Inteligjenca Artificiale mund të rrisë krijimtarinë njerëzore apo nëse rrezikon të zvogëlojë origjinalitetin artistik. Mjetet e drejtuara nga Inteligjenca Artificiale si Move Mirror i Google, OpenAI's Sora dhe Motion Capture AI analizojnë lëvizjen, sugjerojnë modele koreografike dhe ofrojnë qasje të reja për kompozimin e dancit. Megjithatë, pyetja themelore mbetet: A mundet që Inteligjenca Artificiale të përsërisë thellësinë intuitive, emocionale dhe kulturore të mishëruar në koreografinë e krijuar nga njeriu?

Ky studim përdor një metodologji kërkimore cilësore, duke përfshirë studime rastesh mbi koreografë si Wayne McGregor, i cili bashkëpunon me Inteligjencën Artificiale për të zgjeruar kufijtë e krijimit të lëvizjes. Duke analizuar koreografinë e gjeneruar nga Inteligjenca Artificiale dhe duke e krahasuar me performancat e krijuara nga njerëzit, ky hulumtim vlerëson aftësitë e Inteligjencës Artificiale në krijimin e larmishmërisë dhe efikasitetit të lëvizjes, ndërkohë që identifikon gjithashtu kufizimet e saj në shprehjen emocionale dhe marrjen e vendimeve artistike. Rezultatet sugjerojnë se Inteligjenca Artificiale sjell mundësi të reja për eksplorimin koreografik, por i mungon aftësia për të kuptuar plotësisht kontekstin kulturor, qëllimin narrativ dhe nuancat emocionale.

Punimi arrin në përfundimin se Inteligjenca Artificiale nuk është një zëvendësim për koreografët, por një partner bashkëpunues që mund të ndihmojë në gjenerimin e ideve, të ofrojë sugjerime inovative për lëvizje dhe të zgjerojë procesin koreografik. Ndërkohë që Inteligjenca Artificiale vazhdon të evoluojë, e ardhmja e dancit mbetet e rrënjësuar në sinergjinë midis teknologjisë dhe artit njerëzor, duke siguruar që kreativiteti dhe shprehja të mbeten në thelb të performancës. Këto njohuri kontribuojnë në diskursin e vazhdueshëm mbi rolin e Inteligjencës Artificiale në artet performuese dhe aplikimet e saj të mundshme në edukimin koreografik dhe praktikën profesionale.

Fjalë kyçe

Inteligjenca Artificiale, koreografi, teknologji danci

Synimi drejt veprave kombëtare origjinale

Prof. Asoc. Dr. Roberta Ndokaj

robertandokaj@hotmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Synimi për të krijuar në baletin shqiptar një traditë të re të pahasur më parë me vepra origjinale, erdhi falë përvijës së grumbulluar në vitet '50 me vënien në skenë të shumë baleteve nga literatura koreografike botërore.

Dukuria e re ishte pasojë e dy faktorëve: a) zhvillimit të vetë baletit si art me kualifikimin dhe përkryerjen e tij të natyrshme vit pas viti, b) zhvillimit të kulturës kombëtare në përgjithësi, e cila e konsideronte si kusht të saj edhe përfshirjen e baletit. Një nga veçoritë e zhvillimit historik të tij qenë pikërisht baletet kombëtare. Gjuha që ato sollën, risitë, origjinaliteti nxorën në pah mënyrën se si duhej zgjidhur raporti midis strukturave koreografike të baletit klasik si art i kultivuar me strukturat koreografike të folklorit shqiptar, tashmë të përpunuara e të ngritura në një status të ri artistik. Ndonëse arti si i tillë është universal, e veçanta e baletit shqiptar, pra kombëtarja, etnikja, e bëri të dallueshëm atë me veprat nacionale që prodhoi. Kjo erdhi më së pari nga parti muzikor i kompozuar nga muzikantët shqiptarë, më pas nga elementet e tjerë si subjekti, ngjarjet e trajtuara, mjediset sociale, koncepti koreografik si dhe gjithçka që lidhej me narrativën, personazhet, zakonet, traditat antropologjike etj. Sigurisht ishte kërkesa ngulmuese e pushtetit të kohës, por po aq dhe nevoja historike që baletet kombëtare të gjenin një gjuhë dhe një formë sa më të pëlqyeshme për spektatorin shqiptar, çka nxiti vetiu krijimtarinë origjinale.

Baleti ynë nuk do të krijonte dot fytyrën e vet artistike pa realizimin e këtij qëllimi, gjë e cila mundësoi që ai të shpërfaqte disa aspekte të veçanta, të cilat krijuan begati dhe larmi, si në rrafshin përmbajtësor, ashtu dhe në atë formal e stilistik.

Fjalë kyçe

balet, gjuhë, kombëtar, veçori

Studim krahasues i skenografive për shfaqje të njëjta në teatro të ndryshme

Drini Shehu

drini_shehu@hotmail.com

Teatri “Petro Marko”, Vlorë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim publikon dhe krahason qasjet në skenografi midis dy veprave të njëjta të vendosura në skenë në periudha të ndryshme kohore në dy teatro të vendit, përkatësisht në Teatrin “Petro Marko” Vlorë dhe Teatrin “Bylis” Fier. Baza kryesore e studimit është të analizojë se si zgjidhjet skenografike përfshirë konceptin, dekorin, shfrytëzimin e hapësirave, ndriçimin, elementet vizuale që janë përdorur nga skenografë të ndryshëm në po të njëjtat shfaqje teatrale përmes një metodologjie krahasuese nga materiale arkivore dhe artikujsh të botuar në media dhe rrjete sociale, bazuar në analizimin e materialeve fotografike si dhe vëzhgimin dhe njohjen e drejtpërdrejtë të veprave.

Artikulli identifikon pikat e përbashkëta dhe ndryshimet midis dy shfaqjeve teatrale si në zgjidhjen ashtu dhe në konceptimin e skenografisë në funksion të shfaqjes dhe zgjidhjes regjisoriale. Fokusi vendoset te mënyra se si skenografia pasqyron vizionin regjisorial, kontekstin artistik, teknik të secilit teatër si dhe rëndësisë së figurës së skenografit dhe krijimtarisë së tij në realizimin e një performance teatrale. Gjetjet gjithashtu vënë në dukje rolin kritik të skenografisë në formësimin e narrativës, në interpretimin e dramaturgjisë dhe të performancës teatrale.

Ky punim synon të hedhë dritë mbi ndikimin e skenografisë në përvojën e publikut dhe në ndërtimin e atmosferës teatrale, duke vënë në dukje bashkëpunimin midis skenografit dhe regjisorit si një ndër elementët thelbësorë në suksesin e shfaqjes. Studimi ofron një kontribut të vlefshëm që do të shërbejë si informacion për artistët dhe studiuesit e interesuar për evolucionin e praktikave teatrale në vendin tonë.

Fjalë kyçe

koncept skenografik, performance teatrale, metodologji krahasuese, element skenik, dekor

Skenografia dhe kostumet në fillesat e kinematografisë shqiptare

Enela Mastori

enelamastori@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim shqyrton rolin dhe ndikimin e skenografisë dhe kostumeve në krijimin e identitetit të kinematografisë shqiptare, me një fokus të veçantë në periudhën e pasluftës, kur kinematografia shqiptare filloi të zhvillohej. Elementët vizual, si skenografia dhe kostumet, kontribuan në formimin e një estetike të veçantë dhe në pasqyrimin e realitetit shoqëror dhe politik të kohës.

Përmes një analize të disa veprave të njohura të asaj periudhe, studimi do të vlerësojë rëndësinë e këtyre dy aspekteve për krijimin e atmosferës dhe pasqyrimin e karaktereve të personazheve, duke përçuar mesazhe ideologjike dhe duke i dhënë kështu kinematografisë shqiptare një dimension të ri artistik dhe kulturor. Analiza do të fokusohet në mënyrën se si këto elemente vizuale ishin të lidhura ngushtë me tematikën dhe kontekstin social politik të kohës, duke ofruar një pasqyrë të pasur të ndikimit të tyre në formimin e identitetit vizual të kinematografisë shqiptare.

Nëpërmjet studimit të punës së artistëve të njohur të skenografisë dhe kostumeve të periudhës, do të vlerësohet ndikimi i skenografisë dhe kostumeve në kinemanë shqiptare, duke krijuar një gjuhë vizuale që shërbeu për të artikuluar tregimet dhe për të ndihmuar në transmetimin e mesazheve ideologjike të regjimit komunist, i cili kontrollonte me rigorozitet çdo aspekt të jetës kulturore dhe artistike.

Skenografia në kinematografinë shqiptare të periudhës së hershme ishte e lidhur ngushtë me realitetin social të kohës, duke përdorur shpesh elemente tradicionale dhe ndikime nga arti popullor shqiptar, ndërsa përpiqej të pasqyronte ngjarjet dhe temat e rëndësishme shoqërore dhe historike. Në fillimet e kinematografisë shqiptare, skenografia ishte ende një fushë që zhvillohej ngadalë, me mundësi të kufizuara për teknologji dhe burime.

Fjalë kyçe

kinematografia shqiptare, skenografia, kostume, element vizual, ndikimi estetik

Ndërtimet italiane të viteve 1900 në qytetin e Gjirokastrës, frymë perëndimore që erdhi nga Italia

Gazmend Koçollari

gkocollari@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Dëshmitë historike të qytetit të Gjirokastrës, nxjerrin në dritë ditë pas dite fakte të reja të cilat i shtojnë vlerat dhe hijeshinë këtij qyteti. Nën pluhurin e kohës mbetet e pashkelur mirë një pjesë po aq e rëndësishme e arkitekturës së qytetit, e cila solli një erë perëndimore për qytetin e gurtë. Pikërisht këtu merr shtysë kjo punë kërkimore duke pasur si qëllim evidentimin dhe identifikimin e ndërtesave italiane në qytet, historikut të tyre, individët që jetuan e punuan në qytet në vitet '20-'30 dhe kontributi i tyre në jetën ekonomike, sociale e kulturore të qytetit dhe sidomos në rikonstruktionet dhe kontruksionet bashkëkohore me funksione sociale, moderne tërësisht perëndimore.

Por lind pyetja përse dhe si u ndërthurën këto ndërtesa luksoze si bare, restorante, banka, shkolla e shtëpi banimi, ambiente me funksion social, shëndetësor etj., që nga mbulimi i cative me tjegulla të kuqe e deri te teknikat inovatore bashkëkohore të përdorura për herë të parë në qytet, me arkitekturën mesjetare kaq unike të qytetit të Gjirokastrës.

Themi se ndërtimet italiane në infrakstrukturën dhe arkitekturën e qytetit sollën një frymë të re në zhvillimin e qytetit, duke sjell kështu një qasje tjetër perëndimore bashkëkohore por duke ruajtur identitetin historik.

Ky studim u realizua nëpërmjet hulumtimeve në bibliotekën e qytetit në libra dhe periodikë të kohës, kronika dhe njoftime të ndryshme me përmbajtje shpjeguese, intervista me pasaardhës të familjeve më të rëndësishme të kohës. Gjithashtu dhe kërkime në fondin arkivor të Ambasadës së Nderit të Republikës Italiane në Gjirokastrë.

Ndërtimet me karakter social, ekonomik në qytet me frymë perëndimore kanë ndikuar në zhvillimin dhe orientimin e qytetit drejt perëndimit, duke mos mohuar trashëgiminë kulturore por krijoi një marrëdhënie unike vlerësimi dhe ruajtje identiteti.

Fjalë kyçe

arkitekturë, trashëgimi kulturore, inovacion

Evoluimi i teatrit dhe skenografisë

Ened Kuka

enkuka@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi dhe objekti i këtij studimi do jetë një analizë esenciale nga format e thjeshta të teatrit antik grek deri në imazhet komplekse dhe teknologjinë të avancuar të skenave bashkëkohore. Duke u nisur nga funksioni fillestar i hapësirës teatrale në antikitet për rrëfimin dhe ritualin, kërkimi shqyrton ndikimin e lëvizjeve artistike, zhvillimeve teknologjike, ndryshimeve shoqërore dhe kulturore në evoluimin e teatrit.

Studimi do të ndjekë një qasje historike dhe ndërdisiplinore, duke ekzaminuar periudha të rëndësishme të teatrit: si teatri i Rilindjes italiane me shpikjen e perspektivës iluzioniste, teatri Barok me efektet e tij madhështore, lëvizjet e shekullit të XIX-të drejt realizmit dhe natyralizmit, avangardat e fillimit të shekullit të XX-të që sfiduan konvencionet tradicionale dhe integrimin e teknologjive dixhitale në skenografinë e shekullit të XXI.

Metodologjia do të përfshijë analizën e ndryshimit të arkitekturës së teatrit, gjë që sjell ndryshimin e konceptit të skenografisë teatrale.

Rezultatet e pritura të këtij kërkimi synojnë të ofrojnë një kuptim gjithëpërfshirës të forcave që kanë formësuar skenografinë europiane, duke zbuluar tendencat kryesore dhe inovacionet teknike.

Studimi do të analizojë se si evoluimi i skenografisë ka ndikuar në perceptimin e dramës, marrëdhënien midis performuesit dhe spektatorit, dhe potencialin e formave të reja të shprehjes skenike.

Pyetja shkencore do jetë: Çfarë ndikimi ka zhvillimi i teknologjisë në teatër dhe skenografi? Rezultatet e këtij studimi do përqendrohen në historinë e teatrove në Europë, nga periudha e antikitetit deri në ditët e sotme dhe realizimet personale të aktiviteteve të ndryshme. Ky kërkim ka potencialin të kontribuojë në fushën e studimeve teatrale dhe të performancës duke ofruar një perspektivë të gjerë mbi zhvillimin e një elementi qendror të teatrit evropian dhe ndërveprimin e tij me kontekstin historik, artistik dhe teknologjik.

Fjalë kyçe

teatër, skenografi, histori, arti skenik, teknologji, evoluim

Edukimi artistik, domosdoshmëri apo harresë

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala, Adivi Kuka

majlindahala@gmail.com, Universiteti i Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura, Tiranë, Shqipëri
dina.kuka@hotmail.it, Mediatore linguistico Culturale, Romë, Itali

Abstrakt

Edukimi dhe kultura artistike formale dhe joformale është pa dyshim, një ndër qëllimet kryesore që duhet të ketë një sistem arsimor. Kjo, për faktin se edukimi dhe artet janë një nga rrugët kryesore që përmbushin dimensionet e brendshme të individit, dimensione të rëndësishme në formimin human dhe qytetar të tij. Edukimi artistik mund të marrë rolin e përmbushësit të nevojave të brendshme të individit për të humanizuar sjelljet e tij. Thënë ndryshe, blloku i lëndëve që realizojnë formimin artistik, muzika, arti pamor, teatri dhe kërcimi, i ofron individit zhvillimin human, intelektual, estetik, social, kulturor dhe afektiv.

Qëllimi i këtij punimi është të shterojë shqetësimet që kanë artistët dhe mësimdhënësit e arteve, duke argumentuar rëndësinë, vendin dhe rolin që duhet të kenë artet në shoqëri.

Pyetjet kërkimore janë: kush është vendi që zënë artet sot në kurrikulën e arsimit parauniversitar?

Analiza krahasuese është realizuar nëpërmjet analizës desk research, duke u bazuar në raporte studimore dhe artikuj të viteve të fundit. Nga analiza ndalemi në tre momente: a) lëndët brenda fushës së arteve; b) orët dhe vendi që zënë në kurrikul në raport me fushat e tjera të nxënësve; c) përfundime dhe rekomandime.

Si përfundim, kjo analizë nxjerr në pah domosdoshmërinë e rishikimit të planit mësimor, dokument i cili vendos në vendin e duhur artet në raport me lëndët e tjera të kurrikulës; numri i orëve të rishikuara krijon mundësinë e zhvillimit më mirë të aftësive artistike të nxënësve duke i orientuar nxënësit drejt profesioneve të artit dhe mësuesisë.

Fjalë kyçe

arte, kurrikul, plan mësimor, orë mësimore

Sfida e integritetit të kërcimit në kurrikulën arsimore kombëtare

Prof. Asoc. Dr. Artan Ibërshimi, Uesli Alushi

artanibershimi@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah rëndësinë dhe rolin që ka arti i kërcimit në systemin parauniversitar në Shqipëri. Ky punim nxjerr në pah domosdoshmërinë e planifikimit të kësaj disipline në kurrikulën kombëtare shqiptare.

Pyetjet kërkimore kërkohen të vërtetojnë pse arti i kërcimit duhet të jetë pjesë e kurrikulës në arsimin parauniversitar në shkollë? Si ndikon kjo disiplinë në zhvillimin kognitiv dhe emocional të nxënësit?

Metodat që do të përdoret në zhvillimin e këtij punimi janë: a) metoda e analizës së burimeve teorike nga autorë të ndryshëm; b) konsultimi i dokumentacionit në fushën përkatëse; c) analiza historiko krahasuese e materialeve referuese; d) përpunimi i analizës e të dhënave të përftuara nga informacioni i grumbulluar; e) vëzhgimi dhe hulumtimi vetjak në terren.

Analizat e kryera dalin në përfundime se disiplina e artit të kërcimit ndihmon zhvillimin e individit sidomos në drejtimin psiko-emocional dhe artistiko-estetik të tij. Në përfundim punimi synon të vërtetojë se arti i kërcimit në shkollë është i domosdoshëm, për zhvillimin e aftësive krijuese, intelektuale dhe fizike të nxënësve në shkollë.

Fjalë kyçe

proces, metodë, planifikim, program mësimor, kërcim

Harmonizimi i programeve të Historisë së muzikës shqiptare në arsimin e lartë të Kosovës dhe Shqipërisë

Asoc. Prof. Dr. Rreze Kryeziu Breznica, Asoc. Prof. EdD. Besa Luzha

rreze.kryeziubreznica@uni-pr.edu, besa.luzha@uni-pr.edu

Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti i Arteve, Departamenti i Muzikës, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Historia e muzikës shqiptare përfaqëson një komponent të rëndësishëm të edukimit muzikor profesional, duke ndikuar në formimin akademik të studentëve dhe në ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar. Megjithatë, programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë dhe Shqipëri shpesh paraqesin dallime të ndjeshme në përmbajtje, metodologji dhe qasje didaktike.

Ky punim synon të analizojë programet ekzistuese dhe të propozojë një model të unifikuar që do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së edukimit muzikor dhe ruajtjen e trashëgimisë muzikore kombëtare. Studimet mbi edukimin muzikor në hapësirën shqiptare janë të kufizuara, por ekzistojnë disa analiza mbi ndikimin e sistemit arsimor në formimin e muzikantëve dhe studiuesve të muzikës. Literatura e disponueshme përmban studime mbi kurrikulat e fakulteteve të muzikës në Shqipëri dhe Kosovë, si dhe analiza krahasimore të modeleve evropiane të edukimit muzikor. Dokumentet zyrtare mbi standardet akademike dhe planet mësimore të miratuara nga institucionet përkatëse janë burime thelbësore për këtë studim. Së bashku me analizën e dokumenteve, janë intervistuar pedagogë të historisë së muzikës, me qëllim kuptimin e sfidave dhe avantazheve të modeleve ekzistuese. Analiza ka evidentuar ndryshime thelbësore midis programeve të studimit, si në qasjen metodologjike ashtu edhe në përmbajtjen e lëndëve të historisë së muzikës shqiptare. Për më tepër, dallimet në literaturën e përdorur dhe format e vlerësimit ndikojnë në formimin e studentëve dhe në mundësitë e tyre për lëvizshmëri akademike. Bazuar në rezultatet e analizës, unifikimi i programeve mësimore të historisë së muzikës shqiptare do të krijonte një standard akademik të unifikuar, duke lehtësuar lëvizjen e studentëve dhe duke garantuar një cilësi më të lartë arsimore. Rekomandohet harmonizimi i plan-programeve në Kosovë dhe Shqipëri, krijimi i një grupi të përbashkët ekspertësh për rishikimin e materialeve didaktike dhe promovimi i bashkëpunimeve akademike. Zbatimi i këtyre ndryshimeve do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e studimeve muzikologjike dhe në ruajtjen e trashëgimisë muzikore shqiptare.

Fjalë kyçe

kurrikul, edukimi muzikor, historia e muzikës shqiptare, harmonizim akademik

Edukimi artistik përmes Muzeut Kombëtar “Marubi”

Andi Hila

andi.hila@unishk.edu.al

Departamenti i Edukimit, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim paraqet pikëpamjet teorike dhe teoritë mbi edukimin artistik përmes vizitave në muzeume, si pjesë e domosdoshme e programit të lëndës “Art pamor” në sistemin arsimor shqiptar.

Punimi ofron një pasqyrë të programeve të artit pamor, duke sjellë përmes trajtimit një sy kritik dhe sugjerime që lidhen me përvojën e përditshme të mësuesve si dhe me përvojat nga vendet e tjera të rajonit në lidhje me edukimin nëpërmjet muzeut.

Ky punim mbështetet në krahasimin e përmbajtjes së programit të kësaj lënde në Shqipëri me shkollën italiane.

Punimi zhvillohet përmes një ankete me fëmijët dhe të rinjtë lidhur me njohuritë që ata kanë për muzetë në Shqipëri dhe jashtë saj, përvojat dhe njohuritë e tyre specifike për to. Bazuar në teori bashkëkohore, përvoja dhe anketimin, punimi ofron sugjerime dhe rekomandime për përmirësim.

Si përfundim, artikulli fokusohet në përvojën e mirë të viteve të fundit të Muzeut Kombëtar “Marubi” në drejtim të edukimit nëpërmjet muzeut në disa drejtime. Aktiviteti i muzeut në fjalë përfshin disa lloje aktiviteteve me fëmijë të grupmoshave të ndryshme.

Fjalë kyçe

art pamor, muzeu, edukimi, kurrikul, sistem

Semiotika dhe interpretimi i krijimeve artistike në grupmoshat 3 deri 18 vjeç

Dr. Oltsen Gripshi

olsi1984@live.it

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi shkencor përqendrohet në interpretimin e krijimeve artistike të fëmijëve dhe të rinjve në grupmoshën 3 – 18 vjeç në edukim, nëpërmjet shkencës së semiotikës. Marrëdhënia midis imazheve përfytyruese të fëmijëve dhe të rinjve dhe vizatimeve që ata krijojnë është shumë e ngushtë. Krijimi i vendos ata përballë dy perceptimeve, atë të krijimit të imazheve përfytyruese e që janë imitime të realitetit brenda botës së tij dhe realizimit të vizatime në letër të tyre. Ky hulumtim mbi vizatimet artistike nga ana e tyre na lejon të kuptojmë simbolikën e tyre në rikrijimin e realitetit sipas përfytyrimit dhe imagjinatës që ata kanë në raport me atë që i rrethon. Për realizimin e këtij punimi, përdoret ndërthurja e metodologjive shkencore, teorike dhe analitike krahasuese, që së bashku do të udhëheqin shtjellimin e temës në mënyrë shteruese. Ato kërkojnë të gjurmojnë gjendjen emocionale dhe psikologjike që fëmijët dhe të rinjtë përcjellin nëpërmjet imazheve të pikturuara, me simbolikat e përdorura për shpërfaqjen e vetvetes nëpërmjet imazheve si dhe interpretimin semiotik për konkretizimin e imazheve.

Ky studim shkencor nxjerr disa përfundime mbi procesin e zhvillimit dhe procesin krijues që ndodh tek fëmijët dhe të rinjtë gjatë përfytyrimit të imazheve dhe deri te realizimi konkret i imazheve artistike, duke evidentuar problematika të ndryshme për temperamentin krijues të tyre. Gjithashtu ky punim rekomandon përdorimin e semiotikës në interpretimin e procesit krijues artistik nga mësuesit e artit pamor në sistemin parauniversitar.

Fjalë kyçe

semiotikë, vizatime, mësimdhënie, art pamor, psikologji

Metodologjia e mësimit të teknikës së skulpturës dhe qeramikës për grupmosha 6-12 vjeç

Dr. Irena Buzi

i_buzi@hotmail.com

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Universiteti Politeknik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim kërkon të prezantojë një program didaktik mbi mësimdhënien e skulpturës dhe qeramikës për grupmoshën 6-12 vjeç. Hapat që ndjek ky program didaktik për këto grupmosha ndahet në tre nivele (A, B, C) ku: niveli A fokusohet në format gjeometrike, niveli B në format natyrore/bimët dhe teknika të ndryshme, dhe niveli C në format e faunës. Ky studim përmes hulumtimit do të shqyrtojë efektivitetin e nivelit B, i cili përfshin stampimin, incizimin, relievin dhe modelimin 3D. Hipoteza e këtij studimi kërkon të vërtetojë problematikën që lidhet me mungesën e një strukture metodologjike në edukimin artistik fillestar formal dhe jo formal, duke kërkuar të ndikojë në hartimin e dokumentacionit formal i cili do të zhvillojë aftësitë krijuese bazuar në njohuri dhe teknika konkrete artistike, të cilat çojnë edhe në krijimin e vetëbesimit të fëmijëve.

Metodologjia është ndërtuar mbi analiza cilësore dhe sasiore, duke përfshirë vëzhgime të drejtpërdrejta, analiza të portofolit të punimeve të fëmijëve, bazuar në vëzhgimin e 13 fëmijëve të angazhuar në nivelin B. Rezultatet paraprake tregojnë se qasja e strukturuar ndihmon zhvillimin progresiv të aftësive artistike, rrit krijimtarinë dhe nxit mendimin kritik dhe krijues. Përveç aftësive teknike, fëmijët tregojnë përparim në vetëbesim dhe angazhim artistik.

Studimi vërteton dhe thekson domosdoshmërinë e strukturimit të qartë të kurrikulave të artit pamor veçanërisht në teknikën e skulpturës dhe qeramikës. Këto rezultate mund të shërbejnë si bazë për pasurimin e metodologjive të artit pamor, i cili shërben drejtpërdrejt në zhvillimin e aftësive krijuese, kritike të fëmijëve, rritjen e vetëbesimit, shprehjen emocionale përmes punimeve të tyre.

Fjalë kyçe

edukim artistik, gjuha e formës, krijimtari artistike

Roli i edukimit muzikor në zhvillimin e artistëve të rinj për skenën operistike

Ulpiana Aliaj

ulpiana.aliaj@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky studim shqyrton rëndësinë e një qasjeje të integruar pedagogjike në edukimin e këngëtarëve: solistë apo koristë, ku një rol shumë të rëndësishëm luajnë komponentët emocionalë, fizikë, bashkëpunues dhe kulturorë të cilat ndërthuren natyrshëm me përgatitjen vokale të artistit. Në një realitet ku kërkesat ndaj interpretuesve janë në rritje të vazhdueshme, qëllimi i këtij studimi është të analizojë se si edukimi përmes muzikës kontribuon jo vetëm në aftësitë teknike, por edhe në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve njohëse, emocionale dhe shoqërore të artistëve. Ndaj ky studim ngre disa pyetje: Si përgatiten artistët e rinj për sfidat e skenës operistike? Cilat janë disa aspekte që formojnë artistin e ri përtej aftësive vokale?

Hulumtimi ndjek një metodologji cilësore, duke përfshirë analiza dhe intervista me pedagogë të muzikës vokale, regjisorë opere dhe artistë aktivë, si dhe vëzhgime në ambientet mësimore dhe provat e ansambleve vokale.

Gjetjet tregojnë se qasja e integruar pedagogjike e balancuar mes teknikës dhe ndjeshmërisë artistike, krijon kushte optimale për zhvillimin e qëndrueshëm të interpretuesve që janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre artistike dhe shoqërore. Një qasje e tillë nxit vetëreflektimin, disiplinën, bashkëpunimin dhe aftësinë për të komunikuar emocionalisht me audiencën. Ky studim rekomandon zgjerimin e përmbajtjeve ndërdisiplinore dhe forcimin e mentorimit profesional për të mbështetur një brez të ri solistësh dhe koristësh të përgatitur për sfidat estetike dhe humane të skenës moderne.

Fjalë kyçe

pedagogji vokale, zhvillim emocional, bashkëpunim artistik, ndjeshmëri estetike

Ndikimi i pedagogjisë vokale tek këngëtarët sipas zhanreve të ndryshme muzikore

Linda Kazani

lindakazani@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtojë ndikimet e pedagogjisë vokale në teknikën e këndimit për këngëtarë të zhanreve të ndryshme muzikore. Pavarësisht karakteristikave specifike të zhanreve muzikore vokale, ato duhet të këndohen me një teknikë të pastër vokale, në muzikalitet dhe interpretimin e duhur vokal. Teknika e këndimit mbështetet në aftësitë disponuese vokale të këngëtarit, aftësi që u jep mundësinë për të përdorur zërin e tyre në mënyrë optimale në zhanre të ndryshme vokale.

Një nga pyetjet kërkimore që duam të vërtetojmë në këtë punim është: A njihen parimet dhe metodat themelore të pedagogjisë vokale nga këngëtarët për zhanre të ndryshme muzikore? Gjatë analizimit dhe dokumentimit të përdorimit të teknikës vokale sipas zhanreve të ndryshme, ndoqëm metodologjinë empirike, të rasteve të shumta, para dhe pas efektit të didaktikës pedagogjike vokale, pra mënyrës së impostimit të zërit, pavarësisht zhanrit në të cilin kryhet procesi i këndimit.

Ky proces i cili bazohet në mënyrën e impostimit sipas zhanrit, u mbështet në disa hapa si: intonacioni, diapazoni vokal, stabiliteti i zërit, kontrolli i ajrit, artikulimi, rezonanca. Si përfundim, arrijmë të deklarojmë se përdorimi i këngëtarëve në të gjithë zhanret muzikore mbështetet në impostimin e duhur të vokalit, për interpretimin e duhur të zhanreve të ndryshme muzikore vokale.

Fjalë kyçe

vokal, zhanër muzikor, impostim, teknika pedagogjike, teknika këndimi

Arbërishtja dhe shqipja standarde: Dallime gjuhësore dhe rreziku i zhdukjes

Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana

manjolarshana@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Arbërishtja është një dialekt me rëndësi historike i gjuhës shqipe, i folur nga komunitetet arbëreshe në Italinë Jugore, pasardhës të shqiptarëve që u larguan nga Ballkani midis shekujve XV dhe XVIII si pasojë e zgjerimit osman. Duke i përkitur degës toske të shqipes, arbërishtja ruan një sërë tiparësh gjuhësorë arkaikë që janë zhdukur nga shqipja standarde. Në të njëjtën kohë, ajo ka pësuar ndikime të konsiderueshme nga italishtja dhe greqishtja, duke krijuar një përzierje të veçantë mes ruajtjes dhe përshtatjes gjuhësore.

Dallimet gjuhësore midis arbërishtes dhe shqipes standarde shfaqen në fonologji (p.sh., zëvendësimi i tingullit “ë” me “a” dhe ruajtja e formave të vjetra vendore si mbë), në leksik (përdorimi i termave arkaikë dhe i huazimeve të shpeshta) dhe në morfosintaksë (si format e vjetra të foljeve dhe nyjeve të shquara). Këto elemente e dallojnë arbërishten si një trashëgimi të çmuar gjuhësore dhe kulturore.

Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së saj historike dhe etnolinguistike, arbërishtja sot është në rrezik kritik. Numri i folësve aktivë po bie me shpejtësi, veçanërisht ndër brezat e rinj që janë tërësisht të asimiluar në shoqërinë italofone. Mungesa e një standardi të unifikuar dhe prania e kufizuar në sistemin arsimor e bëjnë këtë dialekt edhe më të brishtë.

Kjo analizë mbështetet në një qasje cilësore, përmes shqyrtimit krahasues të burimeve gjuhësore dhe etnografike. Janë analizuar materiale të shkruara dhe të folura në arbërisht (si këngë popullore, lutje, poezi dhe intervista të dokumentuara), krahasuar me strukturat e shqipes standarde. Gjithashtu, janë përfshirë studime të mëparshme në fushën e sociolinguistikës dhe dokumentimit të gjuhëve në rrezik, për të vendosur arbërishten në një kontekst më të gjerë teorik dhe praktik.

Ky punim shqyrton statusin aktual të arbërishtes, dallimet e saj gjuhësore me shqipen standarde dhe ndikimet më të gjera sociolinguistike që lidhen me rënien e saj.

Fjalë kyçe

arbërishtja, dialekt, dallime gjuhësore, rreziku i zhdukjes

Arkitektura e mijes: Rikonceptimi i Muzeve dhe hapësirave urbane si territore të kreativitetit dhe edukimit

Angela Bushati

2307822@my.aub.ac.uk

MACHmit! Muzeum për Fëmijë, Berlin, Gjermani dhe Arts University Bournemouth, Angli

Abstrakt

Hapësirat publike urbane po njihen gjithnjë e më shumë si mjedise transformuese për kreativitetin, edukimin dhe angazhimin social. Ky artikull vëzhgon në detaje se si dizajni hapësinor dhe strategjitë kuratoriale ndikojnë në të nxënit pjesëmarrës dhe angazhimin krijues brenda këtyre hapësirave. Duke analizuar qasjet ndërdisiplinore në muze, galeri dhe dizajnin e hapësirave urbane, studimi synon të evidentojë mënyrat se si këto mjedise mund të kontribuojnë në mendimin kritik, modalitetet e të nxënit multimodal dhe përfshirjen sociale.

Qëllimi kryesor i këtij rishikimi është të sintetizojë literaturën ekzistuese mbi muzetë, galeritë e artit, etj., përmes një qasjeje edukative të artit, me fokus në pedagogjinë urbane dhe praktikën krijuese hapësinore. Ky rishikim drejtohet nga pyetje: Si ndikojnë konfigurimet hapësinore në përvojat krijuese dhe edukative? Cilat qasje ndërdisiplinore angazhojnë audiencat e ndryshme? Si mund të shërbejnë hapësirat publike dhe muzeale si platforma për prodhimin kolektiv të dijes?

Ky studim përdor një qasje sistematike të rishikimit të literaturës, duke u mbështetur në studime mbi muzeologjinë, teorinë edukative dhe dizajnin hapësinor. Ky punim sintetizon debatet mbi të nxënit pjesëmarrës, angazhimin shqisor, edukimin e artit dhe kreativitetin. Gjetjet theksojnë rëndësinë e krijimit të hapësirave fleksibile, interaktive dhe gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në mendimin kritik dhe nxitjen e kreativitetit, duke vënë në pah njëkohësisht kufizimet e imponuara nga kornizat institucionale më tradicionale dhe të ngurta.

Ky rishikim avokon për rikonceptimin e hapësirave publike si ekosisteme dinamike dhe në zhvillim të dijes, të cilat mbështesin të nxënit ndërdisiplinor, eksperimental dhe nxisin kreativitetin, bashkëkrijimin si dhe drejtësinë sociale. Këto hapësira jo vetëm që veprojnë si vende të ruajtjes kulturore, por edhe si katalizatorë të inovacionit, mendimit kritik dhe mjete të rëndësishme kulturore për mbështetjen e praktikave edukative gjithëpërfshirëse që promovojnë fuqizimin.

Fjalë kyçe

edukimi i artit, pedagogjia krijuese, të nxënit pjesëmarrës, mjedise interaktive ndërdisiplinore

Reumatologjia në Art

Ervin Rapushi, Artur Zoto, Teuta Backa

dr.ervini2006@yahoo.it

Universiteti i Mjekësisë, Shërbimi i Reumatologjisë, QSUNT, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Sëmundjet reumatizmale janë patologji sistemike autoimune me prekje multiorganore. Në zhargonin e përgjithshëm reumatologjia nënkupton prekjen e kyçeve, muskujve, por reumatologjia shkon shumë përtej duke u bërë një nga degët e mjekësisë atraktive për artistët duke përshkruar disa shenja patognomonike të sëmundjeve reumatizmale në art.

Në shumë tablo gjenden tipare të sëmundjeve reumatizmale ku autori duke dashur të jetë sa me afër origjinalit i ka pikturuar ato përpara se ato të përcaktoheshin si patologji specifike. Në një rishikim të veprave të artit të cilat datojnë nga Mesjeta, Rilindja dhe post-impresioniste gjenden shumë tipare të sëmundjeve reumatizmale të OAI, AR, arteritit temporal, sclerodermis, vaskuliteve, etj. Nga ana tjetër, artistë të mëdhenj si Pirre-Auguste Renoir, Antoni Gaudí, Raoul Dufy, Paul Klee, Frida Kahlo dhe Niki de SaintPhalle janë shembuj të mirë se si sëmundjet reumatizmale dhe dhimbja kronike mund të ndikojnë në këndvështrimin e artistit, teknikën e përdorur dhe përmbajtjen e punës së tyre. Arti mund të shërbejë si një burim i fuqishëm për të kuptuar rrjedhën natyrore të sëmundjeve reumatizmale e pasyqruar kjo në shumë punime të artistëve në telajo të një personazhi në vite. Citokinat proinflamatore të cilët janë “aktorët” kryesorë të fispatologjisë së sëmundjeve reumatizmale janë përshkruar nga Da Vinci, Van Gogh në tabllotë e tyre, përpara se të zbuloheshin në këtë shekull.

Duke mësuar përmes syve të artistit sesi sëmundjet sillen dhe evoluojnë në kohë, reumatologët e kanë të mundur të gjurmojnë historinë dhe dekursin e sëmundjeve reumatizmale. Përmes analizës së detajuar e kronologjike të punës së artistëve, mund të zbulojmë disa aspekte të sëmundjeve reumatizmale që vetëm shkenca nuk mund t'i sqarojë.

Fjalë kyçe

tablo, art, histori, radiologji, reumatologji

Simbolika e vdekjes në poezinë e D. Agollit

Prof. Asoc. Dr. Rovenà Vata Mikeli

rovena_vata@hotmail.com

Akademia e Shkencave të Shqipërisë

Abstrakt

Ky studim ka si qëllim simbolikën e vdekjes në poezinë e shkrimtarit D. Agolli dhe shpërfaqjen e saj në vargun poetik shqiptar. Studimi merr përsipër gjetjen, analizimin dhe promovimin e vargjeve poetike agolliane nën dritën e studimit letrar, për të bërë të njohur aspektin e tij poetik në arenën ndërkombëtare, përmes magjisë së vargut kushtuar: simbolikës së vdekjes në veçanti dhe vdekjes në përgjithësi.

Realizimi i këtij studimi do ketë parësore kombinimin e metodave teorike, cilësore dhe analitike, me përfshirjen herë pas here të metodës historiko-kulturore interpretative, përmes të dhënave historike.

Pse D. Agolli përfshiu këtë element në vargun e tij poetik para dhe pas viteve 1990?

Dritëro Agolli i përket atij grupi që në historinë e letërsisë shqipe njihen me emërtimin si “brezi i viteve ’60”, ku së bashku me Ismail Kadarenë dhe Fatos Arapin, i sollën letërsisë shqipe një frymë të re (të gjysmës së dytë të shekullit XX), një frymë që prirej drejt një letërsie më cilësore, sa u takonte elementeve të formës artistike, por edhe në drejtimin e zgjerimit të pasurimit të temave letrare.

Kujtojmë që letërsia shqipe në atë periudhë ishte nën zhvillimin e metodës së realizmit socialist, ku letërsia kishte karakter më tepër ideologjik dhe politik, por një emër si D. Agolli edhe pse në këto kushte, arriti të sillte vlera të mirëfillta artistike letrare në letërsinë shqipe.

Krijimtaria poetike e Dritëro Agollit ndryshoi fytyrën e së ardhmes së poezisë shqipe. Ai i këndoi dashurisë së tokës ku u rrit, njeriut të thjeshtë, gjuhës shqipe, sinqeritetit dhe komunikimit njerëzor, ndjenjave shpirtërore dhe virtyteteve njerëzore, si: dashurisë, besimit, shpresës, mirësisë, gëzimit, bujarisë, pasionit, mërzisë, braktikjes, vetmisë, por edhe proceseve jetësore të vetë njeriut, si: fëmijërisë, rinisë, pjekurisë, pleqërisë, vdekjes. Pikërisht simbolikën e vdekjes do e kemi objekt trajtesë në këtë kumtesë, ku është një ndër elementet mbizotërues në poezinë e tij.

D. Agolli si poet është një emër, që vendosi vargun në gjithë sistemin e jetës së tij. D. Agolli shkroi poezi gjatë gjithë jetës së tij. Pra poezia e D. Agollit shtrihet në dy kohë, para viteve 1990 dhe pas viteve 1990.

Fjalë kyçe

poezi, simbolikë, kohë, vdekje, ironi

Rëndësia e komunikimit jo verbal në marrëdhëniet mësues - nxënës

Mirela Vitaj, Mimoza Marko, Vitori Gjonaj, Aurora Zekaj, Gjylie Cela
ilva83@hotmail.it

Shkolla 9 vjecare "Musa Cakërri, Shkolla 9 vjecare "Rilindja" Vlorë, Shqipëri

Abstrakt

Komunikimi jo verbal është një nga elementet ndërveprues mes mësuesve dhe nxënësve, që shkon përtej fjalëve dhe luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin e një mjedisi mësuesor produktiv dhe harmonik. Objektivi kryesor i këtij punimi kërkimor është të analizojë ndikimin e komunikimit jo verbal në marrëdhëniet mësues-nxënës, duke shqyrtuar se si ky lloj komunikimi mund të ndikojë edhe në angazhimin, motivimin e nxënësve, përmirësimin e marrëdhënieve mësues-nxënës dhe efektet pozitive në procesin e mësimit.

Hipoteza kryesore që duam të vërtetojmë përmes këtij punimi është: përdorimi i komunikimit jo verbal nga mësuesit ka një ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e një mjedisi mësuesor më të ngrohtë dhe më angazhues, duke ndikuar pozitivisht në marrëdhëniet mësues-nxënës si dhe në motivimin e nxënësve për të mësuar. Ky punim ngre disa pyetje kërkimore, të cilat duan të vërtetojnë ndikimin e komunikimit jo verbal në forcimin e marrëdhënieve mësues - nxënës, angazhimin e nxënësve në procesin mësuesor, rritjen e efikasitetit gjatë mësimit. Metodologjia bazohet në analizat sasiore dhe cilësore, kryer a) vëzhgime ndaj elementëve të komunikimit jo verbal në mjedise shkollore dhe b) intervista me mësues c) intervista me nxënës duke u ndalur në çdo të dhënë konkrete mbi ndikimet që dalin nga komunikimi midis aktorëve. Gjetjet dhe rezultatet tregojnë se mësuesit që përdorin komunikimin jo verbal në mënyrë të vazhdueshme krijojnë një lidhje më të fortë me nxënësit, duke kontribuar në një atmosferë më të hapur dhe mbështetëse.

Ndaj ky studim tregon rëndësinë e komunikimit jo verbal në klasë dhe e vë në dukje se përdorimi i tij mund të rrisë angazhimin dhe motivimin e nxënësve, duke krijuar një atmosferë më të ngrohtë në përmirësimin e marrëdhënieve mësues-nxënës.

Fjalë kyçe

komunikimi jo verbal, marrëdhënia mësues-nxënës, motivim, mjedis mësuesor

Disiplina në orët mësimore

Saranda Nitaj

sarandanitaj00@gmail.com

Universiteti “Haxhi Zeka”, Fakulteti i Arteve, Pejë, Kosovë

Abstrakt

Ky punim synon të hulumtojë rolin dhe rëndësinë e disiplinës në orët mësimore, duke u fokusuar në metodat dhe praktikat konkrete që përmirësojnë të nxënin, duke krijuar një mjedis motivues për nxënësit. Disiplina në klasë është thelbësore për mbajtjen e rregullit dhe përmirësimin e performancës akademike të nxënësve.

Ky punim kërkon të hulumtojë përmes disa strategjive të disiplinës që zbatohen në mjedisin e shkollës dhe vërtetojë ndikimin e këtyre strategjive në motivimin dhe angazhimin e nxënësve në procesin mësimor.

Nëpërmjet analizave të këtyre strategjive në procesin mësimor, do të identifikohen faktorët që ndikojnë në ndërtimin e një atmosfere disiplinore pozitive dhe efektive, si dhe vlerësimin e risive dhe sfidave që vijnë përmes zbatimit të disiplinës së duhur në orët mësimore, duke i ndihmuar mësuesit dhe nxënësit të arrijnë rezultate sa më të mira.

Fjalë kyçe

disiplina, orë mësimore, mësimdhënia, motivimi, proces mësimor

Tefta Tashko Koço, këngëtarja lirike urbane në epokën digjitale

Ardi Pulaj, Prof. Edith Mihali

ardipulaj@live.com

Universiteti European i Tiranës (UET), Shqipëri

Abstrakt

Në epokën digjitale, muzika urbane lirike gjen pak hapësirë në platformat si Spotify dhe YouTube. Tefta Tashko Koço, pavarësisht kontributit të dhënë në muzikën shqiptare, sa e njohur dhe e dëgjuar është nga publiku i ri?

Studimi hedh një vështrim pranisë së këngëve të Tefta Tashko Koços në YouTube dhe Spotify dhe njëkohësisht vlerëson interesin e audiencës. Gjatë kërkimit në Spotify, gjenden vetëm dy këngë të artistes Tefta Tashko ‘Koço’: “Për një ditë kur del goca në pazar” me 0 dëgjime dhe “Zare Trëndafille” me 3058 dëgjime deri më 17 mars 2025. Ato janë pjesë e një playlist-e me 24 këngë të ndryshme popullore shqiptare me minutazh total 79 min.: “Albanian Folk Songs”, 78 rmp recordings, Vol. 1, 2019, Golden Century Records. Në YouTube, “Zare Trëndafille” deri më 17 mars 2025 shfaqet në disa video, ku më e klikuara ka 73375 shikime, e ngarkuar tetë vjet më parë nga përdoruesi Albanian History. Videoja më e klikuar kur kërkon “Për një ditë kur del goca në pazar”, deri në të njëjtën datë, në YouTube rezulton me 8492 shikime, e ngarkuar nga përdoruesi Ajet Nallbani, 15 vjet më parë.

Pavarësisht repertorit të pasur të lënë në muzikën lirike urbane shqiptare, ky studim, tregoi për numrin dhe impaktin e ulët të këngëve të Tefta Tashko Koços te audienca në Spotify dhe YouTube. Kjo gjetje tregon nevojën që prania digjitale e veprës së saj, nuk duhet lënë vetëm në dorën e përdoruesve të rastësishëm. Institucionet shtetërore kulturore duhet të marrin në dorë promovimin, me krijimin e playlist-ave në Spotify dhe YouTube, duke respektuar të drejtat e autorit.

Fjalë kyçe

muzika lirike, digjitalizimi, Spotify, YouTube, promovimi

E drejta e autorit dhe digitalizimi i pronësive intelektuale artistike

Prof. Asoc. Dr. Saimir Shatku

s_shatku@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Vitet e fundit, mund të themi se e gjithë bota është në një revolucion të vazhdueshëm të përdorimit të teknologjisë dhe shpërndarjes së informacionit në mënyrë të shpejtë dhe efikase, duke eliminuar barrierat e mëparshme që ekzistonin ndërmjet vendeve.

Dixhitalizimi po ecën me hapa gjigandë, në një botë ku largësia po e humb efektin e saj dhe marrëdhëniet po konkretizohen çdo herë nëpërmjet botës virtuale dhe dixhitale. Teknologjia në këtë aspekt luan rolin e saj të padiskutueshëm, pasi me përsosjen e funksionimit dhe metodave të saj, janë krijuar kushte favorizuese për krijimin dhe shfrytëzimin e veprave dixhitale. Ky shfrytëzim dhe përdorim i tyre nuk është i njëjtë kudo në botë, pasi në vende të ndryshme përdorja e veprave dixhitale konsiderohet e ndryshme dhe jo gjithmonë përbën cenim të së drejtë së autorit, e aq më tepër në procesin e krimtarisë dhe modaliteteve artistike.

Çdo individ, krijues apo artist, është i aftë të krijojë një vepër dixhitale dhe të ushtrojë të drejtat kryesore që burojnë prej saj duke ndërmarrë gjithashtu të gjitha veprimet për përdorimin e lirë dhe sipas dëshirës së tij të kësaj vepre. Është e pamundur që në një mjedis dixhital, të mos të ketë krijimtari nga shumë individë, të cilët në mënyrë që të thjeshtëzojnë mënyrat e jetesës të ndikohen duke ndërmarrë veprime të ndryshme, të cilat lidhen me riprodhimin e tyre për efekte përfitimi ose lehtësimi.

Shpeshherë këto mënyra riprodhimi të këtyre veprave, nuk realizohen sipas kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni, por krijojnë kushte për abuzime, duke cenuar të drejtat e autorëve real të këtyre të drejtave. Kjo gjë nodh rëndomtë dhe në krimtarinë artistike.

Për këtë arsye, e drejta për përdorim vetjak e veprave dixhitale, është shumë e rëndësishme, në mjedisin virtual nga i cili rrethohemi dhe në mënyrë që të mos krijojë shkaqe për abuzime, është e nevojshme që të njihemi me aspektet më të rëndësishme që ajo trajton.

E drejta e konkurrencës, dhe e drejta e pronësisë intelektuale, si dhe e drejta artistike, janë dy të drejta të rëndësishme për këdo individ në afirmimin e tij, që shpeshherë përplasen me njëra tjetrën duke krijuar në këtë mënyrë kushte për përfitime të padrejta dhe cenim të tyre nga njëri tjetri.

Në këtë aspekt, është detyrë e shtetit si rregullator, që nëpërmjet masave konkrete dhe reformave të ndërmarra nga ana e tij, të krijojë kushte për parandalimin e këtyre shkeljeve dhe rregullimit të pasojave konkrete në një masë të gjerë për për mbrojtjen e produktit intelektual, si dhe duke shpërblyer dhe dëmin e shkaktuar e fitimit e munguar përmes kontratave artistike apo aktmarrëveshje artistike.

Në këtë aspekt, është detyrë e shtetit si rregullator, që nëpërmjet masave konkrete dhe reformave të ndërmarra nga ana e tij, të krijojë kushte për parandalimin e këtyre shkeljeve dhe rregullimit të pasojave konkrete në një masë të gjerë për mbrojtjen e produktit intelektual, si dhe duke shpërblyer dhe dëmin e shkaktuar e fitimit e munguar përmes kontratave artistike apo aktmarrëveshje artistike.

Fjalë kyçe

e drejta artistike autorit, pronësia intelektuale, mbrojtje ligjore, abuzim, riprodhim

Globalizimi, ndikimi i kësaj dukurie në zhanret muzikore në Kosovë

Endona Bardhi

endona.bardhi@icloud.com

Universiteti “Haxhi Zeka”, Fakulteti i Arteve, Pejë, Kosovë

Abstrakt

Globalizmi është një proces kompleks që i referohet rritjes së ndërvarësisë dhe lidhjeve ndërkombëtare mes shteteve, ekonomive, kulturave dhe njerëzve në të gjithë botën. Ky proces përfshin: globalizmin ekonomik, kulturor dhe politik. Studiuar nga ky këndvështrim globalizimi ka sjellë ndryshime të thella në të gjitha fushat e jetës shoqërore, përfshirë edhe muzikën. Ky proces ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe diversitetin e zhanreve muzikore, dukuri e cila ka ndikimin e vet edhe në Kosovë. Studimi synon të shqyrtojë ndikimet e globalizimit në zhvillimin e zhanreve të muzikës shqiptare, me fokus në lëvizjen dhe ndërveprimin e stileve dhe kulturave muzikore nga mbarë bota, përmes kontributit dhe rritjes së aksesit të muzikës ndërkombëtare përmes teknologjisë dhe mediave, duke mundësuar përhapjen e ndikimeve të reja në muzikën popullore, rock, hip-hop dhe muzikën elektronike në Kosovë.

Ky studim merr përsipër të shqyrtojë efektet e ndërveprimeve të zhanreve të muzikës shqiptare në identitetin kulturor dhe shoqëror të Kosovës, si dhe sfidat dhe mundësitë që ofron ky proces për industrinë muzikore vendore. Për arritjen e rezultateve të këtij hulumtimi, është përdorur metoda empirike e mbledhjes dhe e paraqitjes së të dhënave përmes studimeve dhe pyetësorit si dhe metoda deskriptive, për të përshkruar elementet dhe karakteristikat e monstrës së përdorur për të arritur në rezultatin e kërkuar të temës që është shqyrtuar.

Fjalë kyçe

fenomen, kulturë, zhanre muzikore, teknologji, modernitet

Psikologjia e ndërmjetësimit, impakti i metodës

Amalia Koleka

Ndërmjetësuese kulturore

Abstrakt

Psikologjia e ndërmjetësimit bazohet në metodën dhe në parimin e ndërlidhjes midis formës dhe përmbajtjes, si dhe në fuqinë e angazhimit artistik. Ky studim shqyrton sesi ndërmjetësimi, si praktikë, nxit kuriozitetin dhe rikonfiguron dinamikat tradicionale, duke adresuar çështje thelbësore si autoritarizmi dhe ndarja sociale.

Përmes një kornize metodologjike të strukturuar, ky kërkim analizon rezultatet e integrimit të ndërmjetësimit brenda kurrikulave arsimore dhe hapësirave publike, si dhe ndikimin e tij në kreativitet, zhvillimin kognitiv dhe ndërgjegjen shoqërore. Parimet e ndërmjetësimit zbulojnë kuriozitetin pozitiv duke iu qasur krijimit dhe kuptimit në mënyrë holistike, pa sakrifikuar strukturën e nevojshme për stabilitetin shoqëror.

Studimi gjithashtu përqendrohet në një qasje krahasimore me të tjera raste për të mbledhur praktikatat më të mira dhe ofron njohuri mbi potencialin e ndërmjetësimit si një mjet i fuqishëm pedagogjik. A mund të ketë integrimi i kësaj praktike në hapësirat publike dhe në kurrikulat arsimore një efekt zinxhir, dhe çfarë mund të na mësojë metodologjia e ndërmjetësimit artistik në epokën e teknologjisë?

Fjalë kyçe

ndërmjetësim, hapësira publike, kurrikul, metodologji

Modernizimi i operës shqiptare pas vitit 1990: Qasja eksistencialiste dhe serializmi në operan moderne shqiptare Dhoma të kompozitorit Ermir Dergjini

Valmir Xoxa

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë transformimet e muzikës shqiptare pas vitit 1990, me fokus të veçantë në shprehjet dhe risitë muzikore që kanë ndikuar në modernizimin e operës shqiptare. Në këtë kontekst, do të shqyrtohet opera “Dhoma” e kompozitorit Ermir Dergjini, duke eksploruar elementet muzikorë, stilistikat dhe teknikat kompozicionale që e veçojnë këtë vepër si një shembull të rëndësishëm të këtij zhvillimi.

Punimi do të mbështetet në një analizë krahasuese dhe strukturore të operës “Dhoma” të Ermir Dergjinit, duke shqyrtuar përdorimin e teknikës dodekafonike dhe parimeve të serializmit në ndërtimin muzikor të veprës. Për këtë qëllim, janë përdorur metoda analitike muzikore, duke përfshirë: analizën e partiturës – studimin e elementeve stilistikë dhe teknikave kompozicionale – krahasimin me krijimtarinë e kompozitorëve si Alban Berg dhe Anton Webern. Analiza do të përqendrohet në mënyrën se si Dergjini ka shfrytëzuar përvojat bashkëkohore për të krijuar një gjuhë të re muzikore, si dhe në ndikimin dramaturgjik të operës në kontekstin e evolucionit të muzikës shqiptare.

Nga një perspektivë kritike dhe qëndrim personal, vepra shihet si një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të operës shqiptare, por njëkohësisht ngre pyetje mbi aksesueshmërinë dhe ndikimin e saj te dëgjuesi. Përkundër kompleksitetit të saj, muzika e Dergjinit arrin të krijojë një lidhje të fuqishme emocionale dhe dramatike me tekstin, duke dëshmuar se eksperimentimi muzikor mund të bashkëjetojë me një thellësi të madhe shprehëse.

Fjalë kyçe

opera “Dhoma”, transformim, modernizim, ekzistencializëm, serializëm

Krijimtaria muzikore e Zeqirja Ballatës, një mes i artë mes traditave muzikore popullore dhe muzikës bashkëkohore

Jetmir Zaganjori

j.zaganjori94@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Punimi i kushtohet kompozitorit Zeqirja Ballata, një nga kompozitorët më të shquar shqiptarë të shekullit XX, krijimtaria e të cilit ka zënë vend të merituar në repertorin e muzikës mbarëshqiptare. Përmes analizimit të krijimtarisë së tij, do të argumentohet se krijimtaria e tij përfaqëson një ekuilibër të rrallë mes traditës dhe inovacionit.

Elementet e muzikës popullore shqiptare bashkëjetojnë me teknikat e avancuara të kompozicionit bashkëkohor, duke krijuar një gjuhë muzikore që është kombëtare dhe evropiane. Do të shqyrtojmë, si muzika e Ballatës mbështetet në trashëgiminë kulturore popullore dhe si e përdor atë për të eksploruar mundësi të reja në harmoninë, ritmin dhe strukturën formale.

Punimi vë në dukje se Ballata ka arritur të integrojë motive muzikore tradicionale, ritme dhe ngjyra instrumentale karakteristike të muzikës shqiptare, të cilat i transformon në një kontekst modern. Ai ka bashkuar tingujt autentikë shqiptarë me tendencat më të avancuara evropiane, përfshirë serializmin, modalizmin dhe teknikat aleatore. Ky proces ka krijuar një gjuhë muzikore unike, ku identiteti shqiptar ruhet dhe zhvillohet, duke u bërë pjesë e një peizazhi të gjerë artistik.

Kjo ndërthurje ka krijuar harmoni mes elementeve tradicionale dhe bashkëkohore, duke e çuar muzikën shqiptare në Kosovë, nga fazat paraprofesioniste drejt atyre profesioniste e bashkëkohore. Vend të veçantë në punim zënë disa vepra, ndër më përfaqësueset të Ballatës, të cilat i kemi shqyrtuar në detaje, me fokus të veçantë në mënyrat se si ai ka përdorur materialin folklorik si bazë për ndërtimin e një stili modern, inovativ dhe me identitet të qartë. Punimi do të dokumentojë rëndësinë e kontributit të Ballatës në zhvillimin e muzikës shqiptare të shek. XX-XXI!

Fjalë kyçe

muzikë popullore shqiptare, kompozicion bashkëkohor, modalizëm, serializëm, teknika aleatore

Edmond Buharaja – “Tërësia e polisemizmit morfologjik”, vështrim i përgjithshëm mbi strategjitë dhe teoritë analitike

Pirro Gjikondi

pirro.gjikondi@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Edmond Buharaja (Durrës 1963 – 2024) na paraqet një thellësi dhe një shumanshmëri të pazakontë në studimet e mirëfillta në fushën e muzikologjisë sistematike, analizës muzikore dhe kompozimit. Qëllimi i këtij kumtimi është të hedhë një vështrim të përgjithshëm mbi strategjinë dhe mbi disa teori analitike dhe shkencore që Buharaja ka përdorur në veprën e tij të fundit “Tërësia e polisemizmit morfologjik”, studim monografik mbi Sonatën për pianoforte në si minor të Franz Liszt-it.

Baza metodologjike e kësaj kumtese mbështetet në përcaktimin e objektivit kryesor të Buharasë: a) Përcaktimi i një strukture formale të sonatës duke u nisur nga një analizë e teorisë mbi format “formenlehre” e zhvilluar nga fillimi i shek. të XVIII dhe perceptimit personal të Liszt-it mbi të ashtuquajturën “formenbildung”(krijimi i formës). b) në teoritë dhe metodologjitë analitike të përdorura prej tij në përcaktimin e kësaj strukture formale. Në këtë kuadër trajtohen çështje të analizës muzikore që domosdoshmërisht kërkojnë marrjen në konsideratë të tri teorive të veçanta analitike: teorinë e analizës schenkeriane, teorinë neorieamanniane dhe seth-theory mbi muzikën post-tonale. Përveç këtyre teorive trajtohen gjithashtu edhe disa këndvështrime dhe perspektiva të rëndësishme mbi studimin e formës së sonatës, siç janë: “Elements of the Sonata Theory” – James Hepokoski e Warren Darcy e të analizës së përgjithshme mbi format muzikore si “Analyzing Classical form” – William E. Caplin.

Duke pasur parasysh faktin që kjo kumtesë përbën vetëm përmbledhjen e një pjese të një studimi të mëtejshëm dhe më të detajuar mbi këtë vepër, mund të themi që: a) rezultati e këtij kumtimi qëndron në realizimin e mundshëm dhe sintetik të një ideje kryesore: mënyra se si Buharaja ka arritur të shfrytëzojë njohjen e thellë të teorive analitike muzikore për përcaktimin koherent të strukturës së formës në sonatën për pianoforte në si minor të Franz Liszt-it. b) përfundimi i arritur; të dëshmojë sintetikisht thellësinë e mendimit dhe studimit poliedrik të Edmond Buharasë.

Fjalë kyçe

Edmond Buharaja, analizë, Liszt, sonata, pianoforte

Disa reflektime mbi përfaqësimin zanor të stuhisë: Retorika, estetika dhe funksionet didaktike të një tropi muzikor

Dr. Fabio M. Rocchi

fabio.rocchi@unitir.edu.al

Fakulteti Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i këtij hulumtimi është studimi i paraqitjes së stuhisë në muzikë. Shfaqjet dhe evoluimet e saj, të vëzhguara në një periudhë që varion nga shekulli i tetëmbëdhjetë deri në fillim të shekullit të njëzetë, janë me interes të konsiderueshëm për të hedhur dritë mbi atë periudhë në të cilën, në disa traktate të shekullit të shtatëmbëdhjetë, lindi koncepti i retorikës muzikore.

Vivaldi është i pari që ia doli t'i japë formë mimetike (në kuptimin platonik) këtij fenomeni natyror. Që nga ai moment, nga *Il cimento dell'Armonia e dell'Invention* e vitit 1725, nisi pasuria e një tropi të vërtetë muzikor që do të kalonte shekujt dhe do të interesonte një numër shumë të lartë kompozitorësh, ndër të cilët spikasin Rossini, Beethoven, Liszt, Verdi dhe Strauss. Qëllimi i hulumtimit është të rindërtojë zonat stilistiko-shprehëse të paraqitjes së stuhisë në muzikë, duke dhënë një pasqyrë të transformimeve të saj.

Metodologjia e përdorur do të fokusohet në një analizë formale, stilistike dhe harmonike të rezultateve, sipas një përjasje metodologjike krahasuese që merr parasysh si konstantet ashtu edhe variacionet historike. Rezultati do të jetë rindërtimi i një kanoni referues veprash në të cilat realizimi i tropit është veçanërisht i rëndësishëm. Brenda tij do të dalin në pah sistemet e shënimeve dhe figurat retoriko-ritmike që kanë mbetur të pandryshuara me kalimin e kohës, ashtu siç do të jenë të dukshme disa ndërlikime strukturore dhe semantike, të cilat janë të dukshme sidomos në kalimin nga periudha romantike në atë të vonë romantike falë zhanrit të poemës simfonike.

Duke ndjekur këndvështrimin e adoptuar, më në fund do të bëhet e mundur të mbivendosen përfundime tekniko-stilistike mbi çështjet filozofike, duke ofruar një pikënisje për mësimin e një lënde që shpesh është tepër teorike, siç është estetika e muzikës.

Fjalë kyçe

retorikë muzikore; teoria e tropit muzikor; muzikë me program; estetikë muzikore

Flauti në formacionet e muzikës së dhomës dhe tendencat bashkëkohore në këtë gjini

Rozana Kuka

rozanakuka@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Instrumentistët solistë në instrumentet e drurit ishin të paktë deri në hapjen e Konservatorit Shtetëror të Tiranës, viti 1962, prandaj krijimtaria shqiptare e muzikës së dhomës për këto instrumente ishte e kufizuar. Më pas, kërkesa për vepra kombëtare të kësaj gjinie erdhi në rritje.

Ky punim ka si qëllim që përmes analizës së konceptit mbi tipologjinë dhe karakteristikat e krijimtarisë shqiptare, ku flauti përfshihet në ansamble të ndryshme, të evidentojë zhvillimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore për prezantimin e ideve. Krahasimi i dy veprave të poshtëshënuara i shërben këtij qëllimi. Në “Kuartetin” për instrumente druri (Fl., Ob., Kl., Fg.), i pari i këtij lloji, shkruar në 1985 nga Aleksandër Vezuli, vërejmë një përpjekje serioze drejt këtij zhvillimi, krijuar në formë ciklike, në frymën neoklasike, me program të qartë dhe me harmoni tonale (karakteristikë e kohës). Pas vitit 1990, me futjen dhe eksperimentimin e elementeve të rinj kompozicionalë, vëmë re një interes të shtuar të kompozitorëve lidhur me krijimet në muzikë dhomë me qasjet e reja, si rrjedhojë edhe për ansamble të ndryshme ku përfshihej dhe flauti.

Vepra “Vetëm” për soprano, flaut, cello, piano e shirit magnetik, kompozuar nga Nestor Kraja në 2003, prezanton një ide ekzistenciale mbi përvojat strukturaliste të muzikës së kohës. Vepra paraqitet e një stili atonal, me tipare të qarta strukturaliste e ndërthurur me muzikën elektronike (arsyeja e përzgjedhjes). Metodologjia e përdorur është e lidhur ngushtë me natyrën e punimit: metoda e analizës së burimeve teorike nga autorë të ndryshëm, metoda kërkimore-shkencore, analiza historiko krahasuese e materialeve referuese, duke synuar prezantimin e tendencave bashkëkohore në krijimtarinë shqiptare të muzikës së dhomës.

Si përfundim, vetë timbrika, potencia dhe karakteri i instrumentit të flautit, jep hapësirë e mundësi për krijime të zhanreve të ndryshme, duke përfshirë dhe teknikat e reja të lëvruara pas viteve 1990.

Fjalë kyçe

kuartet, neoklasike, atonale, analizë

Kitara në Muzikën shqiptare (Shekulli XX)

Flavio Lito

flaviolito15@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim analizon zhvillimin dhe rolin e kitarës në muzikën shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, duke u përqendruar veçanërisht në përfshirjen e kitarës në muzikën klasike dhe ndikimin e saj nga folklori muzikor në trevat shqiptare. Problemi i hulumtimit qëndron në mungesën e studimeve të organizuara mbi integrimin e kitarës në muzikën shqiptare dhe rolin e saj në formimin e një identiteti muzikor bashkëkohor.

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë mënyrën se si kitara është bërë një pjesë e pandashme e edukimit muzikor dhe interpretimit profesional, si dhe të vlerësojë ndikimin e saj në zhvillimin e repertorit shqiptar përmes përparimit të teknikave specifike për këtë instrument. Pyetjet kryesore të këtij studimi përqendrohen në rolin e kitaristëve dhe kompozitorëve shqiptarë në zhvillimin e repertorit për kitarë, ndikimin e institucioneve arsimore në formimin dhe promovimin e këtij instrumenti, si dhe në masën në të cilën kitara ka kontribuar në zgjerimin dhe pasurimin e muzikës shqiptare.

Metodologjia është e bazuar në një qasje cilësore, duke përfshirë intervista me interpretues dhe pedagogë profesionistë, si dhe analizë historike dhe muzikore. Rezultatet tregojnë se kitara ka fituar një rol të rëndësishëm në muzikën shqiptare, falë veprave që ndërthurin elementë të muzikës klasike dhe moderne me motive nga trashëgimia folklorike. Një nga përfundimet më të rëndësishme të studimit është se një pjesë e konsiderueshme e kompozimeve për kitarë të shkruara nga kompozitorët shqiptarë janë të bazuara mbi baza të folklorit muzikor shqiptar, duke kontribuar në pasurimin e identitetit kulturor.

Në përfundim, theksohet roli gjithnjë e më i rëndësishëm i kitarës në muzikën shqiptare dhe potenciali i saj për zhvillim të mëtejshëm si në muzikën klasike dhe bashkëkohore.

Fjalë kyçe

kitara në trevat Shqiptare, edukimi muzikor në shekullin XX, folklori muzikor, interpretimi muziko

Roli i klarinetës në muzikën bashkëkohore shqiptare

Prof. Mr. Fatbardh Gashi

fatbardh.gashi@unhz.eu

Universiteti “Haxhi Zeka”, Fakulteti i Arteve, Kosovë

Abstrakt

Ky punim trajton zhvillimin e repertorit bashkëkohor shqiptar për klarinetë, duke u ndalur tek ndikimet kulturore, stilistike dhe teknike që e kanë formësuar atë. Përmes një vështrimi në veprat e kompozitorëve shqiptarë të shekullit XX dhe XXI, zbulojmë sesi ky instrument ka marrë jetë në kontekstin shqiptar, nga tingujt e muzikës tradicionale deri te eksperimentimi me teknika të reja interpretative dhe roli i tij në formatet bashkëkohore të muzikës së dhomës dhe orkestrale.

Qëllimi është të kuptojmë rëndësinë e këtyre veprave muzikore në pasurimin e repertorit për klarinetë dhe ndikimin e tyre në formësimin e identitetit muzikor shqiptar brenda muzikës bashkëkohore. Duke shqyrtuar partiturat dhe analizuar interpretimet e ndryshme të veprave bashkëkohore për klarinetë, ky punim sjell një pasqyrë të thelluar mbi mënyrat se si klarineta është zhvilluar në krijimtarinë shqiptare. Gjetjet nga analiza e veprave tregojnë se klarineta ka fituar një rol të qenësishëm në muzikën bashkëkohore shqiptare, duke kaluar nga përdorimi tradicional në një mjet shprehjeje të përparuar dhe shumëdimensional. Në një nga kompozimet, për shembull, përdorimi i slap tonguing dhe multifonikave e shtyn instrumentin përtej përdorimit tradicional, ndërsa strukturat asimetrike ritmike e mbajnë dëgjuesin në një tension të vazhdueshëm emocional. Këto qasje reflektojnë jo vetëm mjeshtërinë e tyre teknike, por edhe vizionin artistik për të ribërë dhe zgjeruar kufijtë e muzikës klasike. Veprat e shqyrtuara tregojnë një bashkim të pasur të elementeve kombëtare, ndikimeve klasike dhe xhazit, duke theksuar fleksibilitetin teknik të klarinetës.

Si përfundim, ky punim thekson rolin e klarinetës në formimin e identitetit muzikor shqiptar, duke theksuar kontributin e saj në evolucionin e traditave lokale dhe integrimin e saj në kontekstin më të gjerë të muzikës bashkëkohore.

Fjalë kyçe

instrument frymor, muzikë bashkëkohore shqiptare, kompozitorë shqiptarë, teknika interpretative, evolucioni i repertorit

Fillet e muzikës pianistike në Kosovë

Syzana Jakupi

suzana.jakupi@unhz.eu

Universiteti “Haxhi Zeka”, Fakulteti i Arteve, Kosovë

Abstrakt

Duke qenë se muzika pianistike kosovare është kryesisht e re, është i njohur fakti se materialet e shkruara rreth saj janë të mangëta. Pikërisht kjo është nxitëse për një trajtim të gjerë që përfshin kompozitorët kryesorë, veprat e tyre, interpretuesit, koncertet e festivalet, arsimin muzikor pianistik e deri tek faktorët e ndikimit politike e kulturore që i kanë kushtëzuar ato zhvillime.

Qëllimi i këtij punimi përfshin identifikimin dhe gjurmimin e zhvillimit të muzikës pianistike në Kosovë, faktorët që kanë ndikuar, sfidat gjatë procesit zhvillimor të saj, por edhe identifikimin e elementeve që çojnë drejt një ngritjeje cilësore të krijimeve të veprave pianistike apo edhe si interpretime.

Metodologjia e këtij studimi përfshin intervista me muzikantë, kontakte me institucionet muzikore, grumbullimin dhe analizimin e incizimeve, posterave dhe programeve koncertale, me qëllim të krijimit të një pasqyre sa më të plotë të zhvillimit të muzikës pianistike në Kosovë. Cilët kanë qenë pianistët pionierë në Kosovë? Si u zhvillua muzika pianistike në Kosovë? Cilët janë faktorët që ndikuan në zhvillimin e muzikës pianistike? Si ka evoluar ajo dhe a mund të flitet për elementet krahasues zhvillimor me vendet e rajonit apo edhe më gjerë?

Këto janë disa pyetje të cilave ky punim ju është përgjigjur me qëllim të ofrimit të një pasqyre më të detajuar të zhvillimit të muzikës pianistike kosovare, duke evidentuar krijues dhe interpretues të veprave pianistike.

Fjalë kyçe

muzika pianistike kosovare, pianistët pionierë kosovarë, piano, performancë artistike, institucionet muzikore

Promovimi i krijimtarisë së kompozitoreve gra në botë përmes festivaleve muzikore dhe recitaleve: Një përvojë e vlefshme për skenën muzikore shqiptare

Entela Demi

entelademi_27@hotmail.com

Kolegji AAB, Fakulteti i Arteve, Prishtinë, Kosovë

Abstrakt

Festivalet muzikore dhe recitalet solistike në kuadër të tyre kanë shërbyer si platforma kyçe për promovimin e krijimtarisë së kompozitoreve gra, së bashku me iniciativa të tjera si aktivitetet e shoqatave artistike dhe botimet periodike. Historikisht, kjo krijimtari është përballur me pamundësitë e njohjes, promovimit dhe interpretimit.

Qëllimi i kësaj kumtese është të analizojë ndikimin e festivaleve ndërkombëtare dhe recitaleve solistike që promovojnë krijimtarinë e kompozitoreve gra, duke i vlerësuar si modele të vlefshme për skenën muzikore shqiptare, ku promovimi i krijimtarisë së grave kompozitore pothuajse mungon. Pyetja kryesore hulumtuese është: Si ndikojnë këto festivale dhe recitale solistike në promovimin e krijimtarisë së kompozitoreve gra dhe cilat strategji mund të ndihmojnë në përmirësimin e përfaqësimit të tyre? Hipoteza e këtij punimi është se këto festivale ofrojnë mundësi reale për promovimin, interpretimin, publikimin dhe analizën e krijimtarisë së kompozitoreve gra, duke tejkaluar kufijtë e vendeve ku ato organizohen. Duke përdorur metodologjinë krahasuese dhe analitike, mbështetur në analizën e programeve koncertale, recitaleve, intervistave dhe të dhënave të hapura, studimi synon të propozojë rekomandime për krijimin e platformave të ngjashme në Shqipëri dhe Kosovë. Rezultatet tregojnë se festivalet ndërkombëtare nuk janë më vetëm platforma promovuese por janë shndërruar në institucione muzikore me ndikim në politikat kulturore dhe edukative.

Përfundimet theksojnë se integrimi i krijimtarisë së kompozitoreve gra në festivalet ekzistuese dhe mbështetja institucionale për krijimin e platformave të reja të ngjashme dhe hapësirave të dedikuara, do të kontribuojë në rritjen e përfaqësimit dhe njohjen e tyre si kontribuese të rëndësishme të artit muzikor.

Fjalë kyçe

muzika solistike, përfaqësimi gjinor, vepra muzikore, feminizmi dhe arti muzikor

Muzika shqiptare e dhomës në vitet 1910 – 1940

Ajet Çekici

a_cekici@hotmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim ka për objekt të tij zhvillimet e muzikës së dhomës në Shqipëri, duke synuar pikërisht të hulumtojë proceset e para të lëvrimin të kësaj muzike në vendin tonë. Pjesë e krijimtarisë muzikore të kohës, muzika e dhomës e viteve 1910-1940, ruan në thelb një karakter para-profesionist. Në kontekstin historik dhe artistik, ajo frymëzohet nga lëvizja artistike dhe kulturore e Rilindjes Kombëtare, ndërsa orientimi i saj kompozicional buron nga tradita klasiko-romantike evropiane.

Në ndjekjen e procesit sipas metodologjisë historiko-analitike, trajtohen autorët përfaqësues me veprat përkatëse. I pari prej tyre, Lec Kurti, ka meritën që gjatë viteve 1913-1916 lëvroi për herë të parë gjini të tilla të llojit si sonata, trio dhe kuarteti. Pas tij, M. Gjoka shkroi pjesë të vogla për formacione të përziera instrumentale, kryesisht të tipit të miniatyrës instrumentale, ndërsa Fan Noli më 1937 është autor i një sonate për violinë dhe piano.

Nga analiza e kësaj krijimtari, rezulton se: 1) muzika e dhomës zë një vend të kufizuar në krijimtarinë muzikore të kohës, përcaktuar nga niveli profesional i autorëve, impakti i ulët në publik, si edhe nga mungesa e instrumentistëve të kualifikuar; 2) përfaqja me gjinitë përcaktohet kryesisht nga përbërja instrumentale dhe jo nga kërkesat standarde formale dhe dramaturgjike të tyre; 3) në dallim nga orientimi i përgjithshëm i muzikës shqiptare të kohës drejt formimit si muzikë kombëtare, veprat e muzikës së dhomës nuk i përmbahen kësaj linje, por mbeten ngushtësisht të ndërruara prej modeleve të traditës evropiane të shek. XVIII-XIX. Këto veçori, si edhe mjeshtëria ende e pamjaftueshme profesionale, e përcaktojnë këtë krijimtari si të stadit para-profesionist.

Fjalë kyçe

sonatë, trio, kuartet, muzikantë shqiptarë

Veprat muzikore për orkestër të At Fan S. Nolit, si pikë takimi me Nolin poet, klerik, studiues e shtetar

Ardita Bufaj

arditabufaj@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

At Fan S. Noli (1882–1965) është një nga figurat më të shquara të kulturës shqiptare, i cili përfaqëson një ndërthurje të rrallë mes artit, fesë, dijes dhe politikës. Ky studim fokusohet në katër veprat e tij muzikore për orkestër: Poema Simfonike “Scanderbeg”, “Uvertura Bizantine”, Këngë për Tenor dhe Orkestër “Gaspari i Gjorë” dhe “Rapsodia Shqiptare”, duke i trajtuar si refleksim të identitetit të tij kompleks.

Hulumtimi synon të analizojë mënyrën se si muzika e tij përfaqëson lidhjen mes Nolit si poet, klerik, studiues dhe shtetar, duke ndërtuar një narrativë muzikore që përçon vizionin e tij intelektual dhe kombëtar. Studimi do të zhvillohet përmes analizës muzikologjike të partiturave, shqyrtimit të dokumenteve arkivore dhe interpretimit të titujve dhe tematikave të veprave në kontekste të ndryshme historike e kulturore. Poema Simfonike “Scanderbeg” reflekton vizionin e Nolit për heroin kombëtar si figurë frymëzuese, “Uvertura Bizantine” pasqyron lidhjet e tij me traditën liturgjike dhe ortodokse, “Gaspari i Gjorë” ndërthur tragjedinë njerëzore me muzikën dramatike, ndërsa “Rapsodia Shqiptare” sintetizon folklorin dhe aspiratat kombëtare në një gjuhë muzikore të pasur. Metoda e kërkimit mbështetet në qasjen historiko-analitike, duke kombinuar studimin e burimeve të shkruara me analizën estetike dhe stilistike të muzikës së Nolit. Rezultatet hedhin dritë mbi ndikimet kulturore dhe ideologjike në krijimtarinë e tij muzikore, duke konfirmuar rolin e tij si një figurë unike në historinë e muzikës shqiptare.

Përfundimet e studimit nxjerrin në pah mënyrën se si muzika e tij, përveçse një shprehje artistike, është një mjet për të kuptuar më thellë Nolin si poet, klerik, studiues dhe shtetar.

Fjalë kyçe

Noli, muzikë orkestrale, identitet artistik, dokumente arkivore, analizë muzikologjike

“Copëza” të muzikës bizantine në muzikën profesioniste shqiptare

Prof. Asoc. Dr. Holta Sina Kilica

sinaholta@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i këtij punimi është një aspekt pothuajse i paprekur në muzikologjinë shqiptare që lidhet me ‘interferimet’ e muzikës bizantine në muzikën profesioniste shqiptare. Pikërisht ky punim ka për qëllim të evidentojnë se si ka ‘depërtuar’ kjo muzikë e liturgjisë së krishterë në muzikën profesioniste shqiptare, para dhe pas viteve ’90 të shek. XX. Megjithatë jo të shumta në numër, ka krijime të muzikës profesioniste shqiptare të cilat janë ndikuar nga muzika apo modet e muzikës bizantine.

Për këtë qëllim, punimi ynë nis fillimisht me Nolin, që përveç personalitetit të tij shumëdimensional, ai edhe si kompozitor ka dhënë një kontribut të çmuar jo vetëm për kishën ortodokse me përshtatjet për koralet kishtarë, por ka krijuar edhe vepra të tjera muzikore, siç janë ato orkestrale ku temat, modet dhe vetë fryma e muzikës bizantine janë prezente. Përmes metodologjisë së hulumtimit dhe analizimit, do vijohet më tej me të tjerë emra si K. Trako, i cili përpunoi dhe krijoi për liturgjinë bizantine, H. Zacharian me aranzhime, përshtatje, por edhe citime të kësaj muzike në krijimtarinë e tij, ashtu si dhe Th. Gaqi me disa aranzhime për kishën, por dhe me krijime simfonike, ku vërehen herë-herë tingëllime të mbështetura në materiale burimore me tërthorin e dytë bizantin, të cilat dëshmojnë për një rrugë të ‘tërthortë’ që lidh në këtë mënyrë muzikën popullore me atë bizantine dhe, të dyja së bashku, ‘frymojnë’ veçanërisht te Rapsodia e tij nr. 1 për orkestër simfonike.

Do të arrihet kështu në konkluzionin sesi disa prej kompozitorëve tanë, i janë qasur kësaj muzike të liturgjisë së shenjtë dhe si ka interferuar ajo në krijimtarinë e tyre, duke dëshmuar kështu pikëtakimet mes kulturave muzikore të lashta e të vona.

Fjalë kyçe

muzika bizantine, muzika popullore, muzika profesioniste, tërthori i dytë bizantin, citim

Roli i orkestrave frymore në zhvillimin e muzikës së kultivuar në Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi

saracisokol@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është shqyrtimi i orkestrave frymore në Shqipëri, si institucionet e para që mundësuan mësimin e instrumenteve muzikore në vend. Instrumentet e tunxhit dhe ato të frymës filluan të përdoren në fund të shekullit të XIX, në një kohë kur ndikimet kulturore, veçanërisht nga Italia, kishin një rol të rëndësishëm në zhvillimet kulturore, ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë.

Pyetja kërkimore në këtë punim do të jetë: Çfarë ndihmese sollën orkestrat frymore në zhvillimin dhe pasurimin e muzikës së kultivuar në Shqipëri ?

Metodologjia e këtij punimi përfshin kombinimin e disa metodave, si atë historike, kulturore, sociologjike, në prizmin e rolit të orkestrave frymore.

Rezultatet e punimit nënvizojnë rolin kyç të këtyre formacioneve muzikore në përparimin e muzikës së kultivuar në Shqipëri. Afërsimi me praktikatat e avancuara të leximit dhe shkrimit muzikor dhe krijimi i orkestrave frymore në çdo qytet apo institucion arsimor.

Diskutimet dhe përfundimet e këtij punimi theksojnë ndikimin pozitiv të formacioneve muzikore te të rinjtë shqiptarë, duke i bashkuar ata mes tyre dhe me bashkëmoshatarë nga e gjithë bota. Muzika shërben si një gjuhë universale që lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor. Në këtë mënyrë, mësimi i një instrumenti muzikor shndërrohet jo vetëm në një proces arsimor, por edhe në një mënyrë për të folur gjuhën sublime të muzikës, e cila mbetet një nga format më të fuqishme të shprehjes njerëzore.

Fjalë kyçe

histori e bandave muzikore, formacione muzikore, bashkëpunim ndërkulturor

Lindja e muzikës profesioniste në Shqipëri dhe lidhja e saj me lëvizjen e bandave muzikore në qytetin e Shkodrës

Fatma Spahiu

namartalbania@hotmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Lëvizja e bandave muzikore në qytetin e Shkodrës ishte padyshim një ndër nismat pioniere të ngjarjeve artistike, e cila shënoi fillimet e muzikës profesioniste shqiptare. Ajo lindi mes dukurish gjeopolitike të përmasave epokale në fundin e shekullit XIX.

Në këtë kumtesë do të shqyrtojmë pikërisht rolin e kësaj lëvizjeje, pra të themelimit të bandave frymore, si fillimet e muzikës profesioniste shqiptare. Nga njëra anë, fenomeni do të analizohet në këndvështrim social-kulturor, duke e vënë në raport edhe me zhvillimet paralele në arte të tjera si letërsia, publicistika, piktura e fotografia, nga ana tjetër, krahas linjës kryesore të zhvillimit që fillon me kompozitorin arbëresh At Marcozzi dhe muzikantët Giovanni Canale e Palokë Kurti, trajtimi do të ndalet edhe në figura të tjera, kontributet e të cilëve për një arsye apo një tjetër, kanë mbetur më pak të njohura e të trajtuara në literaturën përkatëse. Në këtë kuptim vihen në pah kontributet e patriotëve si Hilë Mosi e Ragip Gjylbegu, si dhe e muzikantëve drejtues si Sulë Liçaj e Pavlo Zhvap.

Ndër gjetjet e punimit është fakti se zhvillimi i bandave frymore në Shkodër ishte mjaft intensiv dhe pati bazë të gjerë e angazhim të admirueshëm të shumë shtresave sociale, gjë që i detyrohet jo pak, vetë momentit historik. Argumentohet se kemi të bëjmë me një lëvizje vërtet të mrekullueshme, pasi për të hasur një realitet të ngjashëm me të duhet të shkojmë, ndoshta, deri në Zagreb apo Selanik.

Përfundojmë se lëvizja bandistike në Shkodër ka një rëndësi themelore për zhvillimet e mëvonshme të muzikës profesioniste shqiptare.

Fjalë kyçe

bandë frymore, muzikë profesioniste, Shkodër

“Vallja me dajre” e Th. Gaqit – mes muzikës dhe simbolikës

Arjan Brahimi

brahimiarjan@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i këtij punimi ka në fokus konceptin muzikor dhe atë simbolik të Valles Simfonike nr. 2 të kompozitorit Th. Gaqi. Padyshim që historia e muzikës shqiptare dëshmon për një sërë veprash cilësore në zhanrin simfonik të të gjitha gjinive por, kjo valle simfonike e shumë interpretuar, është sot një ‘pasaportë’ e vërtetë artistike, pasi së fundmi është interpretuar me sukses të plotë në një prej sallave më të famshme në botë, në Carnegie Hall në New York. Për ndërtimin e saj janë shfrytëzuar të gjithë elementet karakteristike muzikore të Valles së Tiranës (seksionet), duke ruajtur në këtë mënyrë origjinalitetin e kësaj valleje kaq të veçantë e interesante.

Kjo valle është më tepër e njohur si “Vallja me dajre”, sepse elementi kryesor që i jep tonin veprës është ai i “dajres”, me figurën karakteristike ritmike të ekspozuar që në hyrje të saj, e cila shoqëron gjithë veprën në fjalë. Por, duke e parë veprën në një vështrim më të kujdesshëm formal e analitik, si dhe duke abstraguat edhe me një figuracion gjeometrik të përfytyruar, rezulton se struktura muzikore e saj do të lidhej përsëri me një element popullor (kësaj here etnografik), i cili gjendet në qilimat e punuar me dorë të traditës sonë – figura e rombit të shkallëzuar ose ‘bakllavasë’. Pikërisht kjo simbolikë përkon edhe me formën muzikore të veprës, e cila përmes seksioneve vjen me skemën: a b c d c b a, që janë edhe ‘shkallët’ e rombit drejt kulminacionit d (në pjesën e mesit) dhe zbritjes në krahun tjetër të tij, në reprizë refleksive.

Në përfundim, do të theksohet fakti se ky bashkim traditash muzikore dhe etnografike në koncept e strukturë, ka sjellë një vepër mjaft të realizuar artistikisht, që ka tejkaluar kohën dhe vijon të interpretohet edhe sot, jo vetëm në skenat shqiptare, por edhe ato ndërkombëtare.

Fjalë kyçe

valle, dajre, rombi, muzikë, simbolikë

“Sonatë për violinë e piano” e Çesk Zadesë - Këndvështrimi analitik dhe kritik i koncepteve të reja muzikore ndërthurur me folklorin shqiptar

Lorenc Treska

treskalorenc@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i këtij punimi fokusohet në konceptet e reja muzikore, ndërthurur me elemente të folklorit shqiptar në “Sonatën për violinë e piano” të Çesk Zadesë, e cila është një nga veprat më cilësore të opusit krijues në zhanrin e muzikës së dhomës. Vepra u krijua mes viteve 1972-1974 dhe u interpretua për herë të parë nga violinisti Pandush Gjezi, në shoqërimin e pianistes Anita Tartari, në koncertet e Dekadës së Majit të vitit 1974. Sonata, jo vetëm u vlerësua si vepra më e mirë e vitit, mes veprave instrumentale të muzikës profesioniste shqiptare, por ngjalli edhe një interes të veçantë për cilësitë e reja gjuhësore e strukturore që solli në muzikën tonë instrumentale.

Ky punim ka për qëllim të nxjerrë në pah risitë që solli përmes gjuhës së saj muzikore dhe mjeshtërisë të teknikave kompozicionale. Kjo vepër përfaqëson, jo vetëm një arritje në krijimtarinë e kompozitorit, por ajo është edhe një arritje e rëndësishme e muzikës së dhomës dhe, në veçanti, të gjithë muzikës shqiptare të kësaj periudhe. Tingëllimi i përgjithshëm i sonatës lajmëron për një zhvillim të ri e bashkëkohor në muzikën shqiptare instrumentale të dhomës e më gjerë. Ndërsa, në këndvështrimin analitik sonata, me formën dhe përmbajtjen e re të saj, tregoi për një rrugë të re në krijimtarinë muzikore instrumentale por, njëkohësisht me tingëllim shqip.

Dalim në përfundimin se Zadeja, në këtë vepër, më shumë se kudo tjetër, arrin të ndërlidhë me shumë profesionalizëm pasurinë e etnosit muzikor shqiptar me thurjen kompozicionale tepër të veçantë për kohën (me bitonalitete, bifunksionalitete, pentatoni, mode etj.), duke shpërfaqur njëkohësisht aspekte të reja estetike në vepër.

Fjalë kyçe

sonatë, violinë, piano, folklor

Veprat e para shqiptare për piano e orkestër dhe vendi i tyre në fondin e muzikës shqiptare

Klejda Tare

klejdatare@yahoo.it

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Muzika profesioniste shqiptare, gjatë ekzistencës së saj relativisht të shkurtër, ka njohur zhvillime të rëndësishme. Këto nisën që prej fundit të shekullit XIX, por periudha që përcaktoi përfundimisht zhvillimin e kësaj muzike është ajo e gjysmës së dytë të shekullit XX. Ky artikull fokusohet tek veprat e para shqiptare për piano e orkestër që nisën rrugëtimin në vitet 1959 – 1969 dhe i jep përgjigje pyetjes se cilët kanë qenë faktorët kryesorë që përcaktuan lindjen dhe zhvillimin e kësaj gjinie dhe themelimin e shkollës së pianos.

Metodologjia është mbështetur në punën me arkivin si dhe në aspekte historike e analitike të veprave konkrete. Ka një sërë faktorësh të zhvillimit të muzikës koncertale pianistike shqiptare, ndër më kryesorët veçojmë faktorin profesional e artistik, të përcaktuar nga fakti i formimit të muzikantëve profesionistë të të gjitha niveleve përmes ngritjes së sistemit të plotë të edukimit muzikor në vend, që është produkt i gjysmës së dytë të shekullit XX. Që nga viti 1959 e në vazhdim, numërohen disa vepra pianistike koncertale, gjithsecila prej tyre dëshmi e kohës në të cilën u krijua, por duhet theksuar se niveli i forcave krijuese dhe kërkesat artistike u rritën drejt një jete koncertale aktive, sidomos me ardhjen nga ish-Bashkimi Sovjetik i disa kompozitorëve (Zadeja, Daija etj.).

Rezultatet e punimit përqëndrohen në disa pika të rëndësishme, së pari në të rejtat që sjellin në koncept e strukturë veprat e para për piano dhe orkestër, referuar edhe teknikave kompozicionale të përdorura për krijimin e tyre si dhe arrihet në përfundimin e peshës historike që mbajnë këto vepra në artin muzikor shqiptar dhe vlerat kompozicionale të tyre të patjetërsueshme.

Fjalë kyçe

kompozitorë, krijimtaria shqiptare, muzika koncertale pianistike

Muzika shqiptare në piano në fundin e shekullit XX – fillimin e shekullit XXI dhe roli i saj në formimin e shkollës kombëtare pianistike shqiptare

Fjorda Veizaj

fjorda.veizaj@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim ka si qëllim të analizojë në disa dimensione zhvillimin e krijimtarisë muzikore pianistike në Shqipëri nga fundi i shekullit XX deri në fillim të shekullit XXI. Periudha e përmendur karakterizohet nga ndryshime politike, shoqërore dhe kulturore, që ndikuan drejtpërdrejt në jetën artistike të vendit. Ndryshimi i sistemit solli hapje ndaj influencimeve perëndimore dhe një lirshmëri më të madhe në shprehjen muzikore, çka ndikoi dukshëm edhe krijimtarinë për piano, ndaj repertori pianistik kombëtar i pas viteve '90 përbën një burim të çmuar për edukimin didaktik të brezave të rinj të pianistëve dhe për pasurimin e jetës koncertale në Shqipëri.

Objekt i analizës është repertori pianistik kombëtar i krijuar pas viteve '90, me fokus në tiparet stilistike, strukturale dhe ekspresive të kësaj krijimtarije. Qasja metodologjike mbështetet në analizën muzikore të partiturave, shqyrtimin krahasues të praktikave interpretative dhe vlerësimin e kontekstit historiko-kulturor në të cilin janë krijuar veprat muzikore.

Krijimtaria pianistike në Shqipërinë e pas '90-ës tregon kapacitetin e muzikës shqiptare për t'u zhvilluar duke ruajtur lidhjen me traditën dhe njëkohësisht duke reflektuar sfidat dhe kërkesat e kohës moderne përmes ndikimit perëndimor.

Punimi vë në pah se muzika për piano ka prirje drejt individualizimit estetik, eksperimentimit timbral dhe integritetit të elementeve të muzikës tradicionale shqiptare në forma të reja bashkëkohore. Zhvillimet e vërejtura reflektojnë transformimin e shijeve muzikore e sidomos përpjekje të vazhdueshme për të avancuar në artin muzikor, që kanë çuar në një identitet artistik të ri të jetës kulturore në vend si rrjedhojë e realitetit të ndryshuar shoqëror.

Fjalë kyçe

krijimtaria muzikore bashkëkohore, ndryshimet shoqërore, influencat perëndimore, tradita shqiptare, identitet artistik

Teknika Pianistike dhe Muzika shqiptare e viteve 50' – 60'

Laura Lila

laura_lila09@hotmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Megjithë sprovat sporadike në gjysmën e parë të shek. XX, muzika pianistike shqiptare u zhvillua pas Luftës II Botërore. Kjo kumtesë do të hulumtojë evolucionin e teknikës pianistike në fazën e parë të këtij zhvillimi, siç paraqitet ajo nga veprat e para pianistike deri tek veprat koncertale të viteve 1950–1960.

Në bazë të hulumtimit do të jetë metoda analitike, historiografike dhe krahasuese, duke u mbështetur në përvojën e studimeve analoge të literaturës botërore. Në qendër të analizës do të jenë sidomos koncertet për piano të Çesk Zadesë dhe Tonin Harapit, fillimisht duke bërë krahasimin midis teknikave të përdorura në veprat e tyre koncertale dhe përvojës botërore të gjinisë. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sidomos ndikimit të kompozitorëve romantikë, e më konkretisht lidhjeve të ngushta midis teknikës pianistike romantike të shek. XIX dhe përdorimit të saj në veprat muzikore shqiptare të viteve 1950-të dhe 1960-të. Duke analizuar teknikat e përdorura në këto vepra, kjo kumtesë argumenton se kompozitorët shqiptarë të viteve 1950-1960, trashëguan dhe përshtatën në mënyrë krijuese elemente thelbësore të teknikës pianistike romantike, të ndërmjetësuar edhe nga përvoja ruse të cilën autorët e përthithën gjatë shkollimit të tyre në ish-Bashkimin Sovjetik.

Përfundojmë se ndërthurja e kësaj eksperience me mbështetjen në folklorin e pasur muzikor shqiptar, përcaktoi tiparin themelor të pianizmit shqiptar, të paktën në këtë fazë të parë, duke krijuar një muzikë sa individuale aq dhe kombëtare.

Fjalë kyçe

teknika pianistike, romantizmi, muzika pianistike shqiptare, folklor

Nga protesta te patriotizmi: Roli i muzikës rrok dhe këngës patriotike në ndërtimin e identitetit kombëtar shqiptar

Armend Xhoni

xhoni51@hotmail.com

Kolegji AAB, Prishtinë

Abstrakt

Muzika ka luajtur një rol vendimtar në formësimin e identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë, duke pasqyruar transformimet historike dhe kulturore të vendit. Ky studim, fokusohet në dy zhanre kryesore si: muzikën rrok, që simbolizon protestën, rezistencën dhe këngët patriotike, të cilat mishërojnë kujtesën kolektive dhe krenarinë kombëtare. Edhe pse të dallueshme në stil, të dyja kanë kontribuar në ndërtimin e një identiteti të unifikuar. Ky hulumtim, përmes analizës tekstuale dhe melodike, eksploron ndërveprimin e tyre, në kuptimin e asaj se si këto dy zhanre funksionojnë si forca kundërshtare apo si elemente plotësuese të së njëjtës narrative.

Studimi përfshin vitet 80', 90' dhe mijëvjeçarin e ri. Muzika rrok, si një zhanër proteste, kanalizoi zhgënjimin dhe kundërshtimin ndaj shtypjes, duke mobilizuar audiencën për ndryshim. Ndërkohë, këngët patriotike përforcuan kujtesën historike dhe bashkimin kombëtar, duke nxitur një ndërgjegje kolektive. Në këtë studim, analizat krahasuese dhe stilistike nxjerrin në pah rolin e tyre si mjete artistike dhe socio-politike në rezistencën dhe ndërtimin e kombit. Në përfundim, studimi tregon se, pavarësisht dallimeve stilistike, muzika rrok dhe këngët patriotike kanë ndarë një mision të përbashkët: formësimin e identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë. "Rroku", veçanërisht "folk rroku", nuk ishte thjesht një zhanër proteste, por gjithashtu përfshiu elemente muzikore etnike, njësoj si këngët patriotike. Shumë kompozime "rrok" huazuan melodi, shkallë dhe motive nga traditat popullore, me anë të së cilave, përforcuan rezonancën e tyre kulturore.

Kjo shkrirje mundësoi që "rroku" të shërbejë si një mjet për shprehjen kombëtare, duke pasqyruar traditën e këngës patriotike. Ndërlidhja e tyre pasqyron realitetet historike, duke demonstruar funksionin e tyre si mobilizues kulturor dhe social. Për më tepër, këto zhanre vazhdojnë të evoluojnë, të ruajnë rolin e tyre në peizazhin dinamik sociopolitik të Kosovës. Ky evolucion nxjerr në pah rëndësinë e qëndrueshme të të dy zhanreve në formësimin e identitetit kombëtar.

Fjalë kyçe

identiteti kombëtar, muzika rrok, kënga patriotike, rezistenca, protesta

Ndikimi i muzikës jazz në muzikën e lehtë shqiptare gjatë periudhës socialiste (1945 - 1973)

Andi Kongo

kongoandi@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Muzika jazz, e cila ka origjinën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, identifikohet si muzika e vendeve të boshtit kapitalist dhe konsiderohet si “shfaqje e huaj” gjatë periudhës socialiste në Shqipëri.

Ky punim ka për qëllim të hedhë dritë mbi përpjekjet e disa kompozitorëve dhe interpretuesve, të cilët arritën me guxim të integrojnë elemente të jazz-it në muzikën e lehtë, por jo pa censurime dhe pasoja nga regjimi i atëhershëm. Në regjistrimet e para zanore të formacioneve të muzikës së lehtë shqiptare të viteve ‘50 në Radio Tirana, gjendet një numër i konsiderueshëm këngësh me elemente të muzikës jazz. Këto elemente vihen re edhe në edicionin e parë dhe të dytë të “Festivalit të Këngës” në Radio Tirana, ashtu si dhe në edicionin e pafat të njëmbëdhjetë në RTSH. Në këtë studim është pasqyruar historiku i ndikimit të kësaj muzike në periudhën që përkon nga vitet e para të pasluftës deri në vitin 1973 (vit kur u zhvillua Plenumi i IV i Komitetit Qendror të PPSH) duke iu referuar dëshmi të disa prej personazheve kyçe. Dëshmi të qëmtuara në libra (KËLLIÇI, 2002; ALIA, 2010), artikuj gazetash (BEJKO, 2017; IMAJ, 2017) dhe intervista (XHAÇKA, 2009; STAMBOLLA, 2010).

Me anë të metodave analitike mbi muzikën jazz dhe teorisë së saj (ZENNI, 2007), janë vënë në dukje elementet karakteristike jazz të aplikuara në ato këngë, si: instrumentacioni, stili, forma, interpretimi, ritmika, harmonia, shkallët dhe modet. Rëndësia e këtij punimi ka të bëjë me nxjerrjen në pah të peshës që pati muzika jazz në muzikën e lehtë shqiptare, edhe pse e censuruar dhe e ndaluar të interpretohet në mënyrë formale sipas shembujve të artistëve perëndimorë.

Fjalë kyçe

Festivali i Këngës, Radio Tirana, Festivali i Njëmbëdhjetë në RTSH, muzika xhaz në totalitarizëm, realizmi socialist

Muzika në Radio Tirana: Një trashëgimi kulturore

Santana Xheladini Myftaraj

santana.xheladini@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Radio-Tirana, krijuar për herë të parë në vitin 1938, ka mbajtur një peshë të jashtëzakonshme në zhvillimet e muzikës shqiptare. Programet muzikore, regjistrimet, formacionet si Orkestra Simfonike e RTSH, por edhe shumë ansamble të tjera, më tej festivalet, nga të cilat do të veçonim sidomos atë të këngës, janë vetëm disa nga shembujt që dëshmojnë peshën e madhe që Radio Tirana si institucion ka luajtur në zhvillimet e muzikës shqiptare. Ky kontribut është “i dallueshëm” para së gjithash te arkivat e këtij institucioni. Ekzistenca e tyre na shtyn të mendojmë për këtë institucion jo vetëm si një ent mediatik, por edhe si një institucion i trashëgimisë kulturore. Si rrjedhojë, është e nevojshme të njohim në mënyrë më të thelluar historinë dhe veçoritë e tyre.

Në këtë kumtesë do të paraqesim një pasqyrë të përgjithshme, duke nxjerrë në pah veçoritë e kësaj trashëgimie dhe sesi mund t’i qasemi për ta studiuar nga ana e antropologjisë kulturore, pra muzika si kulturë. Për shkak të vëllimit të materialit, këtu do të përqendrohemi në periudhën e gjysmës së dytë të shekullit XX që është periudha e konsolidimit të institucionit. Njëkohësisht ajo paraqitet edhe si më e pasura në nivelin sasior, por edhe e ngarkuar në nivelin politik e ideologjik nga regjimi diktatorial. Pra, çfarë trashëgojmë sot nga Radio Tirana nga pikëpamja muzikore? Si mund t’i qasemi këtyre artefakteve dhe strukturave? Cili është kontributi njerëzor në këtë trashëgimi (prania e njerëzve që kanë dhënë kontribute)? Ku gjenden sot këto dokumente/artefakte? Si mund t’i klasifikojmë? Këto çështje do të adresohen në këtë punim, si një hap i parë në drejtim të studimit sistematik të tyre.

Fjalë kyçe

arkivë, artefakt, fonotekë, regjistrim, histori, regjim diktatorial

Transformimi i procesit krijues të kantautorit përmes teknologjisë moderne muzikore

Voltan Prodani

vprodani@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim eksploron mënyrën se si teknologjia moderne muzikore ka ndikuar dhe transformuar thelbësisht procesin krijues të kantautorit bashkëkohor. Në peizazhin muzikor të ditëve të sotme, ku kompozimi, interpretimi dhe prodhimi bashkekzistojnë në mënyrë të pandashme, kantautori bashkëkohor merr përsipër role të shumëfishta—kompozitor, autor teksti, producent, orkestrues, regjistruar dhe interpretues live. Mjetet digjitale, si softuerët për kompozim dhe prodhim, pajisjet për performancë live dhe platformat e shpërndarjes online, janë bërë pjesë thelbësore e këtij procesi krijues dhe profesional, duke formësuar praktikën dhe identitetin artistik.

Në qendër të studimit është marrëdhënia dinamike midis vizionit personal artistik dhe ndërmjetësismit teknologjik. Kjo ndërveprimësi mundëson zgjerimin e mundësive shprehëse dhe ofron më shumë autonomi krijuese për artistin. Për më tepër, teknologjia muzikore ka riformësuar mënyrën e ndërveprimit me audiencën, duke mundësuar forma të reja të shpërndarjes, komunikimit dhe personalizimit të performancës. Mjetet për performancë live, përfshirë pajisjet për looping, kontrolluesit MIDI dhe efektet në kohë reale, kontribuojnë në krijimin e përvojave të veçanta dhe të përshtatura për secilën ngjarje muzikore. Integrimi i mjeteve digjitale në proceset e krijimit të këngës dhe prodhimit muzikor ka thjeshtuar rrjedhën e punës, duke u dhënë artistëve më shumë menjëhershëmi dhe ndjeshmëri në shprehje. Teknologjia, në këtë kuptim, nuk është thjesht një ndihmë funksionale, por një bashkë-krijuese aktive që ndikon në vendimet estetike dhe pasuron shprehjen artistike.

Arrijmë në përfundimin se teknologjia muzikore përbën një komponent thelbësor të praktikës së kantautorit bashkëkohor. Duke zgjeruar kapacitetet krijuese dhe duke mundësuar lidhje më të drejtpërdrejta me audiencën, ajo jo vetëm që përmirëson procesin artistik, por edhe riformulon vetë natyrën e autorësisë dhe interpretimit muzikor në epokën digjitale.

Fjalë kyçe

krijimtari muzikore, identitet artistik, performancë live, prodhim muzikor, teknologji digjitale

Arti dhe kultura e qytetit të Pejës

Prof. Dr. Hysen Nimani

hysen.nimani@unhz.eu

Universiteti “Haxhi Zeka”, Fakulteti i Arteve, Pejë, Kosovë

Abstrakt

Peja është një ndër qytetet e vjetra e me trashëgimi kulturore të spikatur në Kosovë. Ajo perceptohet si kryeqytet i Dukagjinit, dhe nga historia e saj ndër shekuj ka trashëguar tradita të pasura të artit dhe kulturës së bukur tradicionale shqiptare.

Qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë pikërisht parashtrimi i kësaj trashëgimie specifike të artit e kulturës në qytetin e Pejës. Pyetja shkencore qendrore e këtij punimi është: Si dhe sa kanë ndikuar faktorët politikë, ekonomikë dhe kulturorë, në zhvillimin e artit dhe jetës kulturore, tek shqiptarët e Kosovës dhe në veçanti në qytetin e Pejës? Shqyrtimi do të bëhet duke u mbështetur në gërshetimin e metodave historike, etnokulturore dhe krahasuese. Fillimisht do të parashtrihen sferat kryesore të trashëgimisë kulturore por edhe folklorike muzikore të zonës, duke ravigjzuar në radhë të parë profilin e përgjithshëm të secilës shtresë e repertor dhe duke i interpretuar në lidhje të ngushtë edhe me kontekstin kulturor përkatës. Më tej bëhet përpjekje për të depërtuar në specifikën e traditave të Pejës, krahasuar me atë të qyteteve e krahinave të tjera të Kosovës.

Ndër gjetjet e këtij punimi është se faktorët gjeopolitikë dhe vështirësitë e njohura historike nuk ia kanë zbehur aspak banorëve të Pejës (ashtu si edhe shqiptarëve të Kosovës në përgjithësi), dëshirën e tyre për kultivimin e kulturës dhe artit tradicional shqiptar. Përkundrazi, ajo është përcjellë si vlerë e çmuar shpirtërore dhe faktor i rëndësishëm identiteti, duke u trashëguar edhe në lidhjet familjare ndër breza. Konkludohet se trashëgimia kulturore e Pejës përbën një vlerë të shtuar në mozaikun e përgjithshëm kulturor të Kosovës, krahas asaj të qyteteve si Gjakova apo Prizreni.

Fjalë kyçe

kultura qytetare pejane, Çarshia e Pejës, Bajrakli xhamia, Kisha Shën Katerina, Patriakana e Pejës

Një studim krahasues midis muzikës polifonike “a tenore” të Sardenjës dhe muzikës iso-polifonike të Labërisë

Aulon Naçi
aulon_naci@hotmail.com
TKOBKV

Abstrakt

Në kontekstin e globalizimit dhe të tendencave për standardizim kulturor, rikthimi tek format tradicionale të shprehjes artistike dhe kulturore përbën domosdoshmëri për studiuesit e fushave humaniste. Ky studim synon të trajtojë në mënyrë krahasuese dy forma të veçanta të polifonisë vokale mesdhetare: polifoninë a tenore të Sardenjës dhe muzikën iso-polifonike të Labërisë në Shqipëri. Duke u nisur nga ngjashmëritë strukturore, interpretative dhe kompozicionale ndërmjet tyre, si dhe duke marrë në konsideratë tregues të një substrati të përbashkët kulturor dhe gjuhësor, kërkimi synon të evidentojë në mënyrë shkencore pikat e kontaktit dhe diferencimet midis këtyre dy traditave muzikore.

Prej kësaj lindin disa pyetje kërkimore: cilat janë afinitetet dhe çfarë kanë të përbashkët këto dy universe të folklorit muzikor polifonik në nivelin kompozicional dhe interpretativ? A ekziston një terren i përbashkët, i ndarë apo jo, që justifikon këtë afinitet (për momentin i supozuar vetëm si tezë studimore) në nivelin muzikor? Studimi krahasues do të ketë gjithashtu mundësinë të evidentojë origjinalitetin e secilës prej traditave, jo vetëm në raport me tjetrën, por edhe në vetvete.

Nëpërmjet shqyrtimit të teknikave kompozicionale, hipotezave mbi origjinën, përdorimit të zërit, si dhe dimensionit shoqëror dhe komunitar të muzikës dhe këngës, synohet një vlerësim i thelluar ndërdisiplinor i këtyre dy kulturave.

Përtej analizës muzikologjike, studimi propozon ndërtimin e një platforme të përbashkët bashkëpunimi për kërkime dhe krijimtari bashkëkohore, duke promovuar ndërveprimin kulturor mes dy realiteteve që, ndonëse ndahen nga distanca gjeografike, ndajnë një trashëgimi të afërt kulturore. Në kontekstin shqiptar, kjo qasje ndërlidhet me traditën e albanologjisë, duke integruar dimensione historiko-kulturore, etnolinguiste dhe folklorike në funksion të ruajtjes dhe ringjalljes së identitetit kulturor.

Fjalë kyçe

identitet, edukimi muzikor, muzikologji, polifoni, shumëzërësh

E qara me ligje në zonën e Labërisë dhe “Gjama” e veriut - tradita të lashta të kulturës shpirtërore shqiptare

Elvina Koçillari

elvina.gurra@yahoo.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Objekti i kësaj trajtese është analiza e ciklit të fundit të jetës – vdekjes – dhe shoqërimi i saj me vajtimin, si një element i rëndësishëm i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore shqiptare. Kjo trajtesë do të fokusohet në pyetjen shkencore: “Cili është roli i vajtimit në traditën shqiptare?”

Qëllimi është të ndriçohet funksioni i vajtimit jo vetëm si shprehje e dhimbjes, por edhe si formë komunikimi kolektiv dhe ruajtjeje të kujtesës për të ndjerin. Fokusi i punimit do të përqëndrohet te e qara me ligje, të cilën e gjejmë të praktikuar në zonën e jugut, kryesisht në zonën e Labërisë. Vajtimi me ligje është një traditë e lashtë shqiptare, nëpërmjet së cilës, shprehet ngushëllimi për humbjen e njeriut të dashur. Metodologjia e kësaj trajtese, do të mbështetet në gërshetimin e metodave historike, etnokulturore dhe krahasuese. Në këtë kontekst, një tjetër rit mortor tradicional që do të trajtohet është dhe “Gjama”, e cila është e pranishme në veri, një traditë e hershme sidomos në Malësinë e Madhe. Në çdo krahinë shqiptare, në rast vdekjeje, familja dhe komuniteti shprehin dhimbjen përmes të qarës dhe ‘këndimit’ ritual të vajit. Ky akt nuk ka vetëm funksion emocional, por shërben edhe për të përforcuar lidhjet sociale si dhe për të mbajtur gjallë kujtimin e të ndjerit.

Rezultatet dhe përfundimi do të vërtetojnë se vdekja, vajtimi dhe e qara janë elemente të pandara të kulturës shqiptare, të lidhura ngushtë me mënyrën se si komuniteti përjeton humbjen dhe shpreh zinë kolektive.

Fjalë kyçe

vdekja, vajtimi, e qara me ligje, traditë, cikli i jetës

Roli dhe rëndësia e lahutës, sharkisë dhe çiftelisë si instrumente kordofone në traditën dhe kulturën muzikore kombëtare shqiptare

Arbër Çerri

arbercerri@gmail.com

Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës, Tiranë, Shqipëri

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë rolin dhe rëndësinë e lahutës, sharkisë dhe çiftelisë, si instrumente tradicionale kordofone në trashëgiminë muzikore kombëtare shqiptare. Ai shqyrton rrugëtimin historik, zhvillimin dhe mënyrën e trashëgimisë së tyre deri në ditët e sotme. Pyetja shkencore e këtij punimi do të jetë: “Cila ka qenë dhe cila është sot, rëndësia e lahutës, sharkisë dhe çiftelisë si instrumente muzikore në traditën, kujtesën dhe kulturën muzikore të shqiptarëve?”

Këto instrumente kanë luajtur një rol të rëndësishëm në jetën dhe traditën etnomuzikore mbarëshqiptare, ku një aspekt shumë i rëndësishëm është edhe aspekti etik dhe aspekti moral, ku secili prej këtyre instrumentave kanë veçantitë e tyre dhe përbëjnë botëkuptimin artistik, kombëtar dhe etnik të kombit shqiptar.

Ky hulumtim bazohet në metodën e analizës dhe krahasimit. Ai fokusohet në vlerat simbolike, etike dhe estetike të këtyre instrumenteve, në traditën e ndërtimit të tyre, përdorimin në praktikën popullore dhe mënyrën e transmetimit ndër breza.

Punimi ndalet në shpërndarjen gjeografike të këtyre instrumenteve në trevat shqiptare, me theks të veçantë në zonat veriore, ku përdorimi i tyre është më i përhapur. Po ashtu analizohet ndikimi i tyre në etnopsikologjinë e komuniteteve lokale.

Pritet të evidentohen vlerat unike artistike dhe kulturore të këtyre instrumenteve, ndikimi i tyre në identitetin kombëtar shqiptar dhe përshtatshmëria e tyre në kontekstin e teknologjisë digjitale dhe ndërveprimit kulturor global. Punimi do të përmbyllet me një sintezë të origjinës, zhvillimit dhe funksionit të vazhdueshëm të këtyre instrumenteve në kohët moderne, veçanërisht në lidhje me trashëgiminë digjitale dhe teknologjinë e informacionit.

Fjalë kyçe

muzika popullore shqiptare, instrumente kordofone, aspekti etnopsikologjik, shijet estetike, identiteti kulturor

LIBRI ABSTRAKTEVE

Kryetar i Nderuar:

Prof. Dr. Erald Bakalli
Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Organizues:

Prof. Mr. Nora Halimi
Fakulteti i Arteve, Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut
Prof. Dr. Sara Brajović
Fakulteti i Arteve, Universiteti Donja Gorica, Mali i Zi
Prof. Mr. Fatbardh Gashi
Fakulteti i Arteve, Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, Kosovë
Prof. Asoc. Dr. Zeni Ballazhi
Fakulteti i Arteve, Universiteti i Prishtinës, Kosovë
Prof. Asoc. Albes Fusha
Zëvendës Dekan në Fakultetin e Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Silvana Skënderi
Zëvendës Dekan në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Dr. Elis Mataj
Zëvendës Dekan në Fakultetin e Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Janko Ljumović
Fakulteti i Arteve Dramatike, Universiteti i Malit të Zi
Prof. Asoc. Dr. Dr. Ardian Isufi
Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Dr. Holta Sina
Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Elida Rapti
Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala
Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Dr. Ervin Meniko
Fakulteti i Artit Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana
Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha
Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Armira Kapxhiu
Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Mikel Temo
Kordinatori i Shkollës Doktorale, Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Dr. Edmir Ballgjati
Kordinatori i Shkollës Doktorale, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Alert Çeloalija
Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Msc. Adela Kusuri
Sektori Ligjor, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
MA. Kein Katroshi
Supervizor i dizajnit grafik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri

Komiteti Shkencor Ndërkombëtar:

Prof. Dr. Erald Bakalli
Rektor i Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
Academik Vasil S. Tole
Akademia e Shkencave, Tiranë, Shqipëri
Prof. Arben Llozi
Dekan i Fakultetit të Muzikës, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Sadik Spahija
Dekan i Fakultetit të Arteve të Bukura, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Milto Kutali
Dekan i Fakultetit Skenik, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Arian Paço
Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dorian Çene
Zëvendës Rektor, Universitetit të Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Dr. Hazir Haziri
Dekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës, Kosovë
Prof. Ma. Hysen Nimeri
Dekan i Fakultetit të Arteve, "Haxhi Zeka" Universiteti i Pejës, Kosovë
Prof. Mr. Senad Abdul
Dekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut
Prof. Dr. Francesco Perri
Conservatorio "S. Giacomoantonio" di Cosenza, Italy
Prof. Dr. Innocenzo Cosimo De Gaudio
Conservatorio "S. Giacomoantonio" di Cosenza, Italy
Prof. Asoc. Dr. Edin Jasari
Dekan i Fakultetit të Arteve Dramatike, Universiteti i Malit të Zi, Mali i Zi
Dr. Ardian Ahmedaja
Universiteti i Muzikës dhe Arteve Skenike, Vjenë, Austri
Dr. Bledar Kondi
Universiteti Martin Luther Halle-Vitenberg, Gjermani
Dr. Ermir Nika
Universiteti Europian, Tiranë, Shqipëri
Dr. Dashamir Vagharri
Universiteti "Derby", Mbretëria e Bashkuar

Bordi Redaktues:

Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala
Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Holta Sina
Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Dr. Edmir Ballgjati
Kordinatori i Shkollës Doktorale në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Manjola Tërshana
Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Ermir Hoxha
Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
Dr. Ervin Meniko
Fakulteti Skenik, Universiteti i Arteve, Tiranë, Shqipëri
ISBN Print 9789928486004
ISBN Digital 9789928486035
ISBN E-Book 978-9928-4860-3-5